



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 512 Akti

Nr. 632 Vendimi
Tiranë, më 8.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 2.3.2023, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Laurent Fuçia**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Laurent Fuçia dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i

cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Laurent Fuçia është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Laurent Fuçia, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 22.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 e vijues të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 8.7.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin datë 7.2.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Laurent Fuçia, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

¹ Email datë 8.7.2020, ora 9:55, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

7. Në datën 7.2.2023, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 23.2.2023; dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 23.2.2023 subjekti paraqiti me anë të postës elektronike³ pretendimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 28.2.2023, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 2.3.2023, ora 12:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 2.3.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

11. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

12. Z. Laurent Fuçia, pasi dëgjoji relacionin e paraqitur nga relatorja e çështjes, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 2.3.2023, subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia kërkoi konfirmimin në detyrë.

14. Seanca dëgjimore e datës 2.3.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 8.3.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

17. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për

² Email datë 7.2.2023, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

³ Email datë 23.2.2023.

⁴ Email datë 28.2.2023, "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

18. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

19. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2010, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

20. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për vitet 2010 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*

⁵ “Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: ‘Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse’”.

2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2010 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) deklaratimet e bashkëjetueses E. L. për vitet 2013 – 2016 të dorëzuara në ILDKPKI dhe në pyetësorin standard; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; si dhe (ë) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

23. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: E. L., bashkëjetuese (bashkëshorte nga data 24.12.2018), subjekt rivlerësi⁶, konsiderohet person i lidhur; G. L. (babai i bashkëjetueses) konsiderohet person i lidhur për shkak të: (i) dhurimit të shumës 15.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi me bashkëjetuesen; (ii) shumës 40.000 euro që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëjetuesja; (iii) shumave të dhuruara ndër vite.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëjetuesen, me vlerë 55.000 euro

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëjetuesen, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 66 m² dhe verandë 34,56 m², kontratë e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme me nr. ***, datë 6.3.2014, pranë noteres A. K.. Vlera: 55.000 euro, me pjesë të papërcaktuar*”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar: (i) kontratën e kredisë bankare nr. ***, datë 17.3.2014, të lidhur me “***”, me vlerë 40.000 euro (5.640.000 lekë); (ii) 15.000 euro shlyerje në favor të shitësit përmes “***” në mars 2014 dhe shlyerje e kredisë bankare në tetor 2016, me burim të ardhura nga babai i bashkëjetueses E. G. L., shtetasi G. R. L. – të ardhura të cilat i ka krijuara nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 25.3.2010, pranë noteres I. Sh. (dokument që është vënë në dispozicion në momentin e deklaratës fillestare të bashkëjetueses E. L.). Për vërtetimin e deklarimit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷.

⁶ Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷ Vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 15.4.2014; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 6.3.2014; kontratë kredie nr. ***, datë 17.3.2014; kontratë hipotekimi nr. ***, datë 17.3.2014; deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.3.2014; deklaratë llogarie e “***” për periudhën 29.9.2000 – 31.10.2016; deklaratë noteriale nr. ***, datë 28.10.2016; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.03.2010; deklaratë noteriale e bërë përpara noterit publik të shtetit New Jersey, SHBA, me vulë apostile, e datës 17.10.2016.

1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting* 2017, administruar edhe nga ASHK Tirana Jug⁸ dhe notere A. K.⁹, rezulton se subjekti Laurent Fuçia dhe shtetasja E. L., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.3.2014, kanë blerë nga shtetasja Xh. Rr. apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë rruga “****”, kati ***, shk. ***, Tiranë, me sip. 66,6 m², si dhe verandë me sip. 34,56 m². Në kontratë parashikohet se çmimi i shitjes së apartamentit është 55.000 euro, i barasvlefshëm me 7.700.000 lekë. Lidhur me mënyrën e pagesës, kontrata parashikon se në datën e nënshkrimit të saj do të likuidohen 15.000 euro pranë “****” (SGA) në numrin e llogarisë së palës shitëse dhe se kredia prej 40.000 euro, që do të përfitohet nga pala blerëse, do t’i kalojë palës shitëse po në të njëjtin numër llogarie pranë kësaj banke. Vetë shitësi, shtetasja Xh. Rr., e ka blerë këtë apartament me kontratën nr. ***, datë 22.4.2013, në vlerën 55.000 euro (e barasvlefshme me 7.700.000 lekë)¹⁰.

1.3. Me qëllim analizimin e vlerës së blerjes së këtij apartamenti dhe nëse ka pasur apo jo ndonjë trajtim preferencial për subjektin, Komisioni iu referua udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”. Bazuar në këtë udhëzim, referuar tabelës nr. 3 – Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2014 – vlera në tregun e lirë referuar zonës ku ndodhet apartamenti (zona 7/4) përlllogaritet në vlerën 4.329.000 lekë¹¹ (pa përfshirë verandën me sip. 34,56 m²), përkundrajt çmimit 7.700.000 lekë¹², të paguar nga subjekti. Ndërsa, sipas pasqyrës llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, të përcjellë nga ASHK-ja¹³, përlllogaritet një vlerë referuese prej 6.227.100 lekësh (66,6 x 93.500 lekë). Për rrjedhojë, nuk konstatohet që subjekti ka pasur trajtim preferencial.

1.4. Lidhur me momentin e fillimit të banimit, në pyetësin standard¹⁴, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/E. L. kanë deklaruar se kanë filluar të banojnë në këtë apartament nga muaji mars 2014¹⁵. Kjo konfirmohet edhe nga deklarimi i kryer në DIPP-të përkatëse të vitit 2014, ku është deklaruar si vendqëndrim tjetër, adresë e plotë banimi, adresa: rruga “****”, kompleksi “****”, pranë “****”.

1.5. FSHU-ja¹⁶ informon se me gjeneralitetet Laurent Fuçia identifikohet një abonent me kontratë furnizimi me nr. ***, në instancën Tiranë, me adresë rruga “****”. Në vijim, nga dokumentacioni i përcjellë¹⁷ lidhur me datën e kalimit të kësaj kontrate në emër të subjektit, rezulton se fillimisht kontrata është lidhur në emër të shtetasit M. B., në datën 24.8.2011, e më pas ka kaluar nga ky shtetas tek subjekti me kërkesën e datës 15.3.2019. Në përfundim, nuk konstatohen problematika lidhur me momentin e fillimit të banimit në apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë rruga “****”.

1.6. Lidhur me mobilimin e apartamentit, në përgjigje të pyetësit standard, subjekti ka deklaruar se shpenzimet për mobilimin e apartamentit ku jeton bashkë me bashkëshorten, duke

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020.

⁹ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.11.2022.

¹⁰ Paraqitur nga subjekti në dokumentacionin bashkëlidhur pyetësit standard.

¹¹ Sipërfaqe totale 66,6 m² x 65.000 lekë/m².

¹² Ekuivalenti i vlerës 55.000 euro.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020.

¹⁴ Email datë 27.7.2020.

¹⁵ Subjekti ka deklaruar: “Duke filluar nga muaji mars 2014 dhe aktualisht jetoj së bashku me bashkëshorten time, znj. E. L...”. Personi i lidhur/E. L. ka deklaruar: “Nga muaji mars i vitit 2014 dhe aktualisht banoj në apartamentin e ndodhur në adresën rruga ‘****’, kompleksi ‘****’, hyrja nr. ***, kati ***, apartamenti nr. ****...”.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 5.1.2023.

përfshirë edhe shpenzimet për pajisjet elektrike, shkojnë afërsisht 700.000 lekë. Për sa i përket periudhës së blerjes, deklaroi se nuk e mban mend, por sqaron se një pjesë e pajisjeve elektroshtëpiake dhe orendive janë transferuar nga banesa ku bashkëshortja e tij ka jetuar me familjen e saj, pasi në momentin kur familjarët e saj janë larguar në Amerikë banesa ku kanë jetuar është shitur dhe një pjesë e orendive janë transferuar në banesën ku jeton, ndërsa pjesa tjetër është blerë në harkun kohor 2014 – 2019. Në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar shumat e shpenzuara për secilin vit kalendarik, si dhe nuk ka dorëzuar ndonjë dokumentacion justifikues për të provuar shpenzimet, me qëllim saktësimin e kohës së kryerjes së tyre, Komisioni e shpërndau këtë shpenzim bazuar në një vlerësim logjik, konkretisht përllogariti 80% të vlerës së deklaruar si shpenzim në vitin 2014 (viti i fillimit të banimit, shuma 560.000 lekë) dhe 20% të vlerës si shpenzim në vitin 2015 (140.000 lekë).

1.7. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasen Xh. Rr. dhe rezultoi se subjekti nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me këtë shtetase¹⁸.

1.8. Lidhur me pagesën e parë në vlerën 15.000 euro, referuar informacionit të përcjellë nga OTP Bank¹⁹ (ish-SGA), konstatohet se në datën 6.3.2014 subjekti ka depozituar në llogarinë bashkëmërore (Laurent Fuçia ose E. L.) shumën 15.000 euro, me përshkrimin “derdhje cash”. Në të njëjtën datë, kjo shumë është transferuar në favor të shitësit, shtetasen Xh. Rr., me përshkrimin “paguar nga Laurent Fuçia dhe E. L. në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ***, për blerje apartamenti”. Gjithashtu rezultoi se burimi i shumës 15.000 euro është deklaruar në mënyrë koherente nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja e tij në deklaratën *Vetting* 2017, në DIPP-të vjetore dhe në pyetësorin standard, se kanë qenë të ardhurat e shtetasit G. L./babai i bashkëjetueses nga shitja e një apartamenti në Tiranë²⁰.

1.9. Lidhur me pagesën e dytë në vlerën 40.000 euro (kredia nga SGA), subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia dhe shtetasja E. L., në cilësinë e kredimarrësve, kanë lidhur me OTP Bank një kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi, me nr. ***, datë 17.3.2014, në të cilën përcaktohet se banka i jep kredimarrësve një kredi në shumën 5.640.000 lekë për blerje apartamenti, për një periudhë prej 240 muajsh (20 vite).

1.10. Për garantimin e shlyerjes së kredisë është vendosur si kolateral pikërisht apartamenti për të cilin është marrë kredia, konkretisht pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e cila, në momentin e lidhjes së kontratës së kredisë, rezultonte në pronësi të shtetasen Xh. Rr.. Si pasojë është lidhur kontrata e hipotekimit nr. ***, datë 17.3.2014, ndërmjet bankës dhe shtetasen Xh. Rr.²¹. Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare, kredia është lëvruar në datën 26.3.2014, në vlerën 5.640.000 lekë, në llogarinë bashkëmërore (Laurent Fuçia ose E. L.). Në të njëjtën datë është transferuar në favor të shtetasen Xh. Rr. (shitësi) shuma 5.620.000 lekë, me përshkrimin “në favor të Xh. Rr., xhirim me kurs 140,5”²².

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 12.12.2022, e Gjykatës së Apelit Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2020.

²⁰ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.3.2010.

²¹ Në datën 31.3.2014, SGA Bank ka lëshuar deklaratën noteriale nr. ***, me anë të së cilës jep pëlqimin për kalimin e pronësisë së apartamentit të mësipërm nga shtetasja Xh. Rr. tek shtetasit Laurent Fuçia dhe E. L., me kushtin që prona të vijojë e renduar me barrën hipotekore në favor të bankës.

²² Në datën 17.3.2014, subjekti Laurent Fuçia, E. L. dhe shtetasja Xh. Rr. kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët noteriale me nr. ***, ku subjekti dhe bashkëjetuesja e tij, pasi konfirmojnë detyrimin që kishin në shumën 40.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 6.3.2014, deklarojnë se kanë marrë kredinë nga SGA Bank dhe e kanë shlyer detyrimin e tyre.

1.11. Nga analizimi i llogarisë bankare konstatohet se gjatë periudhës 27.3.2014 – 10.10.2016 janë kryer pagesa për këstet dhe shpenzime të tjera për kreditë, me vlerë totale 1.292.055 lekë. Burim i pagesës së këtyre kësteve kanë qenë depozitimet mujore të subjektit të rivlerësimit në llogarinë bashkëmjorë. Më tej, në datën 7.10.2016, subjekti ka depozituar *cash* në llogarinë e tij shumën 40.000 euro, me përshkrimin “*derdhje cash*”, të cilat, në datën 10.10.2016 janë kaluar në llogarinë e shlyerjes së kredisë, të konvertuara në vlerën 5.476.000 lekë, me përshkrimin “*këmbim në llogari*”. Në vijim, në datën 11.10.2016, subjekti dhe bashkëjetuesja kanë shlyer para kohe të gjithë shumën e mbetur të kredisë, me vlerë 5.369.316 lekë. Ky veprim është pasuar me deklaratën noteriale nr. ***, datë 28.10.2016, SGA Bank ka deklaruar se, meqenëse kredimarrësi e ka shlyer kreditë dhe nuk ka më detyrime ndaj bankës, autorizon ZRPP-në të kryejë veprimet e nevojshme për lirimin e pronës të sipërpërmendur nga barra hipotekore.

1.12. Shlyerja e kredisë është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2016. Gjithashtu, burim i shumës 40.000 euro është deklaruar në mënyrë koherente nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesja e tij në deklaratën *Vetting* 2017, në DIPP-të vjetore dhe në pyetësin standard, se kanë qenë të ardhurat e shtetasit G. L./babai i bashkëjetueses nga shitja e një apartamenti në Tiranë²³.

Lidhur me kontributin prej 60.000 euro të babait të personit të lidhur/E. L.

1.13. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar se burim i krijimit të shumës 15.000 euro dhe i shlyerjes së kredisë bankare në tetor të vitit 2016, në shumën 40.000 euro, janë të ardhurat nga babai i bashkëjetueses E. L., shtetasi G. L., të cilat ky i fundit i ka krijuar nga të ardhurat e krijuara nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 25.3.2010.

1.14. Në deklaratën e firmosur përpara noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, të datës 10.10.2016, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, shtetasi G. L.²⁴ ka deklaruar: “...shuma prej 60.000 euro, e cila është deklaruar si pasuri nga ana e vajzës sime, znj. E. L., në deklaratën fillestare të pasurisë (tetor 2013), për të cilën ajo ka pasur të drejtën e administrimit dhe e cila buron nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 25.3.2010, kalon në pronësi të plotë pa kufizim tagrash, vajzës sime znj. E. L....”.

1.15. Komisioni, bazuar në nenin 681²⁵ të Kodit Civil, arsyeton se pavarësisht faktit që dokumenti i mësipërm titullohet deklaratë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së tij, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, konstaton se qëllimi i tij ka qenë kalimi pa shpërblim i shumës 60.000 euro nga shtetasi G. L. vajzës së tij E. L. Nga ana tjetër, duke vlerësuar edhe sjelljen e shtetasës E. L. para dhe pas përfundimit të kontratës nëpërmjet deklarimit të kësaj shume në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe të deklarimit për përdorimin e saj për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e kredisë, evidentohet pëlqimi i saj si palë pranuese. Në këto kushte është evidentuar pëlqimi i palës dhuruese dhe asaj pranuese, shkaku i ligjshëm,

Gjithashtu, pala shitëse Xh. Rr. ka deklaruar se e ka marrë shumën e mësipërme dhe nuk ka asnjë pretendim kundrejt palës blerëse.

²³ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.3.2010.

²⁴ Banues në New Jersey, me shtetësi shqiptare dhe amerikane.

²⁵ Neni 681 parashikon: “Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës”.

objekti që ka formuar lëndën e kësaj kontrate dhe forma e saj ligjore²⁶. Si pasojë, deklarata e shtetasit G. L. plotëson elementet e një kontrate dhurimi, e cila parashikohet nga neni 761²⁷ i Kodit Civil.

1.16. Referuar dokumentacionit të administruar, konstatohet se subjekti në kontratën e shitblerjes së apartamentit²⁸ figuron si blerës bashkë me bashkëjetuesen e tij, personin e lidhur/E. L., dhe kjo pasuri është regjistruar në ASHK në bashkëpronësi me bashkëjetuesen e tij me pjesë të papërcaktuar. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1²⁹, i kërkoi subjektit të sqaronte nëse gjatë periudhës së bashkëjetesës me personin e lidhur E. L. (2014 - 2018) kanë lidhur marrëveshje noteriale për përcaktimin e pasojave të bashkëjetesës për ndarjen e detyrimeve dhe fitimeve gjatë bashkëjetesës, në kuptim të nenit 164 të Kodit të Familjes. Në përgjigje³⁰, subjekti deklaroi se nuk ka marrëveshje noteriale në lidhje me ndarjen e fitimeve dhe detyrimeve, por kanë pranuar pasojat që vijnë nga ligji, prezumimet ligjore (absolute apo relative), si dhe parimi i mirëbesimit. Referuar nenit 164 të Kodit të Familjes, vijoi subjekti, lidhja e marrëveshjes noteriale është lënë në diskrecionin (vullnetin) e bashkëjetuesve, rrjedhimisht kjo çështje i është lënë rregullimeve të përgjithshme mbi pasurinë dhe pronësinë.

1.17. Në kushtet kur: (i) subjekti i rivlerësimit në kontratën e shitblerjes së apartamentit³¹ figuron si blerës bashkë me bashkëjetuesen e tij, me pjesë të papërcaktuar; (ii) kjo pasuri është regjistruar në ASHK në bashkëpronësi me bashkëjetuesen e tij, pa përcaktuar pjesë; (iii) shuma e dhuruar bashkëjetueses së subjektit nga babai i saj ka shërbyer për pagesën e këstit të parë të apartamentit dhe për shlyerjen e detyrimeve që subjekti dhe personi i lidhur kishin ndaj SGA Bank, nisur edhe nga prezumimi ligjor se pjesët e tyre në pasurinë apartament janë të barabarta³² – arrihet në përfundimin se dhurimi që ka marrë personi i lidhur/E. L. nga babai i saj ka shërbyer si i tillë edhe për subjektin e rivlerësimit dhe, për pasojë, bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi G. L. konsiderohet “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit dhe ai së bashku me subjektin kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar për krijimin e 1/2 pjesë të pasurisë apartament.

Burimi i krijimit të shumës prej 60.000 euro të dhuruar nga shtetasi G. L.

1.18. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 25.3.2010, ku shtetasi G. L., me pëlqimin e bashkëshortes së tij V. L., i ka shitur shtetasit M. H. apartamentin me sip. 97 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, Tiranë³³, kundrejt vlerës 16.975.000 lekë, e cila në kontratë parashikohet se është likuiduar plotësisht përpara redaktimit të saj.

1.19. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasit G. L. pranë “Intesa Sanpaolo Bank”³⁴ konstatohet se në datën 2.4.2010 janë kredituar 122.000 euro, me përshkrimin “Transfer M. H. fav. G. R. L., pagesë për blerje apartamenti, rr. “***”, p. “***”, shk. ***, ap.

²⁶ Neni 764 i Kodit Civil parashikon se vetëm dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm.

²⁷ Neni 761 parashikon: “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon”.

²⁸ Kontratë nr. ***, datë 6.3.2014.

²⁹ Email datë 14.12.2022.

³⁰ Përgjigjet e përcjella me email, datë 22.12.2022.

³¹ Kontratë nr. ***, datë 6.3.2014.

³² Kodi Civil, neni 199, parashikon: “Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta”.

³³ I përbërë nga 2 dhoma, 1 kuzhinë dhe ambiente ndihmëse, me adresë: rruga “***”, ap. ***, kati *** i banimit, Tiranë.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2022.

****”. Më pas, kjo shumë është tërhequr nga llogaria gjatë periudhës kohore 8.4.2010 – 15.9.2010.

1.20. Referuar përshkrimeve të evidentuara në lëvizjet e llogarisë, vërehet se: (i) 49.938 euro janë tërhequr pa përshkrim dhe 15.000 euro janë tërhequr me përshkrimin “për pagesa”; (ii) 42.000 euro janë tërhequr me përshkrimin “kthim detyrimi”; (iii) 15.000 euro janë transferuar me përshkrimin “kthim detyrimi”. Për rrjedhojë, babai i subjektit potencialisht mund ta ketë disponuar *cash* shumën 60.000 euro.

1.21. Me anë të pyetësorit nr. 1³⁵, subjektit iu kërkua të specifikojë se në cilën periudhë e ka marrë bashkëjetuesja shumën prej 60.000 euro dhe se ku ishte ruajtur një shumë e tillë deri në vitin 2014. Në përgjigje³⁶, subjekti shpjegoi se shuma 60.000 euro është përfutur në periudhën 2010 – 2013 dhe se këto të holla kanë qenë jashtë sistemit bankar.

1.22. Personi i lidhur/E. L. ka deklaruar në pyetësorin standard se prindërit e saj jetojnë jashtë Shqipërisë që prej tetorit të vitit 2010³⁷, çka konfirmohet nga sistemi TIMS³⁸. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave³⁹ informoi se prindërit e bashkëjetueses nuk kanë deklaruar para *cash* gjatë kalimit të pikave doganore.

1.23. Më tej, subjektit të rivlerësimit, në pyetësorin nr. 1, iu kërkua të shpjegojë arsyen e marrjes së kredisë prej 40.000 euro pranë OTP Bank në vitin 2015, ndërkohë që, referuar deklaramenteve në DIPP-të vjetore, në këtë vit kjo vlerë disponohej gjendje *cash* prej tyre.

1.24. Në përgjigje⁴⁰, subjekti i rivlerësimit sqaroi se fondi 60.000 euro dhe administrimi i tij është çështje personale dhe familjare e familjes së origjinës së bashkëshortes, plane të cilat kanë ndryshuar në varësi të situatave faktike⁴¹. Ai vijoi duke shpjeguar se: “...shlyerja e kredisë përkon me realizimin e kontratës së shitjes të objektit të lëshuar me qira nga prindërit, si dhe dhënien e deklaratës konfirmuese në tetor të vitit 2016, situatë faktike që ka krijuar likuiditete në sistemin bankar. Në lidhje me shprehjen në përgjigjet e pyetësorit standard ‘më është dhënë me qëllim blerjen e apartamentit ku jetoj’, në vitin 2021, por edhe më parë, destinacioni përfundimtar i kësaj shume është bërë i qartë. Ky apartament është vendi ku prindërit kanë qëndruar në Shqipëri, pra ka si qëllim shfrytëzimin e përbashkët”.

1.25. Për sa i përket blerjes dhe shitjes së apartamentit nga ana e babait të bashkëjetueses, nga dokumentacioni i administruar nga noterja I. Sh.⁴², shtetasi V. (G.) L.⁴³, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 13.4.2002, ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin nr. ***, që ndodhet në katin e 10-të të banimit, i përbërë nga 2 dhoma gjumi, 1 dhomë ndenjeje me kuzhinë, si dhe ambiente të tjera me sip. 97 m², në pallatin 12-katësh që ndodhet në rrugën “****”, Tiranë, me

³⁵ Email datë 14.12.2022.

³⁶ Email datë 22.12.2022.

³⁷ Përgjigje e pyetjes nr. 2.

³⁸ Për shtetasin G. L. rezulton dalje nga Rinasi në datën 22.9.2010 dhe hyrja më e afërt në datën 22.7.2012. Për shtetasen V. L. rezulton dalje nga Rinasi në datën 22.9.2010 dhe hyrja më e afërt në datën 7.4.2011. Më tej është vijuar me hyrje - dalje të tjera, me periudha të shkurtra qëndrimi në territorin shqiptar.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022.

⁴⁰ Përgjigjet e përcjella me email datë 22.12.2022.

⁴¹ Në pyetësorin nr. 2, datë 19.1.2023, subjekti ka dhënë shpjegime plotësuese lidhur me shumën 60.000 euro, duke sqaruar se shënimet e kryera nga “Intesa Sanpaolo Bank” janë kryer nga punonjësit e bankës për arsye të brendshme të institucionit financiar bankar, të cilat nuk provojnë qëllimin dhe arsyet e tërheqjes së shumave, konkretisht shënime të karakterit administrativ dhe operativ.

⁴² Shkresë e datës 21.11.2022.

⁴³ DPGJC-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.11.2022, informon se shtetasi G. L. në datën 21.2.1992 ka ndryshuar emrin nga G. në V. dhe, më pas, në datën 17.5.2005 ka ndryshuar përsëri emrin nga V. në G.

çmim shitjeje 55.000 euro, të cilat sipas kontratës janë likuiduar me mandatarkëtime të xhiruara në llogarinë përkatëse të shoqërisë. Më pas, me kontratën nr. ***, datë 25.3.2010, parashikohet se shtetasi G. L., me pëlqimin e bashkëshortes së tij V. L., i ka shitur shtetasit M. M. H. pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 97 m², me nr. ***, i përbërë nga 2 dhoma e kuzhinë, në rrugën “****”, Tiranë, ap. ***, kati i 10-të i banimit, kundrejt çmimit 16.975.000 lekë, shumë e cila në kontratë deklarohet se është likuiduar nga blerësi përpara redaktimit të kësaj kontrate.

1.26. ASHK-ja⁴⁴ informon se referenca e origjinës së pronës së blerë nga shtetasi M. H. është në mungesë. Megjithatë, nga verifikimi në faqen elektronike të ASHK-së rezulton se në emër të shtetasit M. M. H. figuron i regjistruar apartamenti me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Tiranë.

1.27. Sipas legjislacionit tatimor të kohës, dhe konkretisht sipas parashikimit të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, sipas formulimit që ky nen ka pasur në mars të vitit 2010⁴⁵, tatimi për kalimin e së drejtës të pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme derdhej pranë zyrave të regjistrimit të pasurive së paluajtshme nga personi që kalonte të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit të pasurisë. Edhe udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006, i ministrit të Financave, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në pikën 2.7.3 të tij parashikonte se zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme mbledhin tatimin lidhur me kalimin e së drejtës të pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe e derdhin atë brenda 10 ditëve nga kryerja e veprimeve në llogarinë e administratës tatimore.

1.28. Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, prezumohet se me regjistrimin e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 25.3.2010, në ZVRPP, në emër të shtetasit M. H. është paguar tatimi mbi të ardhurat që shtetasi G. L. ka përfituara nga shitja e apartamentit.

1.29. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë apartament; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në vlerën 55.000 euro.

2. Automjet në vlerën 400.000 lekë

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Makinë ‘Mercedes-Benz’, me targa ***, ngjyrë gri, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.1.2016, në vlerën 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”. Si burim krijimi ka deklaruar nga bashkëjetuesja të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 11.10.2010, me qira mujore 1.500 euro për familjen, e cila është revokuar në datën 4.8.2014 me deklaratën nr. ***, ku nga llogaria bankare nr. *** e klientit G. L. autorizohet nga babai tërheqja pranë “Raiffeisen Bank”, deklaratë konfirmuese e njehsuar, lëshuar në datën 10.10.2016, me pjesë takuese 100%. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁴⁶.

⁴⁴ Shkresë e datës 22.11.2022, e përcjellë nëpërmjet sistemit multifunksional.

⁴⁵ Neni 11, i ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar me ligjin nr. 9716, datë 16.4.2007, parashikonte se: “...2. *Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. 3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që brenda 10 ditëve të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni*”.

⁴⁶ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.1.2016; kontratë qiraje nr. ***, datë 11.10.2010; prokurë e posaçme nr. ***, datë 21.9.2010; mandatarkëtim datë 23.3.2012, 27.11.2013, 8.1.2014 dhe datë 22.4.2014; deklaratë nr. ***, datë 4.8.2014; nxjerrje llogarie e klientit G. L. në “Raiffeisen Bank”.

2.2. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja⁴⁷, subjekti ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.1.2016, automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, vit prodhimi 2002, me çmimin 400.000 lekë, shumë e cila në kontratë parashikohet se është paguar përpara redaktimit të saj jashtë zyrës së noterisë. Shoqëria “****” sh.p.k. e ka blerë këtë automjet nga shtetasi V. Z. me kontratën nr. ***, datë 4.7.2007, me çmimin 500.000 lekë. Më pas, subjekti i rivlerësimi, me kontratën nr. ***, datën 6.3.2019, e ka shitur këtë automjet tek shtetasi E. N. kundrejt shumës 300.000 lekë.

2.3. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., administratorin dhe ortakun e saj D. P.. Nga hetimi nuk rezultoi se subjekti ishte në kushtet e konfliktit të interesit me këto subjekte⁴⁸.

Analiza e burimit financiar të krijimit – të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e magazinës në pronësi të shtetasit G. L.

2.4. Në datën 11.10.2010 shtetasit G. edhe V. L., të përfaqësuar nga znj. E. L.⁴⁹, kanë lidhur kontratën e qirasë nr. *** me shoqërinë “****” sh.p.k., duke i dhënë me qira kësaj të fundit objektet: 1. *Ndërtesë, magazinë ambalazhi qelqi me sip. 450 m² dhe truall me sip. 450 m², rr. “****”, Tiranë, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Tiranë; 2. truall me sip. 629 m², rr. “****”, Tiranë, i regjistruar me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***; 3. truall me sip. 243 m², rr. “****”, Tiranë, me afat 10 vjet, me vlerë 1.500 euro/muaj. Gjithashtu rezultoi se palët kanë nënshkruar procesverbalin e datës 11.10.2010 për dorëzimin e pasurive të dhëna/marra me qira⁵⁰.*

2.5. Më pas, kontrata e qirasë është zgjidhur me deklaratën noteriale nr. ***, datë 4.8.2014, sipas së cilës palët kanë deklaruar zgjidhjen me mirëkuptim, si dhe kanë deklaruar që efektet e kësaj kontrate kanë pushuar që nga data 30.4.2014 dhe që palët nuk kanë detyrime ndërmjet tyre.

2.6. Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të shtetasit G. L. pranë “Raiffeisen Bank”⁵¹ konstatohen transfertat periodike nga shoqëria “****” sh.p.k. për pagesën e qirasë në vlerën totale 49.357 euro, konkretisht: (i) 16.607 euro për vitin 2011; (ii) 15.250 euro për vitin 2012; (iii) 12.100 euro për vitin 2013; dhe (iv) 5.400 euro për vitin 2014.

2.7. Në DIPP-në e vitit 2014 personi i lidhur/E. L. ka deklaruar se gjatë vitit 2014 ka tërhequr nga llogaria e babait vlerat 8.463 euro dhe 7.000 USD, si dhe ka depozituar vlerën 1.600 USD.

2.8. Referuar informacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, tërheqjet në vlerën totale prej 8.463 euro kanë si burim transfertat e kryera nga shoqëria “****” sh.p.k. për pagesën e qirasë. Ndërsa tërheqja në datën 9.7.2014, në vlerën 7.000 USD, ka si burim një transfertë nga llogaria bankare në SHBA e shtetasit G. L.⁵².

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 12.12.2022, e Gjykatës së Apelit Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁴⁹ Me prokurën nr. ***, datë 21.9.2010, administruar nga notere Dh. Q., me shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2022, shtetasit G. e V. L. kanë emëruar si përfaqësuese të posaçme vajzën e tyre E. L., që në emër dhe për llogari të tyre t’i përfaqësojë në administrimin e pasurive të paluajtshme të mësipërme, duke i dhënë të drejtë të hyjë në bisedime me shoqërinë “****” sh.p.k. për dhënien me qira të tyre, si dhe i kanë përcaktuar edhe të drejta të tjera që kanë lidhje me administrimin e pasurive.

⁵⁰ Referuar vendimit nr. ***, datë 17.6.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, shtetasi V. (G.) L. ka blerë nëpërmjet kontratës së shitjes datë 5.11.2003 nga personat e tretë H. H. etj., objektin magazinë e ambalazhit të qelqit në ***. Personat e tretë e kishin blerë këtë objekt nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, si ish-pronarë të truallit ku ndodhej objekti.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2020.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2022, e “Raiffeisen Bank”.

2.9. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiraja, në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka paraqitur: (i) depozitim për llogari të Degës së Tatimeve Tiranë, në vlerën 251.850 lekë, datë 23.3.2013, me përshkrimin “G. L., tat. qiraje viti 2011 - 23.3.2013”, urdhërues G. L., nënshkruar nga shtetasja L. D.; (ii) urdhërshirim për llogari të Degës së Tatimeve Tiranë, në vlerën 196.000 lekë, datë 27.11.2013, nga shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “10% tatim qira janar - tetor 2013 për G. L.”; (iii) urdhërshirim për llogari të Degës së Tatimeve Tiranë, në vlerën 42.000 lekë, datë 8.1.2014, nga shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “10% tatim qira nëntor - dhjetor 13, G. L.”; (iv) urdhërshirim për llogari të Degës së Tatimeve Tiranë, në vlerën 63.000 lekë, datë 22.4.2014, nga shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “10% tatim 3 muaj 2014, G. L.”.

2.10. Sa më lart, rezulton se shumat 8.463 euro dhe 7.000 USD, të tërhequra nga personi i lidhur nga llogaria bankare e babait të saj, kanë pasur si burim të ardhura të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës⁵³.

2.11. Megjithatë, pavarësisht konkluzionit të mësipërm, nga analizimi i deklarimeve të likuiditeteve *cash* të disponuar nga personi i lidhur/E. L. (trajtuar gjerësisht në pikën 8), konstatohet se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar qartësisht në DIPP-në e vitit 2016 dhe në pyetësorin nr. 1⁵⁴ nëse për blerjen e automjetit në vlerën 400.000 lekë janë pakësuar shumat e deklaruara në DIPP-në e vitit 2014 (8.346 euro dhe 7.000 USD).

2.12. Referuar orientimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimin nr. 7-2019, datë 5.4.2019⁵⁵, ku parashikohet se: “[...] të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...]”, në kushtet që subjekti nuk ka specifikuar qartësisht pakësimin e ndonjë prej shumave në euro apo dollarë, Komisioni nuk i konsideroi këto likuiditete si burim për blerjen e automjetit.

2.13. Po kështu, nga analizimi i llogarive bankare të babait të personit të lidhur/E. L. për harkun kohor 1.1.2016 – 29.1.2016, nuk konstatohen tërheqje me burim të ardhurat nga qiraja.

2.14. Nga faktet e analizuar më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për pagesën e automjetit në vlerën 400.000 lekë, pasi ai nuk ka deklaruar qartësisht burimin financiar të këtij automjeti, duke mos specifikuar në DIPP-në e vitit 2016 pakësimin e ndonjë prej shumave në euro apo dollarë.*

⁵³ Ligjshmëria e të ardhurave të prindërve të përfutur në SBBA është trajtuar në pikën 12 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁵⁴ Email datë 22.12.2022.

⁵⁵ Bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen të mos konsiderojë si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale ku ata kanë qenë pjesëmarrës, si dhe të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

2.15. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵⁶, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në lidhje me burimet e të ardhurave për automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, i qëndron deklarimeve në deklaratën e procesit të rivlerësimit dhe në deklaratën periodike të ILDKPKI-së, ku burimi i krijimit janë të ardhura nga bashkëjetuesja, të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 11.10.2010. Më pas shpjegon se shuma 400.000 lekë, me burim nga tërheqjet në bankë në llogarinë bankare ku derdhej pagesa periodike e qirasë mujore, ka pakësuar likuiditetin *cash*, pasi në periudhën kur është blerë automjeti, 1.1.2016 – 29.1.2016, nuk ka pasur tërheqje të tjera në llogari bankare.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.16. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

2.17. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* 2017, ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë automjet me targa *** të ardhurat nga bashkëjetuesja, të krijuara nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 11.10.2010.

2.18. Nga analizimi i mënyrës së përfitimit të të ardhurave nga qiraja dhe i lëvizjes së likuiditeteve *cash* (trajtuar në pikën 8 në vijim) vërehet se të ardhurat nga qiraja kanë qenë në monedhën euro.

2.19. Sa më sipër, bazuar në deklarinimet e subjektit lidhur me burimin, Komisioni për llogaritë ekuivalentin në euro të çmimit të blerjes së automjetit, nga ku rezultoi një vlerë prej 2.885 euro⁵⁷ dhe pakësoi me këtë vlerë likuiditetet *cash* të akumuluar deri në momentin e blerjes së automjetit.

2.20. Komisioni vëren se shuma 8.463 euro, e tërhequr nga personi i lidhur nga llogaria bankare e babait të saj, ka pasur si burim të ardhura të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit.

2.21. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë automjet me targa ***; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në vlerën 400.000 lekë.

3. Shumë të hollash në vlerën 1.000 euro

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Shumë të hollash në vlerën 1.000 euro. Pjesa takuese: 100%*”. Si burim krijimi ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Fiat Punto”, me targa ***, në vlerën 1.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 8.10.2015. Burimi i krijimit: kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 10.12.2012 dhe kontratë

⁵⁶ Email datë 23.2.2023.

⁵⁷ Shuma 400.000 lekë e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 29.1.2016, 1 euro = 138,68 lekë.

kredie bankare nr. ***, në vlerën 300.000 lekë. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁵⁸.

3.2. Në DIPP-në e vitit 2015, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit me kontratën nr. ***, datë 8.10.2015. Vlera: 1.000 euro*”. Më pas, në DIPP-në e vitit 2016, nuk ka deklaruar shtesa apo pakësim.

3.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁵⁹, subjekti i rivlerësimit konfirmoi se shuma 1.000 euro, e deklaruar në rubrikën e sipërcituar, ka të bëjë me shtim likuiditetesh *cash*⁶⁰.

3.4. Për rrjedhojë, referuar legjislacionit në fuqi⁶¹, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e vlerës 1.000 euro në DIPP-në e vitit 2016, vlera 1.000 euro konsiderohet e mbartur deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* 2017, vlerë e cila përputhet me atë të deklaruar nga subjekti në këtë deklaratë.

3.5. Lidhur me burimin e parë të deklaruar nga subjekti, konkretisht të ardhurat nga shitja e automjetit me kontratën nr. ***, datë 10.12.2012, me vlerë 1.000 euro, referuar trajtimit në pikën 5, duket se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e vlerës së likuiditeteve *cash*, të deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017.

3.6. Ndërsa, lidhur me burimin e dytë, fondet e përfituara nga kredia bankare pranë “Tirana Bank”, Komisioni vëren se kredia e lëvruar në datën 8.5.2012 nuk mund të përfshihet si burim për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruara në deklaratën *Vetting* 2017, për sa kohë tërheqja e kredisë nuk është deklaruar si likuiditet *cash* në DIPP-në përkatëse.

3.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri dhe e ka krijuar atë me burime të ligjshme.

4. Gjendje llogarie bankare në vlerën 198,83 lekë, në “**”**

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje llogarie bankare ditën e deklaramit, datë 23.1.2017, pranë “****” në vlerën 198,83 lekë, referuar gjendjes së llogarisë datë 20.1.2017. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁶².

4.2. OTP Bank⁶³ konfirmon se subjekti ka pasur llogari rrjedhëse në lekë pranë kësaj banke, e cila është çelur në datën 26.3.2014 dhe balanca në datën 23.1.2017 ka qenë në vlerën 198,83 lekë.

4.3. Nga shqyrtimi i lëvizjeve rezulton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat si gjyqtar.

4.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari bankare në deklaratën *Vetting* 2017.

⁵⁸ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 10.12.2012; kontratë kredie nr. ***; kontratë shitjeje nr. ***, datë 8.10.2015; leje qarkulli për automjetin tip “Fiat Punto”, me targa ***.

⁵⁹ Përgjigjet e përcjella me *email* datë 22.12.2022.

⁶⁰ Subjekti deklaroi: “*Gjendja e likuiditeteve për datën 31.12.2015, shtim 1.000 euro, nga shitja e automjetit Fiat*”.

⁶¹ Referuar nenit 4, pika d e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj” dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklaramin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë”.

⁶² Lëvizje llogarie nga “****”, datë 31.10.2016 dhe datë 20.1.2017.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.8.2020.

5. Automjet tip “Fiat Punto”, me targa *** (blerë në vitin 2012, shitur në vitin 2015)

5.1. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar “kontratë blerjeje automjeti 150 euro” dhe si dokument justifikues ka vendosur kontratë shitblerjeje datë (e palexueshme), 2012.

5.2. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja⁶⁴ rezulton se subjekti, me kontratën e datës 10.12.2012, ka blerë nga shtetasi R. F. automjetin tip “Fiat Punto”, me targa ***, vit prodhimi 2001, në vlerën 1.500 euro, e cila deklarohet në kontratë se është likuiduar 100%. Vetë shitësi R. F. e ka blerë këtë automjet me kontratën nr. ***, datë 24.5.2002, me çmim 200.000 lekë.

5.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁶⁵, subjekti sqaroi se burim krijimi për këtë automjet kanë shërbyer kursimet nga paga e gjyqtarit dhe shuma e kredisë në vlerën 300.000 lekë, e përfituar në prill të vitit 2012.

5.4. Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare në datën 10.12.2012, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, si në tabelën vijuese, nga ku rezultoi një balancë pozitive.

Tabela nr. 1 – analiza financiare datë 10.12.2012

Përshkrimi	Vlera
Automjet tip “Fiat Punto”, vit prodhimi 2001, me targa *** (subjekti) ⁶⁶	209,580
Shtim/pakësim likuiditete bankë	146,752
Total ndryshimi i likuiditeteve	356,332
Kredi konsumatore “Tirana Bank”, 300.000 lekë, datë 8.5.2012	300,000
Total detyrime	300,000
Të ardhura nga pagat e subjektit ⁶⁷	864,389
Total të ardhura	864,389
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT ⁶⁸	132,798
Shpenzime qiraje në Vlorë (subjekti)	120,000
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë “ProCredit Bank” (interes, principal, komisione etj.)	90,962
Shpenzime kredia e marrë pranë “Tirana Bank”	300,000
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë “Tirana Bank” (interes, principal, komisione etj.)	79,929
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	44,871
Total shpenzime	768,560
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - ndryshim likuiditete - shpenzime)	39,497

5.5. Më tej, në DIPP-në e vitit 2015, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit në vlerën 1.000 euro, çka konfirmohet edhe nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja, konkretisht referuar kontratës nr. ***, datë 8.10.2015, çmimi 1.000 euro⁶⁹, blerës R. F.. Kjo vlerë u pasqyrua si e ardhur në analizën financiare të vitit 2015.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020.

⁶⁵ Përgjigjet e përcjella me email datë 22.12.2022.

⁶⁶ Diferenca midis gjendjes së llogarive të subjektit në datën 10.12.2012 me atë të datës 31.12.2011.

⁶⁷ Pagat e kredituara në “Tirana Bank” dhe në “Credins Bank” për periudhën 1.1.2012 – 10.12.2012.

⁶⁸ Përlllogaritur për 11.3 muaj.

⁶⁹ Në kontratë parashikohet se çmimi është likuiduar 100%.

5.6. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit R. F. dhe R. F. Nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit me këta shtetas⁷⁰.

5.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targa ***, në vlerën 1.500 euro, si dhe nuk konstaton problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

PASURITË E BASHKËJETUESËS SË SUBJEKTIT

6. Përdorimi i automjetit tip “Golf 5”, me targa ***

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/E. L. ka deklaruar automjet tip “Golf”, me targa ***, ngjyrë gri, në përdorim. Si burim krijimi ka deklaruar kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.4.2009, autorizim nr. ***, datë 17.9.2010, pranë noteres Sh. Gj., deklaratë konfirmuese e njehsuar, lëshuar në datën 10.10.2016. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷¹.

6.2. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, të administruar edhe nga DPSHTRR-ja⁷², rezulton se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.4.2009, shtetasi G. L. ka blerë nga shtetasi A. P. automjetin tip “Volkswagen Golf”, vit prodhimi 2005, me çmim blerjeje 13.000 euro, i cili në kontratë parashikohet se është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në vijim, nëpërmjet dokumentit “autorizim”, shtetasi G. L. ka autorizuar shtetasit F. Q. dhe E. L. që për një periudhë kohe të pacaktuar ta përdorin automjetin e mësipërm brenda dhe jashtë vendit. Në fund të autorizimit pasqyrohet shënimi nga noteri “autentifikim nënshkrimi”, nr. ***, datë 17.9.2010. Personi i lidhur/E. L. ka deklaruar në pyetësin standard se prindërit e saj jetojnë jashtë Shqipërisë që prej tetorit të vitit 2010⁷³, çka konfirmohet nga sistemi TIMS⁷⁴.

6.3. Rezulton se me deklaratën e datës 10.10.2016, të firmosur përpara noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, shtetasi G. L. deklaroi se konfirmon deklaramet në lidhje me përdorimin e automjetit tip “Golf”, me targa ***, referuar autorizimit nr. ***, datë 17.9.2010.

6.4. Në dosjen e automjetit të përcjellë nga DPSHTRR-ja, konstatohet prokura e datës 27.7.2019, e hartuar përpara noterit publik në New Jersey (SHBA), me anë të së cilës shtetasi G. L. ka autorizuar vajzën e tij E. L. dhe shtetasin R. L. që në emrin e tij të kryejnë çdo veprim në lidhje me pagimin e taksave dhe lejen e qarkullimit.

6.5. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësin standard⁷⁵ se ky automjet është përdorur edhe nga ana e tij.

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 12.12.2022, e Gjykatës së Apelit Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr.*** prot., datë 20.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁷¹ Autorizim nr. ***, datë 17.9.2010; kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.4.2009; praktika e automjetit nga pala shitëse A. P.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020.

⁷³ Përgjigje e pyetjes nr. 2.

⁷⁴ Për shtetasin G. L. rezultoi dalje nga Rinasi në datën 22.9.2010 dhe hyrja më e afërt në datën 22.7.2012. Për shtetasen V. L. rezultoi dalje nga Rinasi në datën 22.9.2010 dhe hyrja më e afërt në datën 7.4.2011. Më tej është vijuar me hyrje - dalje të tjera, me periudha të shkurtra qëndrimi në territorin shqiptar.

⁷⁵ Email datë 27.7.2020, ku konkretisht ka deklaruar se: “*Duke filluar nga muaji gusht i vitit 2013 dhe deri në muajin tetor të vitit 2015 kam përdorur për arsye pune sendin e luajtshëm të llojit ‘automjet’, tip ‘Golf 5’ me targa ***, i cili rezultoi në pronësi të vjehrrit tim, z. G. L., i cili me anë të deklaramit noteriale nr. ***, datë 17.9.2010, rezultoi të ketë lëshuar autorizim përdorimi për bashkëshorten time, znj. E. L.*”.

6.6. Nga verifikimi i faqes elektronike të AMF-së nuk u konstatuan automjete të tjera në përdorim apo në pronësi të subjektit dhe personit të lidhur/E. L., të cilat nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 apo në deklaratimet periodike vjetore.

6.7. Sa më lart, në kushtet kur nga hetimi administrativ nuk konstatohen rrethana të cilat referojnë apo hedhin dyshime për të drejta të tjera të subjektit apo personit të lidhur, të ndryshme nga ajo e përdorimit, si dhe duke konsideruar se: (i) periudha kur shtetasi G. L. është larguar nga Shqipëria për të jetuar jashtë vendit përkon me momentin e lëshimit të autorizimit për përdorim; (ii) shtetasi G. L. e ka blerë automjetin në datën 29.4.2009 (përpara se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/E. L. të emërohen në detyrë) – Komisioni nuk konstaton problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit për këtë pasuri.

6.8. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

7. Gjendje llogarie bankare në vlerën 3.640,85 lekë, në “Credins Bank”

7.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/E. L. ka deklaruar: “*Gjendje e llogarisë bankare ditën e deklaratimit, datë 25.1.2017, të ‘Credins Bank’ në vlerën 3.640,85 lekë, referuar gjendjes së llogarisë datë 20.1.2017*”. Nuk deklaroi burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷⁶.

7.2. “Credins Bank”⁷⁷ konfirmon se personi i lidhur/E. L. disponon llogari rrjedhëse pranë kësaj banke dhe se balanca e kësaj llogarie në datën 23.1.2017 ka qenë në vlerën 3.640,85 lekë.

7.3. Nga shqyrtimi i lëvizjeve rezulton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat e personit të lidhur si gjyqtare.

7.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

8. Shumë të hollash në vlerën 10.000 euro

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/E. L. ka deklaruar shumë të hollash në vlerën 10.000 euro, me pjesë takuese 100%. Si burim krijimi ka deklaruar: të ardhura të krijuara nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 25.3.2010, deklaratë konfirmuese e njehsuar, lëshuar në datën 10.10.2016 (kontrata e shitblerjes të apartamentit me nr.***, datë 25.3.2010, pranë noterës I. Sh., dokument i cili është vënë në dispozicion në momentin e deklaratës fillestare të E. G. L.; të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr.***, datë 11.10.2010, me qira mujore 1.500 euro për familjen, e cila është revokuar në datën 4.8.2014 me deklaratën nr. ***, ku nga llogaria bankare me nr. *** të klientit G. L. autorizohet tërheqja nga babai pranë “Raiffeisen Bank”; deklaratë konfirmuese e njehsuar, lëshuar në datën 10.10.2016; transfertë bankare nga babai, ku nga llogaria bankare me nr. *** të klientit G. L. autorizohet tërheqja nga babai pranë

⁷⁶ Lëvizjet në llogarinë pranë “Credins Bank” për periudhën 3.11.2013 – 6.10.2016; lëvizjet në llogarinë pranë “Credins Bank” për periudhën 4.1.2017 – 23.1.2017.

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2020.

“Raiffeisen Bank”, ku burimi i krijimit është paga në SHBA, pasi është rezident, bashkëngjitur taksat⁷⁸. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷⁹.

8.2. Nga analizimi i deklaratave të interesave privatë, konstatohet se:

- Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2013, personi i lidhur/E. L. ka deklaruar *shumë të hollash në vlerën 60.000 euro* dhe tek rubrika e dokumenteve justifikuese, me përshkrimin “kontrata e shitblerjes së apartamentit me nr. ***, datë 25.3.2010, notere I. Sh., nga babai”.

- Në DIPP-në e vitit 2014, lidhur me burimin e pasurisë apartament, personi i lidhur ka deklaruar: “[...] 15.000 euro, të cilat i kam disponuar dhe që burimi i krijimit është babai im, është shitur apartamenti banesë e përbashkët [...]”. Më tej, në të njëjtën DIPP, personi i lidhur/E. L. ka deklaruar: “(i) gjatë vitit 2014 kam tërhequr 8.346 euro dhe 7.000 USD, llogaria bankare nr. ***, klienti G. R. L., ku autorizohet tërheqja nga babai pranë ‘Raiffeisen Bank’; (ii) gjatë vitit 2014 kam derdhur 1.600 dollarë, llogaria bankare nr. ***, klienti G. L., ku autorizohet tërheqja nga babai pranë ‘Raiffeisen Bank’”.

- Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar: “Shlyerje e kredisë bankare në tetor 2016, të ardhura nga babai, shtetasi G. R. L., të ardhura të krijuara nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 25.3.2010, deklaratë konfirmuese e lëshuar në datën 10.10.2016, në vlerën 5.369.316,9 lekë”. Siç rezultoi nga hetimi (trajtuar në paragrafin 11 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht), shuma e depozituar në llogarinë bankare ishte 40.000 euro. Po në këtë deklaratë, lidhur me burimin e automjetit me vlerë 400.000 lekë, subjekti ka deklaruar: “[...] nga bashkëjetuesja, të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr. ***, datë 11.10.2010 [...]”.

8.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁸⁰, në lidhje me likuiditetet *cash* të disponuara nga bashkëjetuesja, subjekti shpjegoi si në vijim:

- Për sa i përket gjendjes në datën 31.12.2014, subjekti shpjegoi se shuma fillestare prej 60.000 euro është pakësuar në momentin e pagimit të këstit të parë në mars të vitit 2014 dhe në çastin e shlyerjes së kredisë në tetor të vitit 2016. Më tej, gjatë vitit 2014 bashkëshortja ka tërhequr

⁷⁸ *Shënim*: Në lidhje me tërheqjen e realizuar në datën 4.11.2016, në vlerën 2.200 USD, ky veprim është kryer për të përmbushur detyrimet financiare në lidhje me kërkesën për rivlerësimin e pasurisë, pra në emër dhe për llogari të babait. Bashkëngjitur procedura pranë ZVRPP-së Tiranë dhe *statementi* bankar pranë “Raiffeisen Bank”, si dhe mandatarkëtimi për derdhje në arkë pranë “Credins Bank”.

⁷⁹ Kontratë shitblerje nr. ***, datë 25.3.2010, me palë shitëse G. L. i dhe palë blerëse M. Sh.; deklaratë datë 10.10.2016, G. L.; kontratë qiraje nr. ***, datë 11.10.2010, me palë qiradhënëse G. e V. L. dhe palë qiramarrëse shoqëria “****” sh.p.k.; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 16.2.2007, për magazinë ambalazhi qelqi me sip. 450 m² dhe truall me sip. 450 m², rr. “****”, Tiranë, z. k. ***, në pronësi të shtetasit G. L.; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 6.6.2008, për truall me sip. 629 m², rr. “****”, Tiranë, z. k. ***, në pronësi të shtetasit G. L.; vërtetim hipotekor nr. ***, datë 29.4.2008, për truall me sip. 243 m², rr. “****”, Tiranë, z. k. ***, në pronësi të shtetasit G. L.; prokurë e posaçme nr. ***, datë 21.9.2010, ku shtetasi G. e V. L. emërojnë përfaqësuese E. L. për administrimin e pronave: (1) ndërtesë, magazinë ambalazhi qelqi me sip. 450 m² dhe truall me sip. 450 m², rr. “****”, Tiranë; (2) truall me sip. 629 m², rr. “****”, Tiranë; (3) truall me sip. 243 m², rr. “****”, Tiranë, të hyjë në bisedime me shoqërinë “****” sh.p.k. për dhënie me qira, të vendosë për kushtet e kontratës dhe të kryejë procedurat e nevojshme; dokumentacion bankar për të vërtetuar pagesën e tatimit mbi qiranë; deklaratë për revokim kontrate nr. ***, datë 4.8.2014, ku shtetasi G. e V. L. dhe shoqëria “****” sh.p.k. revokojnë kontratën e qirasë nr. ***, datë 11.10.2010; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.10.2016 dhe datë 20.1.2017, për shtetasin G. L. (llogari nr. *** në USD); nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, datë 21.10.2016 dhe datë 20.1.2017, për shtetasin G. L. (llogari nr. *** në euro); dokumentacion të ardhurash për shtetasit G. L. dhe V. L. në SHBA për vitet 2013 – 2016; kërkesë në ZVRPP-në Tiranë, datë 2.11.2016, për rivlerësim pasurie + praktika; prokurë e posaçme nr. ***, datë 21.9.2010, ku shtetasi V. (G.) L. emëron përfaqësuese E. L. ta përfaqësojë në të gjitha shkallët e gjyqimit në çështjen civile, me objekt “njohjen si pronar për katin e dytë të magazinës ambalazh qelqi, të ndodhur në ***, me sip. 750 m², regjistrimin në ZVRPP dhe detyrimin e të paditurve, ZVRPP Tiranë dhe ZQRPP, për të kthyer shumën e përfitur për shkak të ligjshëm (begatim pa shkak) prej 2.282.880 lekësh”.

⁸⁰ *Email* datë 22.12.2022.

nga llogaria bankare e babait shumat 8.346 euro dhe 7.000 USD, si dhe ka derdhur shumën 1.600 USD.

- Për sa i përket gjendjes në datën 31.12.2015, subjekti konfirmoi se nuk ka ndryshime sipas deklaratave vjetore.

- Për sa i përket gjendjes në datën 31.12.2016, subjekti shpjegoi se vlera 10.000 euro, e disponuar nga bashkëjetuesja, është rezultat i ndryshimeve të likuiditeteve sipas shtesave dhe ndryshimeve në deklaratën periodike: (i) pakësim të likuiditeteve për shkak të shlyerjes së kredisë, në masën 5.369.316,9 lekë; (ii) pakësim të likuiditeteve për shkak të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në vlerën 400.000 lekë.

8.4. Lidhur me përdorimin e shumave të tërhequra nga ana e bashkëjetueses nga llogaria e babait të saj në vitin 2014, subjekti deklaroi: “*Deklaroj se arsyet e tërheqjes janë të karakterit personal dhe familjar të bashkëshortes. Kanë kaluar 8 vjet dhe është e pamundur të identifikoj arsyet e tërheqjes*”.

8.5. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar qartësisht në DIPP-në e vitit 2016 nëse për blerjen e automjetit në vlerën 400.000 lekë janë pakësuar shumat e deklaruara në DIPP-në e vitit 2014 (8.346 euro dhe 7.000 USD). Gjithashtu, nga analizimi i llogarive bankare të babait të personit të lidhur/E. L., nuk konstatohen tërheqje në janar të vitit 2016.

8.6. Sa më sipër, Komisioni përpiloi tabelën e ecurisë së gjendjes së kursimeve *cash* të subjektit dhe personit të lidhur, të paraqitura në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2 – analizë e ecurisë së gjendjes së kursimeve në *cash* të subjektit dhe personit të lidhur

Viti	Deklaruar në DIPP	SUBJEKTI (valutë EUR)			PERSONI I LIDHUR					
		Shtesë	Pakësim	Progressive	Valuta EUR			Valuta USD		
					Shtesë	Pakësim	Progressive	Shtesë	Pakësim	Progressive
Para fillimit 2013	Personi i lidhur: Shumë të hollash në vlerën 60.000 euro	-	-	0 €	60,000 €	-	60,000 €	-	-	\$0
Vjetore 2013	Nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje	-	-	0 €	-	-	60,000 €	-	-	\$0
2014	Lidhur me burimin e pasurisë apartament, personi i lidhur ka deklaruar: “[...] 15.000 euro të cilat i kam disponuar dhe që burimi i krjimit është babai im, është shitur apartamenti banesë e përbashkët [...]”	-	-	0 €	-	15,000 €	45,000 €	-	-	\$0
	Personi i lidhur: Gjatë vitit 2014 kam tërhequr, 8.346 euro dhe 7.000 dollarë, llogaria bankare nr.***, klienti G.L. ku autorizohet tërheqja nga babai, pranë Raiffeissen Bank	-	-	0 €	8,346 €	-	53,346 €	\$7,000	-	-
	Personi i lidhur: Gjatë vitit 2014 kam derdhur 1.600 dollarë, llogaria bankare nr. *** klienti G.L.	-	-	0 €	-	-	53,346 €	-	\$1,600	\$5,400
2015	Subjekti ka deklaruar në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krjimit”: “Të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit me kontratën me nr.*** kol, datë *** rep., datë 8.10.2015. Vlera 1.000 euro”.	1,000 €	-	1,000 €	-	-	53,346 €	-	-	\$5,400
2016	Lidhur me burimin e automjetit subjekti ka deklaruar [...] Nga bashkëjetuesja, të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr.*** rep, nr.*** kol, dt. 11.10.2010 [...] - Subjekti nuk ka deklaruar qartësisht.	-	-	1,000 €	-	-	53,346 €	-	-	\$5,400
	Subjekti dhe personi i lidhur: Shlyerje e kredisë bankare tetor 2016, të ardhura nga babai shtetasi G.L., të ardhura të krijuara nga kontrata e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol, datë 25.3.2010, deklaratë konfirmuese e lëshuar në datë 10.10.2016, vlerë 5.369.316,9 lekë	-	-	1,000 €	-	40,000 €	13,346 €	-	-	-
Deklaruar në vetting					1,000 €		10,000 €			\$0
Diferenca					0 €		3,346 €			\$5,400

8.7. Referuar përlllogaritjeve të mësipërme, për sa i përket likuiditeteve *cash* të disponuara nga personi i lidhur/E. L., duket se ka mospërputhje midis vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting* (10.000 euro) dhe asaj të rezultuar nga përlllogaritjet në DIPP-të vjetore (13.346 euro dhe 5.400 USD).

8.8. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se *për sa i përket likuiditeteve cash të disponuara nga personi i lidhur/E. L. ka mospërputhje midis vlerës së deklaruar në deklaratën Vetting (10.000 euro) dhe asaj të rezultuar nga përlllogaritjet e bazuara në deklaramet në DIPP-të vjetore (13.346 euro dhe 5.400 USD).*

8.9. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁸¹, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo mospërputhje mund të vijë si pasojë e mospasqyrimin të pakësimit të likuiditetit, siç është blerja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në analizën e ecurisë së gjendjes së kursimeve *cash* të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit. Në vijim, sqaron se shumata të tërhequra nga personi i lidhur (bashkëshortja E. L.) nga llogaria bankare e babait të saj kanë pasur si burim të ardhura të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, shpjegon se duhet pasur parasysh se shumata e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, e cila buron nga të ardhura të ligjshme, është më e vogël se ajo e përlllogaritur në analizën financiare (të konsideruara si të ligjshme nga Komisioni).

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

8.10. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

8.11. Në vijim të arsyetimit, në pikën nr. 2 të vendimit, pas pakësimit të gjendjes *cash* me 2.885 euro, Komisioni vëren se sërish ekziston një mospërputhje midis vlerës së likuiditeteve *cash* të deklaruara në deklaratën *Vetting* 2017 dhe asaj të rezultuar nga përlllogaritjet e bazuara në deklarimet në DIPP-të vjetore për të dyja shumata në valutë, konkretisht rezulton një diferencë prej 461 euro⁸² dhe 5.400 USD⁸³.

8.12. Megjithatë, Komisioni çmon se vetëm mospërputhja që vjen nga akumulimi potencial i shumave të deklaruara si *cash* në vite me vlerën e deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017, nuk provon pavërtetësinë e deklarimit të subjektit, për sa kohë që nga analiza financiare nuk kanë rezultuar diferenca negative për asnjërin prej viteve të deklarimit. Gjithashtu, nuk rezulton asnjë e dhënë e dalë gjatë deklarimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ në Komision se subjekti ka përdorur pasurinë e tij likuiditet për të krijuar ndonjë pasuri apo për të përballuar ndonjë shpenzim përgjatë periudhës që i është nënshtruar kontrollit.

8.13. Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁸⁴, në kushtet kur shpenzimi apo përdorimi i këtyre pasurive, të deklaruara *cash* dhe të justifikuara ligjërisht, nuk ka shërbyer si burim krijimi për asnjë pasuri të krijuar prej subjektit apo për të përballuar ndonjë transaksion

⁸¹ Email datë 23.2.2023.

⁸² Pas zbritjes së vlerës 2.885 euro mbetet një mospërputhje prej 461 euro (diferenca 3.346 euro me 2.885 euro).

⁸³ Diferencë e mbetur e pandryshuar nga ajo e pasqyruar në rezultatet e hetimit.

⁸⁴ Vendim nr. 28-2020 (JR), datë 23.10.2020, subjekti F. V.

financiar të kryer prej tij, situatë faktike e cila do të kërkonte domosdoshmërisht saktësinë e deklarimeve periodike të subjektit për vlerën e kësaj pasurie, sipas kërkesës së nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se pasaktësia e këtyre deklarimeve nuk afekton verifikimin e ligjshmërisë së burimit për të gjitha pasuritë e subjektit.

8.14. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka provuar bindshëm burimet e ligjshme të likuiditeteve *cash* të tij dhe ka provuar bindshëm vërtetësinë e deklarimeve të tij.

KONSTATIME TË TJERA

9. Adresat e banimit

9.1. Nga shqyrtimi i deklarimeve vjetore rezulton se subjekti, në deklaratën përpara fillimit të detyrës, datë 25.10.2010, ka deklaruar adresë regjistrimi në gjendjen civile “Njësia Administrative Nr. ***, rruga ‘***’, pallati nr. ***, Tiranë” dhe nuk deklaroi vendqëndrim tjetër. Më pas, në DIPP-të e viteve 2011 – 2013, përveç adresës së regjistrimit në gjendjen civile, ka deklaruar si vendqëndrim tjetër, adresë e plotë e banimit, adresën pas shkollës “***”, Vlorë. Në vijim, në DIPP-të e viteve 2014 – 2015, ka deklaruar si adresë të gjendjes civile “rruga ‘***’, Njësia nr. ***”, ndërsa si vendqëndrim tjetër, adresë banimi, “rruga ‘***’, kompleksi ‘***’, Tiranë”. Më pas, në DIPP-të e viteve 2016 - 2017, ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile “rruga ‘***’, kompleksi ‘***’, Tiranë” dhe si vendqëndrim tjetër “lagjja ‘***’, pallati ‘***’ pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

9.2. Në përgjigje të pyetësorit standard⁸⁵, subjekti ka deklaruar se nga momenti i emërimit si gjyqtar në datën 27.9.2010, deri në mars të vitit 2014, ka jetuar me prindërit dhe vëllain e tij R. F. në apartamentin e ndodhur në adresën: rruga “***”, pallati nr. ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, Tiranë. Gjithashtu, ka deklaruar se pronarë të këtij apartamenti janë prindërit e tij, të cilin e kanë blerë me kontratën noteriale nr. ***, datë 6.4.2000, që e ka paraqitur si provë.

9.3. Në vijim, deklaroi se nga marsi i vitit 2014 dhe aktualisht banon në apartamentin në rrugën “***”, kompleksi “***”, hyrja ***, kati ***, ap. ***, Tiranë.

9.4. DPGJC-ja⁸⁶ informon se në datën 20.2.2003 subjekti ka ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Kamëz, duke u vendosur në Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, në adresën: rruga “***”, pallati nr. ***, shkalla ***. Më pas sqaron se në datën 23.9.2016 ka ndryshuar vendbanimin brenda të njëjtës njësi, duke u vendosur në rrugën “***”, ndërtesa nr. ***, hyrja ***⁸⁷.

9.5. Ndërsa personi i lidhur E. L. në DIPP-në para fillimit të detyrës⁸⁸ dhe në DIPP-në e vitit 2013⁸⁹, përveç adresës së regjistrimit në gjendjen civile⁹⁰, ka deklaruar si vendqëndrim tjetër adresën rruga “***” pallati nr. ***, shk. ***, ap. ***, adresë e cila përkon me apartamentin në pronësi të prindërve të subjektit.

⁸⁵ Email datë 27.7.2020.

⁸⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2022.

⁸⁷ Gjithashtu, DPGJC-ja bën me dije se në datën 28.9.2016 shtetasja E. L. ka ndryshuar vendbanimin nga Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, duke u vendosur në Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, në adresën: rruga “***”, ndërtesa nr. ***, hyrja ***.

⁸⁸ Datë 13.1.2014.

⁸⁹ Dorëzuar në datën 31.3.2014.

⁹⁰ Rruga “***”, Njësia Nr. ***.

9.6. Sa më lart, me anë të pyetësoni nr. 1, Komisioni i kërkoi subjektin të rivlerësimit të sqaronte se kur e ka filluar bashkëjetesën me personin e lidhur/E. L.. Në përgjigje⁹¹, subjekti i rivlerësimit konfirmoi deklaratimet e mëparshme lidhur me fillimin e bashkëjetesës në mars të vitit 2014. Ndërsa, në lidhje me adresën e vendosur në deklaratë nga ana e personit të lidhur, shpjegoi se ajo është vendosur me qëllim njoftimin e personit të lidhur, pasi ka qenë adresë e saktë për efekt komunikimi me institucionin e ILDKPKI-së. Më tej, subjekti i rivlerësimit sqaroi se personi i lidhur në këtë periudhë ka qenë në marrëdhënie qiraje, fakt i cili provohet edhe nga ekstrakti bankar i personit të lidhur pranë “Raiffeisen Bank”, nga ku është realizuar shlyerja e detyrimeve përkundrejt qiradhënësit⁹².

9.7. Për sa i përket dokumentacionit lidhur me adresën e banimit në Tiranë, rezulton se sipas kontratës noteriale nr. ***, datë 6.4.2002, paraqitur nga subjekti, si dhe e administruar nga ASHK-ja⁹³, shtetasit A. F. dhe V. F. kanë blerë një apartament me adresë rruga “****”, pallati nr. ***, shkalla ***, apartamenti nr. ***, kati ***, i përbërë nga 2 dhoma e 1 kuzhinë dhe ambiente të tjera ndihmëse, me sip. 75 m², i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, kundrejt çmimit 1.900.000 lekë⁹⁴.

9.8. Për sa i përket dokumentacionit lidhur me banesat e banimit në qytetin e Vlorës, në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar se:

i) Gjatë periudhës janar 2012 – mars 2015 ka jetuar bashkë me kolegun e tij, shtetasin F. K., në apartamentin e marrë me qira të ndodhur në adresën lagjja “****”, rruga “H. H.”, Vlorë, në pronësi të shtetasit I. A., kundrejt qirasë mujore prej 20.000 lekësh, ku secili paguante në mënyrë të barabartë 10.000 lekë, pagesë e cila bëhej tek shtetasi B B. (kunati i pronarit). Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti ka paraqitur në pyetësonin standard deklaratën noteriale nr.***, datë 7.7.2020, ku shtetasi B. B. ka deklaruar: “[...] në janarin e vitit 2012 kemi rënë dakord verbalisht që të jap shtëpinë në pronësi të kunatit tim, z. I. F. A., të ndodhur në Vlorë, me adresë: lagjja “****”, pallati i ri, pranë shkollës së mesme “****” ...e tipit 2 + 1, kati i shtatë nga toka, të mobiluar me pajisjet bazike për jetesë, tek qiramarrësit, z. F. K. dhe z. Laurent Fuçia. Shuma e qirasë ka qenë 20.000 lekë dhe parapaguhej çdo fillim muaji. Nuk e kemi formalizuar kontratën e qirasë me shkrim dhe çdo detyrim i qiramarrësve është përmbushur në kohë. Kjo marrëdhënie qiraje ka zgjatur deri në muajin mars të vitit 2015”.

Nga verifikimi në sistemin elektronik të ASHK-së rezulton se shtetasi I. F. A. figuron pronar i apartamenteve me nr. pasurie: ***, në z. k. ***, me adresë Vlorë.

ii) Gjatë periudhës mars 2015 – aktualisht banon në apartamentin e marrë me qira nga shtetasit Sh. H., Xh. H. dhe R. H., kundrejt qirasë mujore prej 10.000 lekësh/muaj⁹⁵, të ndodhur në adresën: lagjja “****”, rruga “****”, pallati “****”, shkalla ***, apartamenti nr. ***, Vlorë. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti paraqiti kontratën noteriale nr. ***, datë 17.10.2016, sipas së cilës subjekti ka marrë me qira apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 45.2 m²,

⁹¹ Përgjigjet e përcjella me email, datë 22.12.2022.

⁹² Në përgjigje të pyetësonit standard, personi i lidhur ka deklaruar se nga momenti i emërimit si gjyqtare dhe deri në mars të vitit 2014 ka banuar në apartamentin e ndodhur në adresën rruga “****”, Tiranë, si dhe ka deklaruar se pronar i kësaj banese ka qenë shtetasi D. R. (R.) H. ndaj të cilit ka paguar qiranë nëpërmjet transaksioneve bankare pranë “Raiffeisen Bank”, me ekstremite nr. ***. Më pas deklaroi se nga marsi i vitit 2014 dhe aktualisht banon në apartamentin e ndodhur në adresën: rruga “****”, kompleksi “****”, hyrja ***, kati ***, ap. ***, Tiranë.

⁹³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.9.2020, e ASHK-së Tirana Jug.

⁹⁴ Në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 21.2.2019, të shtetasit A. F., subjekti është bërë bashkëpronar i këtij apartamenti bashkë me vëllain e tij R. F. dhe nënën V. M.

⁹⁵ Subjekti deklaroi se pagesa e qirasë bëhej tek shtetasi E. H., djali i shtetasit Xh. H.

*Informacionin në lidhje me ekstremitetet e pasurisë po e marr nëpërmjet pyetjeve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në lidhje me nënshkrimin e kontratës nr. ***, datë 12.8.2010, sqaron se kjo kontratë është nënshkruar para emërimit përfundimtar (propozimi për emërim datë 14.11.2011) dhe emërimit në stazh profesional shtator 2010 - korrik 2011. Pra, kjo pasuri është transferuar para emërimit tim në detyrë dhe unë nuk e gëzoja cilësinë e pronarit në kohën e deklarimit. Babai im A. S. F. ka ndërruar jetë në tetor 2018, situatë e cila nuk më jep mundësi të jap shpjegime të detajuara në lidhje me këto pasuri. Në lidhje me këto pasuri, ju bëj me dije se as nëna ime V. M., as vëllai R. F. nuk janë në dijeni mbi ekzistencën e bashkëpronësisë mbi pasuritë: (i) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 3.000 m²; (ii) dhe nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 1.600 m². Gjithashtu, ju bëj me dije se mungesa e informacionit ka sjellë që të mos kemi asnjë dijeni mbi vendndodhjen konkrete, sipërfaqen, situatën faktike. Këto pasuri nuk i kemi poseduar apo administruar, pavarësisht gjendjes juridike të parashtruar nga ana juaj”.*

10.7. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime në lidhje me konstatimin se *subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting 2017 bashkëpronësinë e tij në pasuritë e llojit “arë”, në z. k. ***, Tiranë, me sipërfaqe totale 4.600 m², sipas parashikimeve në shtojcën 1 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimin nr. *** të ILDKPKI-së.*

10.8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰² subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në lidhje me këtë pasuri i qëndron përgjigjeve të dërguara në *email*-in e datës 22.12.2022, duke sqaruar edhe një herë se nuk ka qenë asnjëherë i informuar për AMTP-në e datës 3.5.1996 për shkak se në këtë periudhë ka qenë 10 vjeç. Në vijim sqaron se këtë pasuri nuk e ka poseduar, administruar apo gëzuar ndonjëherë. Informacionin në lidhje me ekstremitetet e pasurisë së sipërcituar e ka marrë nëpërmjet pyetësorit nr. 1 të dërguar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në lidhje me nënshkrimin e kontratës nr. ***, datë 12.8.2010 shpjegon se kjo kontratë është nënshkruar përpara emërimit përfundimtar dhe marrjes së cilësisë së gjyqtarit, për pasojë kjo pasuri është transferuar tek persona të tretë përpara emërimit të tij në detyrë, që do të thotë se subjekti nuk e gëzonte cilësinë e pronarit në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë përpara fillimit të detyrës.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

10.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

10.10. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, në nenin 24 të tij ka përcaktuar se: “*Kriteret për ndarjen, regjistrimin, ndryshimin, kalimin në pronësi, vlerësimin dhe dhënien me qira të tokës, si dhe detyrat e kadastrës caktohen nga Këshilli i Ministrave*”. Referuar pikës 2 të VKM-së Nr. ***, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, toka bujqësore është ndarë

¹⁰² *Email* datë 23.2.2023.

për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare në datën 1.8.1991. Në këto kushte, bazuar në nenet 4, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, shtojcën 1, të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. *** të ILDKPKI-së subjekti detyrohej të deklaronte pasuritë e paluajtshme, të përfituara në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, si dhe pjesën e tij takuese.

10.11. Kodi Civil në nenin 163 përcakton se: “*Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë*”. Si pasojë, është ligji nr. 7501/1991 që i ka njohur të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore subjektit të rivlerësimit për shkak se ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me babain e tij në datën 1.8.1991. Pavarësisht se subjekti shpjegon se nuk ishte në dijeni nëse e ka poseduar, administruar apo gëzuar ndonjëherë, fakti që në vitin 2010 ka nënshkruar aktin e shitblerjes nr. ***, datë 12.8.2010, në cilësinë e bashkëpronarit, për shitjen e pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sip. 1.000 m², shtetasit M. A., tregon se shpjegimi i subjektit nuk është bindës. Në kushtet e mosdeklarimit të pasurisë arë të përfitur në bazë të ligjit nr. 7501/1991, në bashkëpronësi, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk ka pasur si qëllim mbulimin e ndonjë shtate të dyshimtë, si dhe nga ana tjetër nuk vihet në dyshim burimi i krijimit të pasurisë dhe, për pasojë, kjo pasaktësi nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkak shkakimi për subjektin e rivlerësimit.

10.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 i pjesës takuese në tokën bujqësore të përfitur në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

11. Bashkëpronar në 2/81 pjesë në pasurinë e llojit “truall”, me sip. 250 m² dhe ndërtesë, me sip. 140 m², ndodhur në fshatin *, Tiranë, për shkak të trashëgimisë ligjore nga babai**

11.1. Subjekti e ka deklaruar për herë të parë bashkëpronësinë e tij në pasurinë e llojit “truall”, me sip. 250 m² dhe ndërtesë me sip. 140 m², fshati ***, Tiranë, në përgjigje të pyetësorit standard¹⁰³, ku ka deklaruar: “*Bashkëpronar në 2/81 pjesë në sendin e paluajtshëm të llojit ‘truall’, me sip. 250 m² dhe ndërtesë, me sip. 140 m², nr. ***, zona kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, ndodhur në fshatin ***, Tiranë, për shkak të trashëgimisë ligjore nga babai im, i ndjeri A. F., pasuri për të cilën kam ardhur në dijeni në datën 16.12.2019, në momentin e lëshimit të deklaratës noteriale nr. ***. Dhe për të cilën, me kontratën noteriale të dhurimit nr. ***, datë 4.3.2020, jam zhveshur nga pronësia (bashkëpronësia), duke i dhuruar pjesën time të pasurisë, xhaxhait tim, shtetasit P. F., në cilësinë e pranuesit të dhurimit*”.

11.2. Nga dokumentacioni i administruar nga notere A. S.¹⁰⁴ rezulton se në prokurën nr. ***, datë 25.4.2014, shtetasit Xh. F., A. F. etj. kanë deklaruar se janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerëve S. F. e M. F. dhe në emër të shtetasit S. F., familje bujqësore, rezulton e regjistruar pasuria e llojit “truall dhe ndërtesë”, me sip. truall 250 m² dhe ndërtesë 140 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, ***, Tiranë. Më pas deklarojnë se emërojnë si përfaqësues të posaçëm shtetasin

¹⁰³ Email datë 27.7.2020.

¹⁰⁴ Shkresë datë 30.11.2022.

M. F. që të lidhë dhe nënshkruajë kontratën e dhurimit, me objekt “tjetërsimi i pjesëve të tyre ideale mbi pasurinë e mësipërme në favor të shtetasit P. F.”. Në vijim, me prokurën nr. ***, datë 25.4.2014, shtetasit e mësipërm, pasi deklarojnë se në emër të shtetasit S. F. rezulton e regjistruar pasuria e llojit “truall dhe ndërtesë” me sipërfaqe trualli 250 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 90 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, emërojnë si përfaqësues të tyre shtetasin Sh. F. të lidhë dhe të nënshkruajë kontratën e dhurimit, me objekt “tjetërsimi i pjesëve të tyre ideale në favor të shtetasit M. F.”.

11.3. Nga dokumentacioni i paraqitur në pyetësoin standard, të administruar edhe nga notere S. T.¹⁰⁵, rezulton se sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 21.2.2019, në datën 9.10.2018 ka ndërruar jetë shtetasi A. F. dhe trashëgimtarë ligjorë të tij figurojnë shtetasit V. M. bashkëshortja, R. F. i biri dhe Laurent Fuçia i biri.

11.4. Më pas, rezulton se me deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.12.2019, shtetasit V. M., R. F., Laurent Fuçia etj.¹⁰⁶ kanë deklaruar se kanë përfituar si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerëve S. F. dhe A. F. pasurinë e llojit “truall” me sip. 250 m², e ndodhur në ***, Tiranë, në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me nr. pasurie ***. Gjithashtu kanë deklaruar se pasuria e mësipërme ka qenë në pronësi të të ndjerit S. F. por duke qenë se nga fëmijët e shtetasit S. F. ka ndërruar jetë i ndjeri A. F. janë futur në trashëgim fëmijët e të ndjerit, të cilët së bashku me personat e tjerë e trashëgojnë pasurinë në mënyrë të barabartë. Më pas deklarojnë se kanë humbur certifikatën e pronësisë së pasurisë së mësipërme dhe kanë kërkuar nga ZVRPP-ja të pajisen me certifikatë të re.

11.5. Me prokurën nr. ***, datë 16.12.2019, shtetasit V. M., R. F., L. F. etj., në cilësinë e bashkëpronarëve të pasurisë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, kanë emëruar si përfaqësues të përgjithshëm shtetasin R. H., që t’i përfaqësojë në kryerjen e veprimeve të ndryshme përpara organeve shtetërore.

11.6. Në vijim, konstatohet se me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 4.3.2020, shtetasit e mësipërm i kanë dhuruar shtetasit P. F. pasurinë e paluajtshme të llojit “truall” me sip. 250 m², ndërtesë me sip. 140 m² me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë ***, Tiranë. Bashkëlidhur kontratës konstatohet certifikata e pronësisë së pasurisë së mësipërme dhe lista e bashkëpronarëve, ku subjekti figuron bashkëpronar me pjesë 2/81.

11.7. Sa më sipër, në kushtet kur babai i subjektit të rivlerësimit ka ndërruar jetë datë 9.10.2018 dhe dëshmia e trashëgimisë është çelur në datën 21.2.2019, nuk konstatohen problematika lidhur me deklarimin e kësaj pasurie dhe të pjesës takuese në deklaratën *Vetting* 2017.

11.8. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

12. Shumat e dhuruara ndër vite nga prindërit dhe motra e personit të lidhur

12.1. Nga analizimi i DIPP-ve vjetore rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë përfituar dhurata në likuiditete *cash* në vlerën totale prej 4.586,76 USD, të deklaruara të dhuruara nga prindërit dhe motra e personit të lidhur (bashkëshortja e subjektit).

¹⁰⁵ Shkresë datë 17.11.2022.

¹⁰⁶ Shtetasit Sh. F., R. F., M. F., Xh. Sh., Q. Ll., H. S. dhe S. C..

12.2. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar në seksionin “dhurata dhe trajtime preferenciale”, shumën 3.586,76 USD me përshkrimin “Udhëtimi për në SHBA drejt familjes, biletat e avionit për deklaruesen E. L. dhe bashkëjetuesin Laurent Fuçia, si edhe qëndrimi në shtëpi apo udhëtimet pjesërisht, I., G. dhe V. L. (familjarët), shtetas rezident në SHBA, 2.586,76 USD biletat e avionit dhe 1.000 USD për udhëtimet e ndryshme”.

12.3. Në DIPP-në e vitit 2015 subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar në seksionin “dhurata dhe trajtime preferenciale” shumën 1.000 USD, me përshkrimin “dhuratë 1.000 USD nga prindërit dhe motra, të cilët erdhën me pushime në Shqipëri dhe qëndruan në shtëpinë time I., G. dhe V. L. (familjarët), shtetas rezident në SHBA”. Kjo shumë është deklaruar edhe në seksionin e të ardhurave të deklaratës *Vetting* të subjektit të rivlerësimit¹⁰⁷.

12.4. Në pyetëSORIN standard subjekti ka paraqitur dokumentacion provues, konkretisht dokumentacion lidhur me të ardhurat e përfituara në SHBA nga prindërit e bashkëshortes për vitet 2013 – 2017¹⁰⁸, si dhe biletat e avionit për udhëtimin në datat 6.8.2015 - 31.8.2015¹⁰⁹.

Dokumentacioni lidhur me të ardhurat është paraqitur në formën e kërkuar ligjore nga ana e bashkëshortes së subjektit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard, dorëzuar prej saj pranë Komisionit në datën 22.9.2022¹¹⁰.

12.5. Nga analizimi i këtij dokumentacioni konstatohet se gjatë vitit 2014 të ardhurat *bruto* të prindërve të bashkëshortes në SHBA kanë qenë në vlerën 73.747 USD¹¹¹. Referuar të dhënave statistikore¹¹², shpenzimet jetike gjatë vitit 2014 për një familje me 3 persona në SHBA kanë qenë 18.850 USD.

12.6. Ndërsa gjatë vitit 2015, të ardhurat *bruto* të prindërve të bashkëshortes në SHBA kanë qenë në vlerën 70.855 USD¹¹³. Referuar të dhënave statistikore, shpenzimet jetike gjatë vitit për një familje me 3 persona në SHBA kanë qenë në vlerën 18.871 USD.

12.7. Sa më lart, rezulton se prindërit e bashkëshortes kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhuruar subjektit dhe personit të lidhur shumat e deklaruara si dhurata në DIPP-të përkatëse, konkretisht 3.586,76 USD në vitin 2014 dhe 1.000 USD në vitin 2015.

¹⁰⁷ Subjekti ka deklaruar: “Dhuratë 1.000 USD nga prindërit dhe motra e bashkëjetueses, të cilët erdhën me pushime në Shqipëri dhe qëndruan në shtëpinë time në vitin 2015, referuar deklaratës për vitin 2015 të bashkëjetueses E. L.. Burimi i krijimit: të ardhurat si punëmarrës në SHBA. Bashkëngjitur taksat e familjes”.

¹⁰⁸ (1) Transkript i llogarisë nga IRS për vitet 2015 – 2019; (2) transkript për pagën dhe të ardhurat për G. L. për vitin 2014; (3) dokument mbi pagën *bruto* (1.628 USD), ndalesat, paga *neto* (1.135 USD), e G. L., pranë “****”, periudha deri më 15.9.2016; (4) deklaratë mbi të ardhurat personale të vitit 2015 (e tipit *joint* – e përbashkët për G. dhe V. L.); (5) formular mbi pagën dhe të ardhurat e G. L., viti 2015, punëdhënës “****”; (6) formular mbi pagën dhe të ardhurat e V. L., viti 2015, punëdhënës “****”; (7) formular mbi pagën dhe të ardhurat e G. L., viti 2015, punëdhënës “****”; (8) deklaratë mbi të ardhurat personale të vitit 2014 (e tipit *joint* – e përbashkët për G. dhe V. L.); (9) formular mbi pagën dhe të ardhurat e V. L., viti 2014, punëdhënës “****”; (10) formular mbi pagën dhe të ardhurat e G. L., viti 2014, punëdhënës “****”; (11) formular mbi pagën dhe të ardhurat e G. L., viti 2014, punëdhënës “****”; (12) deklaratë mbi të ardhurat personale të vitit 2013 (e tipit *joint* – e përbashkët për G. dhe V. L.); (13) formular mbi pagën dhe të ardhurat e V. dhe G. L., viti 2013, të ardhura nga “****”; (14) formular mbi pagën dhe të ardhurat e V. L., viti 2013, përfituar nga “****”; (15) formular mbi pagën dhe të ardhurat e G. L., viti 2013, përfituar nga “****”; (16) dokument mbi pagën *bruto* (1.550 USD), ndalesat, paga *neto* (1.138 USD), të G. L., pranë “****”, periudha deri më 30.9.2016.

¹⁰⁹ Email dërguar nga *** për G. L., me detajet e fluturimit Laurent Fuçia dhe E. L., vlera 2.586,76 USD.

¹¹⁰ Administruar me vendimin datë 1.12.2022, të Komisionit.

¹¹¹ Bazuar vetëm në ndalesat e pasqyruara në deklaratën mbi të ardhurat personale të vitit 2014 (e tipit *joint* – e përbashkët për G. dhe V. L.), të ardhurat *neto* duket të kenë qenë rreth 68.688 USD.

¹¹² www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html

¹¹³ Bazuar vetëm në ndalesat e pasqyruara në deklaratën mbi të ardhurat personale të vitit 2015 (e tipit *joint* – e përbashkët për G. dhe V. L.), të ardhurat *neto* duket të kenë qenë rreth 63.445 USD.

12.8. Më tej, Komisioni analizoi edhe deklaratimet e kryera në DIPP-në e vitit 2014, ku personi i lidhur/E. L. ka deklaruar se gjatë vitit 2014 ka tërhequr nga llogaria e babait vlerat 8.463 euro dhe 7.000 USD, si dhe ka depozituar vlerën 1.600 USD.

12.9. Referuar informacionit të përcjellë nga “Raiffeisen Bank”, tërheqjet në vlerën totale 8.463 euro kanë si burim transfertat e kryera nga shoqëria “****” sh.p.k. për pagesën e qirasë, ndërsa tërheqja në datën 9.7.2014, në vlerën 7.000 USD, ka si burim një transfertë nga llogaria bankare në SHBA¹¹⁴ e shtetasit G. L..

12.10. Në deklaratën e firmosur përpara noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, të datës 10.10.2016, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, shtetasi G. L.¹¹⁵ ka deklaruar: *“Shumat e parave në euro dhe USD, të cilat kanë qenë objekt i deklaratimit të pasurisë nga vajza ime për të cilat ajo ka pasur të drejtën e administrimit dhe tërheqjes dhe të cilat kanë rrjedhur si rezultat i kontratës së qirasë lidhur me subjektin ‘***’ sh.p.k. dhe transfertat nga të ardhurat familjare në SHBA, si dhe nga derdhjet e kryera në llogarinë time rrjedhëse në ‘Raiffeisen Bank’, konsiderohen pjesë e pasurisë së vajzës sime, E. L., pa asnjë kufizim tagrash pronësie duke u zhveshur unë nga çfarëdo e drejtë apo pretendimi në lidhje me këtë shumë”.*

12.11. Komisioni, bazuar në arsyetimin në paragrafin 1.15, arsyeton edhe një herë se pavarësisht faktit që dokumenti i mësipërm titullohet deklaratë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së tij vlerëson se qëllimi i këtij dokumenti ka qenë kalimi pa shpërblim i shumave të tërhequra nga ana e personit të lidhur/E. L. Nga ana tjetër, duke vlerësuar edhe sjelljen e shtetases E. L., nëpërmjet deklaratimit të këtyre shumave në DIPP-të vjetore dhe të deklaratimit të përdorimit të tyre për blerjen e automjetit, evidentohet pëlqimi i saj si palë pranuese. Si pasojë, dokumenti i mësipërm plotëson elementet e një kontrate dhurimi.

12.12. Sa më lart, analizës së kryer në paragrafin 12.5 lidhur me të ardhurat në SHBA dhe në paragrafët 2.9 - 2.10 lidhur me të ardhurat nga qiraja, duket se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e shumave 8.463 euro dhe 7.000 USD.

12.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

13. Lidhur me mungesën e deklaratimit nga ana e prindërve të subjektit në deklaratën *Vetting* 2017

13.1. DPGJC-ja¹¹⁶ informon se subjekti ka bërë shkëputjen nga trangu familjar, i përbërë nga nëna dhe babai¹¹⁷, në datën 23.9.2016.

13.2. Komisioni konstaton se në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* 2017, subjekti nuk ka depozituar deklarime veçmas mbi pasuritë, të ardhurat, detyrimet etj., për prindërit e tij, të cilët duke qenë pjesëtarë të trungut familjar bënin pjesë në rrethin e personave të lidhur dhe në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklarorin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private.

¹¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2022, nga “Raiffeisen Bank”.

¹¹⁵ Banues në New Jersey, me shtetësi shqiptare dhe amerikane.

¹¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022.

¹¹⁷ Vëllai i subjektit është shkëputur në datën 20.1.2015.

13.3. Nga hetimi administrativ i Komisionit rezultoi se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* 2017 nga subjekti, prindërit e tij dispononin vetëm një apartament¹¹⁸ me sip. 75 m², të blerë në datën 6.4.2002, me vlerë 1.900.000 lekë, ndërsa llogaritë bankare rezultuan me balanca zero. Referuar informacionit të përcjellë nga ISSH-ja¹¹⁹, i ndjeri babai i subjektit përfitonte pension pleqërie që prej muajit janar 2015, ndërsa nëna e subjektit që prej nëntorit të vitit 2013.

13.4. Gjithashtu, konstatohet se prindërit e subjektit nuk kanë rezultuar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit për ndonjë pasuri të krijuar gjatë detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

13.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

14. Analiza financiare

14.1. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar pasuri në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës së vitit 2010, çka u konfirmua edhe nga hetimi administrativ. Për këtë arsye, Komisioni kreu analizën financiare duke filluar nga data e emërimit të subjektit në detyrë, pra në datën 27.9.2010.

14.2. Analiza financiare u krye: (i) për periudhën 26.9.2010 – 31.12.2013, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për subjektin e rivlerësimit¹²⁰; (ii) për periudhën 2014¹²¹ – 2016, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesen e tij.

14.3. Gjithashtu, në kushtet që subjekti ka deklaruar se ka jetuar me prindërit nga momenti i fillimit të detyrës deri në momentin e fillimit të bashkëjetesës me personin e lidhur/E. L., Komisioni kreu një analizë financiare veçmas për prindërit dhe vëllain e subjektit, për periudhën 27.9.2010 – 31.12.2013, nga ku nuk rezultuan mungesa të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve.

14.4. Ndërsa analiza financiare¹²² për subjektin dhe personin e lidhur paraqitet e përmbledhur në tabelën vijuese, duke u saktësuar ndryshimi i likuiditeteve *cash* për vitin 2016, sipas arsyetimit në pikën 2 të vendimit.

Tabela nr. 3 – analiza financiare

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
27.9.2010 – 31.12.2010	0	0	0	140,762	0	72,071	68,692
2011	0	0	-198,126	809,669	0	273,420	734,375
2012	209,580	0	99,475	873,389	300,000	776,786	87,548
2013	0	0	124,912	1,012,812	0	569,512	318,388
2014	7,700,000	8,083,014	30,495	12,548,300	5,640,000	2,326,909	47,882
2015	0	139,450	348,859	2,273,020	0	1,350,327	434,383
2016	400,000	-6,000,092	-352,759	2,032,015	0	6,386,578	1,598,287
TOTAL	8,309,580	2,222,372	52,856	19,689,967	5,940,000	11,755,603	3,289,555

¹¹⁸ Trajtuar në seksionin e adresave të banimit.

¹¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2020.

¹²⁰ Në pyetësin standard subjekti ka deklaruar: “Për këtë periudhë kohore (duke iu referuar periudhës 27.9.2010 - deri në muajin mars të vitit 2014), shpenzimet e jetesës i kam përballuar me të ardhurat e mia, të cilat vinin nga paga e gjyqtarit apo aktivitete të tjera jashtëgjyqësore”.

¹²¹ Analiza financiare u krye e përbashkët për subjektin dhe personin e lidhur duke filluar që nga janari 2014 (dhe jo mars 2014), në kushtet që deklarata e personit të lidhur pasqyron ndryshimet në interesa private për të gjithë vitin kalendarik 2014.

¹²² Subjektit iu vendos në dispozicion së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, edhe aneksi nr. 1, me emërtim “analiza financiare e detajuar” dhe aneksi nr. 2 me emërtim “metodika e analizës financiare”.

14.5. Në përfundim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në fund të secilit vit kalendarik.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

15. Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara në procesin e rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e pasurisë në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në kreun IV të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

16. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

17. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

18. DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2022, informon se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin dhe, si pasojë, nuk ndryshon konstatimi fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

19. Komisioni, në vijim si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi nuk u gjet ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

20. Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i

rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

21. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

22. Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

23. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (d) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

24. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit bashkë me 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

25. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit nga shtatori i vitit 2010 deri në korrik të vitit 2011 ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në dhjetor të vitit 2011 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me vendimin e datës 7.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur komandimin në skemën e delegimit të subjektit Laurent Fuçia dhe caktimin e tij në Gjykatën e Apelit Vlorë¹²³. Më pas, me vendimet e datave 29.9.2021¹²⁴ dhe 4.10.2022¹²⁵, KLGJ-ja ka vendosur zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Vlorë. Me ndërprerjen e veprimtarisë së Gjykatës së Apelit Vlorë në datën 31.1.2023¹²⁶, subjekti i rivlerësimit vazhdon funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

26. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor. Në 3 dokumentet ligjore

¹²³ https://***/

¹²⁴ https://***/

¹²⁵ https://***/

¹²⁶ Vendim nr. ***, datë 21.11.2022, i KLGJ-së.

dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka aftësi në arsyetimin ligjor. Respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, por jo gjithmonë janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Hetimi i Komisionit

27. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me 5 dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dokumentin 2 të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dosjet 1 e 3, të shortuara si vijon:

28. Lidhur me dokumentin nr. 2, që i përket vendimit civil nr. ***, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që i përket palëve: paditësit P. Ç., me të paditur AKKK Tiranë, me objekt “saktësimi i kufijve dhe hartës treguese që i përket vendimit nr. ***, datë 6.12.1994, të KKP Bashkia Vlorë”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka identifikuar natyrën e mosmarrëveshjes, si dhe nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, sipas parashikimeve në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile.*

29. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁷ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga ana e ish-KKKP-së Bashkia Vlorë është disponuar për njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin në favor të paditësit të një sipërfaqeje toke truall më të vogël sesa gjendja faktike, e cila ka ndodhur për shkak të gabimit në konvertimin e njësisë matëse, nga “vreten” në “m²” në hartën treguese dhe planvendosjen e vendimit të Komisionit. Në këto rrethana, vijon sqarimin subjekti i rivlerësimit, duke qenë se pretendimet e paditësit nga pikëpamja e të drejtës kanë konsistuar në saktësimin e gabimit të dokumenteve që shoqërojnë vendimin nr. ***, datë 6.12.1994, të ish-KKKP-së Bashkia Vlorë (hartat treguese dhe planvendosja) dhe jo në lidhje me përmbajtjen e këtij vendimi, nga ana e gjykatës është vendosur pranimi i padisë, duke bërë edhe saktësimin përkatës të këtyre akteve. Gjithashtu, shpjegon se një vendimmarrje e tillë ka ardhur pas cilësimit të saktë të fakteve objekt mosmarrëveshje, si dhe pas identifikimit të shkakut ligjor të padisë, duke garantuar kështu të drejtën e paditësit për akses në gjykatë, në funksion të garantimit të së drejtës së tij themelore të pronësisë. Për sa i përket vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes pasi ndodhet përpara një padie që nuk mund të ngrihej, vlerëson se ky vendim është marrë konform gërmës “c” të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, dispozitë e cila nuk ka qenë në fuqi në momentin e dhënies së vendimit nr. ***, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹²⁷ Email datë 23.2.2022.

Analiza e Komisionit

30. Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 20.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se paditësi është trashëgimtar ligjor i subjektit të shpronësuar, të ndjerit N. Ç.. Ish-KKKP Bashkia Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 6.10.1994, ka vendosur njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin në favor të trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar N. Ç. të sip. 1.445 m², tokë truall, ndodhur në qytetin e Vlorës. Paditësi ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “saktësimi i kufijve dhe hartës treguese që i përket vendimit nr. ***, datë 6.12.1994, të KKP Bashkia Vlorë”, duke pretenduar se në vendimin nr. ***, datë 6.10.1994, të ish-KKKP-së Bashkia Vlorë për shkak të gabimit në konvertimin e njësisë matëse të “vretenit” me “m²”, është kthyer një sipërfaqe trualli më e vogël sesa gjendja faktike. Në përfundim të gjykimit, subjekti, me vendimin nr. ***, datë 20.1.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë. Saktësimin e kufijve, të sipërfaqes dhe planvendosjes së truallit të vendimit nr. ***, datë 6.12.1994, të ish-KKKP-së Bashkia Vlorë, duke i njohur të drejtën e pronësisë së paditësit, krahas sipërfaqes prej 1445 m², edhe për sipërfaqen prej 449 m², sipas aktekspertimit të ndodhur në dosjen gjyqësore. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 4.12.2014.

31. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 20.6.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 4.12.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. ***, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pushimin e gjykimit me arsyetimin se paditësi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt “saktësimi i kufijve dhe hartës treguese që i përket vendimit nr. ***, datë 6.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Vlorë”, ndërsa në të vërtetë ai kundërshton në themel vendimin nr. ***. Për këtë arsye, paditësi duhet të kishte investuar gjykatën me padi, duke goditur vendimin në fjalë, për atë pjesë për të cilën kërkon ndryshimin e tij.

32. Komisioni vlerëson se qëndrimi i Gjykatës së Lartë për pushimin e gjykimit, me arsyetimin se “paditësi duhet të kishte investuar gjykatën me padi duke goditur vendimin në fjalë, për atë pjesë për të cilën kërkon ndryshimin e tij”, ka të bëjë me ushtrimin e kontrollit që kjo gjykatë i bën vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe që ka lidhje me korrektësinë e vendimmarrjes së tyre dhe me zgjidhjen e çështjes në themel, kriteret të cilat nuk mund të shqyrtohen edhe nga Komisioni, sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e fundit e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

33. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

34. Lidhur me dosjen nr. 1, që i përket çështjes penale nr. *** regj., datë 11.5.2015, me të pandehur P. S., i akuzuar për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, për shpalljen fajtor dhe dënimin e shtetasit P. S., duke mos zbatuar parimin e ligjshmërisë së parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.*

35. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²⁸, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se deklarimi fajtor i të pandehurit është bërë si pasojë e elementë të natyrës objektive sikundër kanë qenë, ngarkesa e madhe në punë, numri tepër i lartë i çështjeve penale të gjykuara në atë kohë për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ndryshimet e shpeshta në kohë të dispozitave të Kodit Rrugor, periudha e shkurtër kohore nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë” dhe deri në dhënien e vendimit gjyqësor, si dhe mospërmbushja e detyrimit ligjor të organeve kompetente shtetërore për vënien në dispozicion të gjykatës të fletoreve zyrtare të azhornuara.

Analiza e Komisionit

36. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 27.2.2015, në autostradën Vlorë-Fier kishte ndodhur një aksident, si rezultat i rrëzimit të një motomjeti tip “Dajana 125 cc”, që drejtohej nga ana e shtetasit P. S., ku në sediljen e pasme ka qenë djali i tij, shtetasi G. S.. Nga rrëzimi i motomjetit kanë mbetur të dëmtuar shtetasit P. S. dhe G. S.. Nga verifikimet e kryera nga shërbimet e policisë gjyqësore ka rezultuar se shtetasi P. S. ishte në drejtimin e motomjetit. Gjithashtu, ka rezultuar se nga informacioni i marrë nga DPSHTRR-ja Vlorë ka rezultuar se ky shtetas ishte i pajisur me leje drejtimi të kategorisë “B” dhe nuk ishte i pajisur me leje për drejtim motomjeti. Nga aktekspertimi mjekoligjor ka rezultuar se dëmtimet e shtetasit G. S. kanë qenë të tilla që i kanë sjellë humbjen e aftësisë së përkohshme në punë mbi 9 ditë, ndërsa sipas aktekspertimit mjekoligjor që i është bërë shtetasit P. S. ka rezultuar se dëmtimet e tij kanë qenë të tilla që kanë sjellë humbjen e aftësisë së përkohshme në punë deri në 9 ditë. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, organi i akuzës ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën për gjykimin e të pandehurit P. S. për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

37. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit P. S. për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406.1 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit i është ulur dënimi duke u dënuar përfundimisht me 2 muaj burgim. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.10.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 29.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të pandehurit P. S. me arsyetimin se shtetasi P. S. figuron i pajisur me leje drejtimi të kategorisë “B” (autovetura), motomjeti i sekuestruar është me fuqi ciklotimore 125 cc dhe, për pasojë, sipas ndryshimeve të Kodit Rrugor me ligjin nr. 175/2014, fakti penal nuk ekziston.

38. Referuar rrethanave të mësipërme, Komisioni arsyeton se neni 291 i Kodit Penal është një dispozitë blankete dhe për zbatimin e tij kërkohet referimi në Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Një nga elementet e anës objektive të kryerjes së veprës penale të sipërcituar është drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse. Në kohën kur ka ndodhur aksidenti (datë 27.2.2015) në fuqi ishte ligji nr. 175/2014, “Për disa ndryshime në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë”¹²⁹. Ky ligj në shtesat dhe ndryshimet që i ka bërë neneve të Kodit Rrugor, përkatësisht nenit 115, pika 3, parashikon se në kategorinë “A1” futen motomjetet deri në 125 cc dhe me fuqi 11 KW. Më tej, në ndryshimet

¹²⁸ Email datë 23.2.2022.

¹²⁹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 31.12.2014.

e nenit 123, pika 2, në germat “dh” dhe “ë”¹³⁰, parashikon se leja e drejtimit e dhënë për kategorinë “B” është e vlefshme për kategoritë “A1”, nëse është mbi moshën 21 vjeç. Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi P. S. rezulton i pajisur me leje drejtimi automjeti të kategorisë “B” se aksidenti ka ndodhur në datën 27.2.2015 dhe vendimi gjyqësor është dhënë në datën 29.6.2015, që i përket periudhës kur kishte hyrë në fuqi ligji nr. 175/2014 dhe në këto kushte fakti penal nuk ka ekzistuar. Neni 2 i Kodit Penal parashikon se: *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale”*. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin nr. ***, datë 29.6.2015, për shpalljen fajtor dhe dënimin e shtetasit P. S. me burgim, duke mos zbatuar parimin e ligjshmërisë të parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.

39. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të identifikuar konfliktin e normave dhe për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

40. Lidhur me dosjen nr. 3, që i përket çështjes administrativo-penale me nr. *** regj., datë 5.12.2013, kërkues V. L., me objekt “zëvendësimi i masës së sigurimit nga ‘arrest në burg’ në ‘arrest në shtëpi’”, e parashikuar në nenin 260, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 10.12.2013, për zëvendësimin e masës së sigurimit bazuar vetëm në pretendimet e të dyshuarit, pa hetuar në lidhje me faktin nëse ato qëndrojnë ose jo, duke vepruar jo sipas parashikimeve të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale dhe sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së.*

41. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³¹ subjekti i rivlerësimit shpjegon se mungesa e disponimit të gjykatës për kryerjen e ekzaminimit mjekoligjor të kërkuesit, është kushtëzuar nga afati i shkurtër i përcaktuar nga ligjvënësi në nenin 260, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit kërkesa për revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit shqyrtohet brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Më pas shpjegon se nisur nga provat shkresore të paraqitura nga ana e kërkuesit (kartela mjekësore e lëshuar nga IEVP Vlorë dhe raporte mjekësore të lëshuara nga klinika private mjekësore), si dhe nga koha e qëndrimit të tij në paraburgim (1.11.2012 – 5.12.2013), nga ana e gjykatës është çmuar se ato kanë fuqi provuese sa i përket pretendimeve mbi gjendjen shëndetësore të tij, në drejtim të zbutjes së nevojave të sigurimit në kuptim të nenit 260, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, shpjegon se në rastin konkret ndodhet përpara parashikimit të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, që ka të bëjë me korrektësinë dhe themelin e çështjes.

42. Nga hetimi i Komisionit rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit V. N., në datën 24.10.2012, ka regjistruar procedimin penal nr. *** ndaj shtetasit V. L., i dyshuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2 i Kodit Penal. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 12.9.2012 ndërmjet kallëzuesit dhe Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Vlorë është lidhur

¹³⁰ Ligji nr. 175/2014, neni 22: *“Neni 123 ndryshohet si më poshtë: “2. Vlefshmëria e lejedrejtimit të mjetit sipas kategorive është si më poshtë:..... dh) Lejedrejtimi e dhënë për kategoritë ‘A’, ‘B’, ‘C’ ose ‘D’ është e vlefshme përkatësisht për kategoritë A1 e A2, B1, C1 ose D1..... ë) Lejedrejtimi e kategorisë ‘B’ është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 KW, si dhe motomjetet e kategorisë ‘A1’, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën 21 vjeç”*.

¹³¹ Email datë 23.2.2022.

një kontratë qiraje me afat 10-vjeçar, me objekt një sipërfaqe toke pyll 1 ha, e ndodhur në ***, me nr. ngastre ***. Pas lidhjes së kontratës, shtetasi V. N. i është drejtuar ZVRPP-së Vlorë, me qëllim regjistrimin e saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme, por është vënë në dijeni nga ky institucion se pasuria e sipërcituar nuk mund të regjistrohej, pasi ajo figuron e regjistruar në emër të shtetasit Z. L.. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur sekuestrimin e praktikës së regjistrimit të pasurisë në emër të shtetasit Z. L. dhe ka konstatuar se veprimet në lidhje me këtë pasuri, përfshirë edhe dorëzimin e dokumenteve për regjistrim, janë kryer nga personi nën hetim V. L.. Gjithashtu, nga hetimi prokuroria ka dyshuar se vendimi nr. ***, datë 30.5.1995, i KKKP-së Vlorë, mbi bazën e të cilit i dyshuari ka bërë regjistrimin e pronësisë në ZVRPP-në Vlorë, është tërësisht i falsifikuar.

43. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, prokuroria i është drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” ndaj shtetasit V. L.. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 1.11.2012, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg”. Më pas, me kërkesën e datës 5.12.2013, personi nën hetim ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit me pretendimin se gjendja e tij shëndetësore, sipas raporteve mjekësore të realizuara në klinika private, si dhe kartelës shëndetësore të ndodhur në IEKPV Vlorë është e atij niveli saqë qëndrimi i mëtejshëm i tij në masën e sigurimit “arrest me burg” do ta vinte seriozisht në rrezik shëndetin dhe jetën e tij. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokuroria dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 10.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuarit V. L.. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi nën hetim V. L.

44. Rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor dhe pasi ka administruar dokumente shkresore që kanë të bëjnë me gjendjen shëndetësore të kërkuarit, ka caktuar ekspert mjekoligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, të cilit i ka kërkuar të përcaktojë nëse shtetasi V. L. vuan nga ndonjë sëmundje, ecurinë e saj dhe me diagnozën që ka, nëse mund t’i rëndohet më tej dhe a mund t’i rrezikohet jeta në kushtet e paraburgimit apo të spitalit të burgut. Eksperti mjekoligjor ka arritur në përfundimin se sëmundjet¹³², nga të cilat ky shtetas vuan, kërkojnë ndjekje të specializuar në dinamikë me mjekime dhe konsulta me mjekë specialistë të fushës, të cilat po të mos trajtohen sipas protokolleve mjekësore mund të sjellin rëndimin e gjendjes si në kushtet e paraburgimit ashtu edhe jashtë tyre. Gjithashtu, para gjykatës eksperti mjekoligjor ka shpjeguar se trajtimi i sëmundjes, nga e cila vuan kërkuari, është i përballueshëm dhe plotësisht i mundur në spitalin e burgut, qoftë me kapacitete personeli mjekësor, ashtu edhe me trajtim veçanërisht të specializuar.

45. Sa më sipër, rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka administruar prova të reja lidhur me gjendjen shëndetësore të kërkuarit dhe pasi ka administruar edhe mendimin e ekspertit mjekoligjor, ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga ai i subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rezultat i vlerësimit ndryshe të provave të paraqitura nga pala kërkuare. Si pasojë, Komisioni vlerëson se qëndrimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, si gjykatë më e lartë, ka vlerësuar korrektësinë e vendimmarrjes së subjektit, si

¹³² Shtetasi V. L. vuan nga sëmundja e diabetit “mellitus tip II” insulinovartës (sëmundja e sheqerit), e ndërlikuar me retinopathy diabetike, rritje të tensionit arterial mbi shifrat normale dhe çrregullime të metabolizmit të yndyrnave, sëmundje e diagnostikuar para disa vitesh.

dhe ka zgjidhur themelin e çështjes, kritere të cilat nuk mund të jenë objekt vlerësimi nga organet e rivlerësimit sipas parashikimit të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

46. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

47. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku në periudhën tetor 2013 - janar 2014 ka gjykuar në fushën e të drejtës civile dhe nga janari i vitit 2014 në fushën e të drejtës penale. Gjithashtu, rezulton se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Laurent Fuçia ka përfunduar gjithsej 986 çështje gjyqësore, nga të cilat 396 çështje civile (225 civile themeli e 171 civile të veçanta) dhe 590 çështje penale (309 penale themeli, 227 administrativo-penale, 31 përgjime dhe 23 masa sigurimi). Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit Laurent Fuçia ka qenë nën standardin minimal¹³³.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjykimit, identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, te pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar e deri te shpallja e vendimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Dosjet janë të inventarizuara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas aktet procedurale të krijuara nga gjykata, duke pasqyruar kronologji në renditjen e akteve dhe duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

48. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore dhe i ankesave, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Laurent Fuçia. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

a) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

b) Paanësia

¹³³ Sipas pikës 3, germa “g” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtarë në vit.

Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

49. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Laurent Fuçia komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 12 trajnime, gjithsej 19 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLGJ-së

50. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Laurent Fuçia janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së 16 ankesa (3 në vitin 2013, 7 në vitin 2014, 4 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016).

51. Tetë ankesa (2 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 3 ankesa me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 3 ankesa me arsyetimin se nuk ka pasur fakte apo rrethana për verifikim dhe 2 ankesa me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë.

52. Tetë ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon: (i) 1 ankesë e vitit 2013, është vendosur mbajtja në vijim e ankesës në pritje të vendimmarrjes nga Gjykata e Lartë; (ii) një informacion i vitit 2014, mbi vendimet e cenuara të gjykatës, pas verifikimit është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik dhe profesional të gjyqtarit; (iii) një ankesë e vitit 2014, ardhur nga institucioni i Prokurorit të Përgjithshëm për vendim të cenuar, pas verifikimit është vendosur evidentimi për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit; (iv) një ankesë e

vitit 2014, pas verifikimit është vendosur “tërheqje vëmendjeje” me shkrim, për mosrespektim formal të ligjit; (v) në ankesë e vitit 2014, është verifikuar dhe nuk ka rezultuar të ketë shkelje nga ana e gjyqtarit; (vi) një ankesë e vitit 2015, është vendosur mbajtja në vijim e ankesës në pritje të vendimmarrjes nga Gjykata e Apelit Vlorë; (vii) një ankesë e vitit 2015, e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është vendosur mbajtja në vijim e ankesës në pritje të vendimmarrjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; (viii) një ankesë e vitit 2016, është sugjeruar të bëhet verifikimi i ankesës.

53. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Laurent Fuçia përgjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se ndaj tij është paraqitur një kërkesë për procedim disiplinor nga ministri i Drejtësisë me nr. *** prot., datë 8.6.2016 (prot. ish-KLD nr. ***, datë 8.6.2016) për masën “vërejtje me paralajmërim”. Kërkesa është trajtuar në mbledhjen e ish-KLD-së, datë 7.5.2018, ku është rrëzuar kërkesa (vendimi nr. ***, datë 7.5.2018, i ish-KLD-së).

Hetimi i Komisionit në raport me ankesat e paraqitura në KLD

54. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, një nga burimet e vlerësimit të magjistratit janë të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, Komisioni administroi nga KLGJ-ja¹³⁴ ankesat e paraqitura në KLD ndaj subjektit Laurent Fuçia për periudhën 1.1.2006 – gusht 2020, ankesat e përcjella nga KLGJ-ja pranë ILD-së¹³⁵ dhe ankesat e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë¹³⁶. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për ankesat.

55. Fillimisht, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se periudha e rivlerësimit kalimtar për komponentin profesional përfshin si rregull periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 dhe si përjashtim nga rregulli periudhën 1.1.2006 – 8.10.2016. Pas kësaj periudhe, vijon subjekti, në respektim të nenit 3, pika 2, nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, nenit 171 të ligjit nr. 96/2016, si dhe neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kompetencë ekskluzive për të bërë inspektimin e shkeljeve disiplinore dhe vlerësimin etik e profesional të magjistratëve e ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe në respektim të neneve 1, 18 dhe 24 të Kodit të Procedurave Administrative ankesat e paraqitura pranë organeve të rivlerësimit duhet t’i përcillen këtyre organeve kushtetuese.

56. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“4. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelit merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”*. Gjatë analizimit të kësaj dispozite, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, ka vlerësuar se: *“...si rregull, bazuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4, ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë gjithashtu nga organet e reja kushtetuese të*

¹³⁴ Shkresë nr. *** prot., pa datë, 2020.

¹³⁵ Shkresë nr. ***, datë 19.12.2022.

¹³⁶ Shkresë nr. ***, datë 27.7.2020.

rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit...”. Referuar nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese Komisioni çmon se vlerësimi i aftësive profesionale shtrihet për periudhën nga 1 janari 2006 e në vijim, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet. Informacionet lidhur me aftësitë profesionale merren parasysh nga Komisioni dhe Kolegji nëse çmohen si të domosdoshme nga relatori dhe vëzhguesit ndërkombëtarë për procesin e rivlerësimit¹³⁷. Dhe në rastet kur nuk ka një vendimmarrje të Komisionit për të shtrirë hetimin për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, atij nuk i cenohet e drejtat sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të sipërpërmendur¹³⁸.

Ankesat e trajtuara nga KLD-ja

57. *Lidhur me ankesën e shtetases N. L., e cila ka pretenduar se janë zhvilluar seanca gjyqësore pa njoftuar rregullisht palët, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka verifikuar legjitimitetin e palës paditëse, sipas parashikimit të nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile.**

58. *Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³⁹, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit rezulton se kjo gjykatë i referohet ekstraktit të regjistrit tregtar të datës 28.5.2014, e cila i referohet një periudhe kohore prej 11 muajsh pas dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë, rrethanë që tregon se në momentin e zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë, potencialisht nuk kanë qenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrit tregtar ndryshimet në lidhje me administrimin e shoqërisë “****” sh.p.k.*

59. Nga hetimi i Komisionit rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është paraqitur çështja civile me palë: paditës shoqëria “****” sh.p.k.; i paditur Drejtoria e Administrimit dhe e Shtitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, me objekt “fitimi i pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme truall funksional të objekteve ndërtimore”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 26.11.2012, me gjyqtar A. Sh., ka vendosur pushimin e çështjes, me arsyetimin se pala paditëse nuk ishte paraqitur pa ndonjë shkak të arsyeshëm. Më pas rezulton se e njëjta çështje është paraqitur përsëri pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe është marrë në shqyrtim nga gjyqtari Laurent Fuçia. Nga hetimi gjyqësor është provuar se me vendimin e datës 24.2.2009, KRRT Bashkia Vlorë ka miratuar lejen e ndërtimit në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. në lidhje me realizimin e një ndërtimi 2-6-7-8-9-10 kate, 2 kate dyqane, 4-5-6-7-8 kate banimi + 1 kat parkimi nën tokë”, në lagjen “****”, Vlorë. Në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit, trualli funksional mbi të cilin janë realizuar ndërtimet ka qenë në pronësi të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit B. S., sipas vendimit nr. ***, datë 9.7.1994, të ish-KKKP-së Vlorë. Me vendimin nr. ***, datë 27.1.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 27.6.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, është vendosur anulimi i vendimit nr. ***, datë 9.7.1994, i ish-KKKP Vlorë, në favor të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit B. S. dhe urdhërimi i ZVRPP-së Vlorë të çregjistrojë pasurinë e regjistruar sipas vendimit të mësipërm në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit B. S. dhe regjistrimin e saj në emër të shtetit shqiptar. Në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë për shqyrtim dhe kërkon detyrimin e palës së paditur, Ministrinë e

¹³⁷ Vendimi nr. 10 (JR), datë 18.4.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹³⁸ Vendimi nr. 25 (JR), datë 14.10.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹³⁹ Email datë 23.2.2022.

Zhvillimit Ekonomik Tregtisë e Sipërmarrjes ta njohë atë pronare mbi truallin funksional mbi të cilin janë realizuar ndërtime prej saj dhe detyrimin e ZVRPP-së Vlorë që të regjistrojë këtë pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme, me arsyetimin se vlera e ndërtimeve të realizuara prej saj është më e madhe se vlera e truallit mbi të cilin janë realizuar këto ndërtime.

60. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 24.6.2013, ka vendosur pranimin e padisë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 10.11.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 24.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pushimin e çështjes me arsyetimin se padia në emër të shoqërisë është nënshkruar nga shtetasi S. Sh., i cili nuk ka pasur tagrat e administratorit të shoqërisë në momentin e ngritjes së padisë.

61. Komisioni arsyeton se referuar nenit 176¹⁴⁰ të Kodit të Procedurës Civile është detyrë e gjykatës që fillimisht të verifikojë legjitimitetin e palëve në gjykim, e para së gjithash legjitimitetin aktiv të paditësit në ngritjen e padisë. Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se ekstrakti i QKR-së (QKB) i administruar nga Gjykata e Apelit është i datës 28.5.2014, që i referohet një periudhe kohore prej 11 muajsh pas dhënies së vendimit nga ana e tij e, për pasojë, ndryshimi i administratorit nuk ka qenë i pasqyruar në ekstraktin e regjistrit tregtar, Komisioni arsyeton se:

61.1. Data 28.5.2014, që përmban ekstraktin e regjistrit tregtar i referohet datës së tërheqjes së këtij dokumenti nga QKR-ja dhe nuk përbën datën e pasqyrimin të vendimit për ndryshimin e administratorit. Referuar ekstraktit të regjistrit tregtar në sistemin elektronik¹⁴¹ dhe përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, rezulton se vendimi për ndryshimin e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. është i datës 8.3.2013, regjistrimi i ndryshimit është bërë në datën 27.3.2013, padia është ngritur në datën 29.4.2013 nga shtetasi S. Sh. dhe është paraqitur në gjykatë në datën 30.4.2013. Referuar këtyre rrethanave, padia është ngritur në emër të shoqërisë nga një shtetas, i cili nuk gëzonte të drejtën e administratorit të shoqërisë.

62. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti e ka marrë të mirëqenë padinë e paraqitur nga shoqëria “****” sh.p.k., pa verifikuar më parë nëse personi që ka nënshkruar kërkesëpadinë në emër të shoqërisë gëzonte tagrat e administratorit. Sa më sipër, duket se subjekti nuk ka verifikuar legjitimitetin e palës paditëse, sipas parashikimit të nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile.

63. Gjithsesi, duke pasur parasysh se ky vendim i subjektit është kontrolluar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me vendimin e saj ka prishur vendimin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka kompetenca të një gjykate më të lartë, por vlerëson këto shkelje procedurale bazuar të kriteret e vlerësimit sipas neneve 72 -76 të ligjit nr. 96/2016.

64. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se ky gabim procedural nuk kualifikohet si një nga problematikat të cilat mund të konsiderohet në rivlerësimin e aftësive profesionale, për aq kohë sa nuk ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët apo mosrespektim të të drejtave të palëve. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se nuk mund të merret në konsideratë si mangësi në rivlerësimin e aftësive profesionale sipas ligjit nr. 84/2016.

¹⁴⁰ Kodi i Procedurës Civile, neni 176 parashikon: “Gjykata verifikon legjitimitetin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe, kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat”.

¹⁴¹ https://qkb.gov.al/***/

65. Lidhur me ankesën e shtetasit L. N., i cili është ankuar për humbjen e të drejtës për të paraqitur rekurs, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka zhvilluar seancën e datës 7.3.2014 pa njoftuar palët dhe në mungesë të tyre, duke mos zbatuar nenet 175 dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile.*

66. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴² subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në pjesën hyrëse të vendimit për veçimin e çështjes dhe shpalljen e moskompetencës lëndore janë shënuar palët e paditura dhe personat e tretë që kanë qenë në mungesë gjatë gjykimit dhe nuk është shënuar e njëjta pozitë për palën paditëse të kundërpaditur, për arsye se, së pari, në gjykimin në shkallë të parë paditësi nuk mund të kishte pozitën procedurale të palës në mungesë (para ndryshimeve të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile) dhe së dyti, në kushtet kur marrja e vendimit është bërë në dhomë këshillimi është e kuptueshme që pala paditëse nuk mund të vendosej si e pranishme në vendim. Gjithashtu, shpjegon se në momentin e marrjes së vendimit për shpalljen e moskompetencës ka pasur rregullim të ndryshëm procedural në lidhje me momentin e ecjes së afatit të ankimit, i cili fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, ndërkohë që, ky afat do duhet të niste nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar (sikundër parashikohet aktualisht në dispozitat procedurale civile pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017).

67. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është gjykuar çështja civile me palë: paditës F. N.; të paditur L. N., B. N. etj., me objekt “ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 25.6.2009, të ish-Zyrës Rajonale të KKP-së, Qarkut Vlorë, detyrim njohje pronar, kundërshtim akti të marrjes së tokës në pronësi, detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të çregjistrojë pronën nga shtetasi A. N. dhe ta regjistrojë në emër të trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit S. N.”. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. *** akti, datë 7.3.2014, ka vendosur veçimin e objektit të padisë që konsiston në kundërshtimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi, dhënë në emër të shtetasit A. N., shpalljen e moskompetencës lëndore në lidhje me këtë kërkim dhe dërgimin e akteve për këtë kërkim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Ky vendim është dhënë nga subjekti pa praninë e palëve, por në vendim nuk pasqyrohet që të paditurit janë në mungesë, duke sjellë si pasojë moskomunikimin e vendimit të paditurve. Të paditurit, pasi janë njohur me këtë vendim, e kanë kundërshtuar, por rekursi i tyre nuk është pranuar nga gjykata e rrethit për shkak se vendimi ka marrë formë të prerë. Në këto kushte, të paditurit i janë drejtuar gjykatës me kërkesë për rivendosje në afat të ankimit (rekursit). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.6.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës.

68. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. *** akti, datë 7.3.2014 dhe procesverbalit të seancës gjyqësore, rezulton se subjekti ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore jopublike çështjen përkatëse dhe në pjesën hyrëse të vendimit pasqyrohet pala paditëse dhe përfaqësuesi i saj dhe mungon shënimi “në mungesë” dhe për palët e paditura nuk pasqyrohet shënimi “në mungesë”. Gjithashtu, nga shqyrtimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore konstatohet se seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në datën 28.10.2013, pra konstatohet se seanca e datës 7.3.2014 ka qenë në vazhdim të gjykimit. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar seancën e datës 7.3.2014 pa njoftuar palët dhe në mungesë të të dyja palëve në kundërshtim me nenet 172 dhe 179¹⁴³ të Kodit të Procedurës Civile (në kohën e gjykimit). Referuar dispozitave

¹⁴² Email datë 23.2.2022.

¹⁴³ Kodi i Procedurës Civile, neni 172 parashikon se: “Shqyrtimi i çështjes përpara gjykatës bëhet verbalisht, por palët mund të parashtrajnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes në gjykim..”; neni 179 parashikon se: “Nëse paditësi

procedurale, gjykimi në mungesë lejohet përjashtimisht vetëm në kushtet që parashikohen në nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, kur pala e paditur apo personi i tretë nuk janë paraqitur pa shkak të arsyeshëm, megjithëse janë njoftuar rregullisht.

69. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

70. Lidhur me ankesën e Prokurorisë së Përgjithshme ndaj dy vendimeve gjyqësore penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë: (i) për revokimin; dhe (ii) shuarjen e masës së sigurimit personal “arrest me burg” – Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 9.8.2012, në interpretim të gabuar të nenit 493, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale.*

71. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴⁴, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *së pari*, në rastin e shqyrtimit të kërkesës për shuarjen masës së sigurimit nuk ndodhej përpara rastit të shkeljes së parimit *ne bis in idem*, pasi kërkesa e dytë për shuarjen e masës së sigurimit i referohet ndryshimit të rrethanave, pasi: (i) ishte marrë vendimi nr. ***, datë 15.11.2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i arrestuari E. S. kundër vendimit nr. ***, datë 5.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; (ii) me vendimin nr. ***, datë 5.2.2014, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 15.11.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë; (iii) në momentin e dhënies së vendimit nr. ***, datë 16.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është bërë interpretim pajtues i nenit 493/4 të Kodit të Procedurës Penale me vendimin datë 25.9.2012 të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJEDNJ), në çështjen *Rrapo vs Republika e Shqipërisë*, vendim i cili nuk rezultonte të ishte dhënë në momentin e dhënies së vendimit nr. ***, datë 9.8.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Së dyti, lidhur me interpretimin e nenit 493/4 të Kodit të Procedurës Penale sqaron se në vendimin nr. ***, datë 16.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është bërë interpretimi pajtues i nenit 493/4 të Kodit të Procedurës Penale në harmoni me qëndrimin e mbajtur nga ana GJEDNJ-së në çështjen *Rrapo vs Republika e Shqipërisë*, datë 25.9.2012, dhe më pas shpjegon se duke qenë përpara një norme procedurale jo të qartë dhe për të cilën mungonte një interpretim unifikues nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Më pas shpjegon se në rastin konkret, gjykata, në interpretimin e bërë, ka mbajtur në konsideratë parësore liritë dhe të drejtat themelore të individit, sikurse është edhe e drejta për liri dhe siguri. Kjo paqartësi në interpretimin e krijuar, shpjegon subjekti, ka ardhur si rezultat i parashikimit të mëparshëm të pikës 4 të nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale, e cila u zgjidh nga ana e ligjvënësit me ndryshimet e bëra në këtë dispozitë me ligjin nr. 35/2017. Gjithashtu, shpjegon se ndodhet në kushtet e pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

72. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se shtetasi E. S. është shpallur person në kërkim ndërkombëtar nga Autoritetet Italiane të Drejtësisë, në bazë të urdhërarrestit ndërkombëtar të

ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit. Nëse i padituri nuk paraqitet në seancën e parë dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata cakton një seancë tjetër gjyqësore. Nëse ky nuk paraqitet edhe në seancën tjetër gjyqësore dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

¹⁴⁴ Email datë 23.2.2022.

datës 1.7.2011, të lëshuar nga Gjykata e *** (Itali), për veprat penale “pjesëmarrje në organizatë kriminale” dhe “trafikim të lëndëve narkotike”.

73. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 2.5.2012, ka vendosur miratimin e arrestit ndërkombëtar dhe caktimin e masës “arrest në burg” me afat 40 ditë ndaj shtetasit E. S.. Pas paraqitjes së kërkesës për ekstradim nga ana e shtetit kërkues dhe të kërkesës për caktim mase sigurimi nga ana e prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2012, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit E. S..

74. Në lidhje me ekstradimin e shtetasit E. S. drejt Italisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 18.6.2012, ka vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.7.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 18.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke gjykuar çështjen në fakt dhe duke vendosur miratimin e ekstradimit. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs shtetasi E. S. i cili ka kërkuar gjithashtu edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. ***, datë 24.7.2012, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal nr. ***, datë 5.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Me vendimin nr. ***, datë 15.11.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i arrestuari E. S. kundër vendimit nr. ***, datë 5.7.2012, të Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë 5.2.2014, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 15.11.2012, të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, duke arsyetuar se kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, i është mohuar e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës dhe, në këtë kuptim, kërkesa e tij është e bazuar dhe duhet pranuar.

75. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 19.5.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 5.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.6.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke arsyetuar se për shtetasin E. S. kanë filluar dy procedime penale në përfundim të të cilave është deklaruar fajtor nga gjykatat¹⁴⁵ dhe, për pasojë, konstatohet një nga kushtet ndaluese të nenit 491, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale, e cila e ndalon gjykatën të japë ekstradimin “kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri”.

i) Vendimi për revokimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg”

Pas nxjerrjes së urdhrin të Kryetarit të Gjykatës së Lartë për pezullim ekzekutimi të vendimit nr. ***, datë 5.7.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, shtetasi E. S., me kërkesën e datës 8.8.2012, ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë revokimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, të caktuar sipas vendimit nr. ***, datë 2.5.2012, me arsyetimin se kanë kaluar 3 muaj nga fillimi i ekzekutimit të saj dhe ende nuk ka përfunduar procedimin përpara gjykatës.

¹⁴⁵ (i) Vendimi nr. ***, datë 27.7.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 5.12.2012, nga Gjykata e Apelit Vlorë, ku është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit E. S. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal; (ii) vendimi nr. ***, datë 9.7.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që ka deklaruar fajtor të pandehurin E. S. për veprën penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 9.8.2012, ka vendosur revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për qëllime ekstradimi ndaj shtetasit E. S., duke urdhëruar lirim të menjëhershëm të tij.

Me vendimin nr. ***, datë 11.10.2012, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 9.8.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e rrëzuar kërkesën e shtetasit E. S. për revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për qëllime ekstradimi¹⁴⁶.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 22.11.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit E. S.

ii) Vendimi për shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg”

Në vijim, shtetasi E. S. në datën 11.7.2014¹⁴⁷ ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën për shuarjen e masës së sigurimit, me arsyetimin se nuk është realizuar marrja në pyetje nga ana e gjykatës e personit të arrestuar brenda afatit 3-ditor të parashikuar nga neni 248/1 i Kodit të Procedurës Penale. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 16.7.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës, revokimin (shuarjen) e masës së sigurimit “arrest me burg” të caktuar ndaj shtetasit E. S. me vendimin nr. ***, datë 2.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë¹⁴⁸, duke urdhëruar lirim të tij nëse nuk mbahet i arrestuar apo i ndaluar për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 15.8.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 16.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rrëzimin e kërkesës së kërkuarit E. S., duke arsyetuar se interpretimi ligjor i nenit 493/4 i Kodit të Procedurës Penale kërkon detyrimisht dhe domosdo përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim nga autoritetet gjyqësore, ku përfshihen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 25.9.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari E. S. kundër vendimit nr. ***, datë 15.8.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Referuar rrethanave të mësipërme, Komisioni vlerëson se vendimi objekt shqyrtimi i subjektit të rivlerësimit është zgjidhur nga ky i fundit bazuar në interpretimin e pikës 4 të nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale që ai i ka bërë këtij neni, duke pasur parasysh faktin se deri në atë moment nuk ka pasur një vendim unifikues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin e pikës 4 të nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale.

Për këtë arsye, Komisioni vlerëson se interpretimi i bërë pikës 4 të nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale nga subjekti në vendimet objekt shqyrtimi nuk mund të vlerësohet nga institucionet e rivlerësimit në kuadër të aftësive gjyqësore të tij. Kjo për shkak se vlerësimi i aftësive gjyqësore të subjektit duhet të realizohet pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit, në përputhje me pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ndodhet në kushtet e pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 është i drejtë.

¹⁴⁶ Vendim i cili është ekzekutuar nga shërbimet e policisë gjyqësore në datën 28.2.2014.

¹⁴⁷ Pas ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 11.10.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që kishte vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 9.8.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke rrëzuar kërkesën e shtetasit E. S. për revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg për qëllime ekstradimi”.

¹⁴⁸ I lënë në fuqi nga vendimi nr. ***, datë 11.10.2012, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

76. Në përfundim, Komisioni vlerëson se ky vendim i marrë nga subjekti nuk përfshihet në një nga kategoritë e shkeljeve sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

77. Lidhur me ankesën e shtetasit Ll. Q., për dhënie vendimi arbitrar dhe të kundërligjshëm, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti në vendimin nr. ***, datë 9.10.2014, nuk është shprehur për të gjitha kërkimet në kundërpadi sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile, pasi: (a) është shprehur vetëm për një pjesë të sipërfaqes së kërkuar nga kundërpaditësi (për sip. 500 m²), ndërsa për pjesën tjetër të kërkuar me padi rivendikimi për sip. 1.500 m² dhe për ligjshmërinë ose jo të posedimit të paditësit për këtë sipërfaqe të zënë nuk është shprehur; si dhe (b) nuk është shprehur lidhur me kërkimin e kundërpadisë për shpërblim dëmi nga përdorimi i sendit.*

78. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴⁹, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *së pari*, në lidhje me natyrën juridike të kërimit të paraqitur nga ana e palës së paditur kundërpaditëse për goditjen për falsitet të lejes së ndërtimit është i mendimit se një kërkim i tillë ka natyrë të mirëfilltë administrative dhe është në përputhje vendimet nr. 2, datë 10.3.2014 dhe nr. 3, datë 28.4.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se pavarësisht se nga pikëpamja procedurale përfaqëson një dokument, nga pikëpamja e së drejtës materiale konsiderohet ai akt administrativ, pasi është shprehje e vullnetit të një organi administrativ shtetëror për krijimin e pasojave juridike në fushën e ndërtimit. Kjo do të thotë se në të gjitha ato raste kur kërkohet goditja për falsitet e një akti me natyrë administrative, sikundër është edhe leja e ndërtimit në këtë rast, kompetente nga pikëpamja lëndore do të jetë gjykata administrative e shkallës së parë, ku ushtron veprimtarinë organi administrativ kompetent. Ndërsa goditja për falsitet i një akti, të parashikuar nga neni 32/c i Kodit të Procedurës Civile, i referohet të gjitha atyre akteve, jo domosdoshmërisht akte administrative (sikundër janë shkresat e thjeshta apo aktet private), nga të cilat paditësi tërheq një interes të ligjshëm nga njohja e falsitetit apo pavërtetësisë së tyre nga gjykata.

Së dyti, në lidhje me detyrimin e gjykatës së shkallës së parë për garantimin e zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me kërkimin e palës së paditur kundërpaditëse për shpërblim për përdorimin e sendit nga pala paditëse e kundërpaditur, subjekti i rivlerësimit shpjegon se gjykata e apelit nuk ka pasur pengesë për riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor, duke urdhëruar kryerjen e një aktekspertimi vlerësues me ekspertë të fushës.

79. Nga analiza e Komisionit rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është gjykuar çështja civile me palë: paditës/i kundërpaditur A. G.; të paditur/kundërpaditës Dh. S., Ll. Q., N. Q., etj., ZVRPP-ja Vlorë, me objekt padie “anulimi i pjesshëm i vendimeve nr. *, datë 7.7.1994 dhe nr. ***, datë 25.1.1996 të ish-KKKP-së Bashkia Vlorë në emër të trashëgimtarëve të Th. S., detyrimi i ZVRPP-së Vlorë të lëshojë certifikatën e pronësisë në emër të paditësit, detyrimi i palës së paditur të heqë kufizimin mbi pronësinë e paditësit”. Ndërsa kundërpadia ka si objekt detyrimin e të paditurit të lirojë dhe dorëzojë sendin, truell me sip. 2.000 m², shpërblimin për përdorimin e tij, si dhe çdo të ardhur tjetër, goditje për falsitet të dokumentit “leje ndërtimi”, pika 11 e vendimit nr. ***, datë 26.5.1998, të Komitetit Ekzekutiv të KP-së Vlorë.**

¹⁴⁹ Email datë 23.2.2022.

80. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 9.10.2014, ka vendosur pranimin e padisë si të mbështetur në prova e në ligj: (i) anulimin pjesërisht të vendimeve nr. ***, datë 7.7.1994 dhe nr. ***, datë 25.1.1996, të ish-KKKP Bashkia Vlorë, në favor të së ndjerës Th. S., vetëm në lidhje me sipërfaqen totale prej 500 m², e cila krijon mbivendosje me pronën e palës paditëse/të kundërpaditur; (ii) detyrimin e palës së paditur ZVRPP Vlorë që të regjistrojë në favor të palës paditëse të kundërpaditur sipërfaqen prej 500 m² truall dhe ndërtesë 150 m² [...]; (iii) veçimin e objektit të kundërpadisë në lidhje me goditjen për falsitet të pikës 11 të vendimit nr. ***, datë 26.5.1988, të ish-Komitetit Ekzekutiv të KP-së Vlorë, duke deklaruar moskompetencën lëndore dhe duke ia kaluar për kompetencë lëndore Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ndërsa ka rrëzuar kundërpadinë për kërkimet e tjera të saj, si të pabazuar në ligj.

81. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 27.12.2016¹⁵⁰, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 9.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palës së paditur/kundërpaditëse në kundërpadi dhe për mungesë të hetimit gjyqësor në lidhje me kërkimin e kundërpadisë për shpërblimin e dëmit nga përdorimi i sendit.

82. Komisioni vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Apelit Vlorë e ka prishur vendimin e subjektit si gjykatë më e lartë dhe duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të administruara në gjykim ka arritur në përfundimin se vendimi i gjykatës së rrethit nuk është korrekt, duhet prishur dhe duke e dërguar edhe një herë për gjykim pranë kësaj gjykatë. Neni 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, parashikon se çmimi i aftësive gjyqësore bëhet pa gjykuar korrektesinë e vendimit dhe themelin e çështjes, për pasojë Komisioni vlerëson se konstatimet e Gjykatës së Apelit Vlorë nuk janë objekt i rivlerësimit të aftësive profesionale, sikundër parashikohet në ligjin nr. 84/2016.

83. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

84. Lidhur me kërkesën për procedim disiplinor të ministrit të Drejtësisë, për shkak të rrëzimit të kërkesës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, të kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 27.2.2016, jo sipas parashikimeve të neneve 252 dhe 253 të Kodit të Procedurës Penale dhe jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pasi: (i) nuk ka marrë në konsideratë procesverbalin e kapjes në flagrancë të të dyshuarit; (ii) nuk ka vlerësuar pamjet filmike të lokalit ku është arrestuar i dyshuari.*

85. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵¹, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se i qëndron të gjitha parashtrimeve dhe shpjegimeve të dhëna më parë pranë këtij institucioni dhe se aspektet për të cilat i janë kërkuar shpjegime nga ana e Komisionit konsistojnë në mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe me vlerësimin dhe bindjen e brendshme të gjyqtarit, në drejtim të analizës juridiko-procedurale të gjendjes së flagrancës, si dhe kushteve dhe kritereve për caktimin e masës së sigurimit, të cilat mund dhe duhet të jenë në çdo rast objekt kontrolli nga gjykata më e lartë. Më pas shpjegon se në rastin në fjalë, pas kontrollit të vendimit

¹⁵⁰ Administruar nga faqja elektronike gjykata.gov.al

¹⁵¹ Email datë 23.2.2022.

nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk rezulton të jenë konstatuar shkelje formalo-procedurale të ligjit nga gjykata më e ulët, por është bërë një vlerësim i ndryshëm i akteve të fashikullit hetimor, duke u arritur në përfundimin se arresti në flagrancë ndaj personit nën hetim ka qenë i ligjshëm dhe se ndaj tij duhej caktuar masa shtrënguese “arrest në burg”.

86. Në lidhje me vlerësimin e pamjeve filmike sqaron se nga ana e organit të prokurorisë është vënë në dispozicion procesverbali i këqyrjes, shoqëruar me fotografi, por nga të cilat nuk mund të konkludohet mbi faktin nëse në momentin e arrestimit në flagrancë nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore, personi nën hetim e ka pasur armën në brez, sikundër është pretenduar. Përkundrazi, fakti që në momentin e ndërhyrjes në lokal nga ana e shërbimeve të policisë gjyqësore janë gjetur të hedhura në tokë 3 armë zjarri, provon indirekt faktin se në momentin e arrestimit në flagrancë personi nën hetim nuk e ka pasur armën me vete, por dyshimet kanë qenë se ai e ka hedhur atë në tokë. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në rastin konkret ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

87. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se Komisariati i Policisë, Qarku Vlorë, mbi bazën e të dhënave të mbledhura në rrugë operative ka marrë dijeni se në lokalit e pikës së basteve “****”, ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, në pronësi të shtetasit K. Ll., ka pasur persona të armatosur. Në këto kushte, shërbimet e policisë gjyqësore kanë kryer kontroll me iniciativë në ambientet e brendshme të lokalit të sipërcituar, nga ku, në momentin kur ata janë drejtuar për nga hyrja kryesore e lokalit, në katin e dytë të tij, kanë konstatuar se shtetasi V. P. është ngritur nga tavolina dhe ka vrapuar në drejtim të dritares së lokalit dhe pas kontrollit personal të tij i është gjetur një armë zjarri tip pistolete e markës “****”. Njëkohësisht, në katin e dytë të lokalit, pranë tavolinës ku ndodheshin të ulur shtetasit K. B. dhe E. M., janë konstatuar të hedhura në dysheme edhe 2 armë të tjera zjarri bashkë me municionin përkatës, konkretisht, një pistoletë e markës “TT” dhe një pistoletë model “Berreta”. Në këto rrethana, nga shërbimet e policisë gjyqësore është kryer veprimi i arrestimit në flagrancë i shtetasve V. P., K. B. dhe E. M.. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën me objekt “vleftësimi i arrestit në flagrancë” ndaj personit nën hetim V. P. dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “arrest në burg”.

88. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 27.2.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, vleftësimin si të paligjshëm të arrestit në flagrancë realizuar nga policia gjyqësore, ndaj personit nën hetim V. P. dhe caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” me arsyetimin se policia gjyqësore nuk ka respektuar parashikimet e nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka rezultuar që personi nën hetim të jetë kapur menjëherë pas kryerjes së veprës penale, në kryerje e sipër të saj apo me mjete dhe prova nga të cilat duket se e ka kryer veprën penale, për pasojë çmon se arrestimi në flagrancë i personit nën hetim V. P. duhet të vleftësohet si i paligjshëm. Këtë arsyetim subjekti i rivlerësimit e mbështet në procesverbalin e kontrollit personal, datë 23.2.2016, ora 21:40, ku pasqyrohet se nga kontrolli personal i shtetasit V. P. nuk është gjetur asnjë send i kundërligjshëm e, për pasojë, sipas subjektit nuk rezulton i provuar ky fakt brenda kufijve të dyshimit të arsyeshëm.

89. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 30.3.2016¹⁵², ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 27.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vleftësimin e ligjshëm

¹⁵² Të administruar nga faqja elektronike gjykata.gov.al

të arrestit në flagrancë të shtetasit V. P. dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

90. Në vijim, Komisioni konstaton se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit duke bërë një interpretim dhe vlerësim të ndryshëm të provave të administruara në gjykim, konkretisht, të procesverbalit të kontrollit personal dhe procesverbalit të arrestimit në flagrancë dhe, si pasojë, ka bërë një interpretim dhe zbatim të ndryshëm të dispozitave procedurale penale dhe ka konkluduar se i arrestuari gjendej në kushtet e flagrancës sipas parashikimeve të nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, bazuar në nenin 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, që parashikon se vlerësimi i aftësive gjyqësore duhet të realizohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, Komisioni çmon se vlerësimi i ndryshëm i provave nga Gjykata e Apelit Vlorë, që ka sjellë si pasojë një interpretim të ndryshëm të ligjit nga gjykata e rrethit, ka të bëjë me ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë më e lartë në kontrollin e korrektësisë së vendimeve të gjykatave të rrethit dhe me zgjidhjen në themel të çështjes, kriteret të cilat nuk janë objekt i rivlerësimit të aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit.

91. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga nenet 72 - 76 të ligjit nr. 96/2016.

Ankesë e trajtuar nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë

92. Lidhur me ankesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për mënyrën e parregullt të zhvillimit të proceseve gjyqësore ku kjo shoqëri ka qenë në cilësinë e të paditurit, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për dy procese gjyqësore, si vijon:

93. Lidhur me procesin gjyqësor civil të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) vendimi i ndërmjetëm i subjektit për shqyrtimin e çështjes në mungesë të palës së paditur në seancën përgatitore të datës 12.7.2013 nuk mbështetet në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi ky vendim, sipas nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, merret në seancë gjyqësore; (ii) subjekti nuk ka njoftuar të paditurin për zhvillimin e seancave gjyqësore të datës 16.7.2013 dhe të datës 22.7.2013, duke mos zbatuar nenin 130, të Kodit të Procedurës Civile; (iii) subjekti ka marrë vendimin për thirrjen e dy ekspertëve në mungesë të palës së paditur dhe pa marrë mendimin e saj, duke mos zbatuar nenet 225 dhe 227 të Kodit të Procedurës Civile.

94. Lidhur me kërkesën e shoqërisë “****” sh.a., për përjashtimin e gjyqtarit A. M. nga gjykimi i çështjes civile, të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: Subjekti nuk ka bërë njoftimin në rrugë shkresore të palës kërkuese për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 21.10.2013, sipas parashikimeve të neneve 128, 130, 141 dhe 144 të Kodit të Procedurës Civile.

95. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵³, lidhur me procesin gjyqësor civil të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka pasur dy praktika të

¹⁵³ Email datë 23.2.2022.

ndryshme, ku njëra prej të cilave ka qenë ajo sipas së cilës, në rastet kur pala e paditur deklarohej në mungesë në seancën e veprimeve përgatitore, nuk procedohej më me njoftimin e saj në vijim për seancat gjyqësore. Ky qëndrim është mbajtur nga ana e tij edhe si rezultat i diskutimeve të natyrës juridike me kolegë të tjerë magjistratë që ndanin të njëjtin mendim. Megjithatë, vijon subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur nga ana e Gjykatës së Apelit është mbajtur një qëndrim tjetër, sipas të cilit, pavarësisht deklarimit të mungesës së palës së paditur në seancën përgatitore, gjykata duhet të realizojë edhe një njoftim tjetër për seancën gjyqësore, atëherë ky qëndrim i Gjykatës së Apelit është reflektuar në vijim edhe nga ana e tij si gjyqtar i shkallës së parë.

96. Për sa i përket mosnjoftimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë të vendimit të ndërmjetëm për kryerjen e aktekspertimeve dhe thirrjen e ekspertëve, sqaron se ligji procedural civil ka përjashtuar detyrimin e gjykatës për njoftimin e vendimit për kryerjen e aktekspertimit, vendimit për caktimin e ekspertëve, si dhe njoftimin e aktekspertimit palës së deklaruar në mungesë. Përveç sa më sipër, vijon subjekti i rivlerësimit, vendimi në fjalë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 16.4.2014, për pasojë ndodhemi përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile është i detyrueshëm për gjykatën që ka dhënë vendimin, për palët dhe trashëgimtarët e tyre, si dhe për çdo institucion tjetër shtetëror (*res judicata*).

97. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se fakti që nga ana e nëpunësit të gjykatës është vendosur shënimi në fletëthirrjen e datës 17.10.2013, “*Mori dijeni me tel për datën dhe orën e gjyqit*”, është prezumuar dijenia e rregullt e palës kërkuese për datën dhe orën e seancës gjyqësore dhe, në këto kushte, është proceduar sipas rregullave të përgjithshme procedurale për pushimin e gjykimit të kërkesës. Një mënyrë e tillë e të proceduarit, vijon subjekti i rivlerësimit, është diktuar edhe nga karakteri i ngutshëm i shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, i cili duhet të përfundojë brenda një kohe sa më të shkurtër.

Analiza e Komisionit

*Lidhur me procesin gjyqësor civil të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*

98. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është gjykuar çështja civile me palë: paditës K. L., E. L.; i paditur “CEZ Shpërndarje” sh.a., me objekt “shpërblimi i dëmit pasuror, jopasuror lidhur me vdekjen e shtetasve K. dhe P. L.”. Padia është paraqitur në gjykatë në datën 3.7.2013 dhe pala e paditur është njoftuar për padinë dhe seancën përgatitore të datës 12.7.2013 me anë të fletëthirrjes së datës 8.7.2013, për 4 ditë. Gjithashtu, subjekti, në seancën përgatitore të datës 12.7.2013, ka marrë vendimin e ndërmjetëm për shqyrtimin e çështjes në mungesë të palës së paditur dhe nuk ka vijuar me njoftimin e palës së paditur për zhvillimin e seancave gjyqësore të datave 16.7.2013 dhe 22.7.2013. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 22.7.2013, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse në shumën 24.000.000 lekë si rezultat i dëmit pasuror dhe jopasuror, duke përfshirë edhe kamatat ligjore. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 16.4.2014. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 16.7.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

99. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi në fjalë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë e, për pasojë, përbën një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili është i

detyrueshëm për gjykatën që ka dhënë vendimin, për palët dhe trashëgimtarët e tyre, si dhe për çdo institucion tjetër shtetëror (*res judicata*). Komisioni, në ushtrim të kompetencave të tij, ka vlerësuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit si gjyqtar që ka gjykuar çështjen dhe ky vlerësim nuk ka të bëjë me zgjidhjen konkrete të çështjes.

100. Komisioni çmon se subjekti në seancën përgatitore të datës 12.7.2013 ka marrë vendimin e ndërmjetëm për shqyrtimin e çështjes në mungesë të palës së paditur, veprim përgatitor që nuk mbështetet në nenin 158/a¹⁵⁴ të Kodit të Procedurës Civile, pasi vendimi për zhvillimin në mungesë sipas nenit 179¹⁵⁵ të Kodit të Procedurës Civile merret në seancë gjyqësore. Në vijim të kësaj shkeljeje procedurale, nuk ka njoftuar palën e paditur për zhvillimin e seancave gjyqësore të datave 16.7.2013 dhe 22.7.2013, sipas parashikimit të nenit 130¹⁵⁶ të Kodit të Procedurës Civile, si dhe ka marrë vendimin për thirrjen e dy ekspertëve në mungesë të palës së paditur dhe pa marrë mendimin e saj, sipas parashikimeve të neneve 225¹⁵⁷ dhe 227¹⁵⁸ të Kodit të Procedurës Civile.

*Lidhur me kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për përjashtimin e gjyqtarit A. M. nga gjykimi i çështjes civile, të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*

101. Rezulton se shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A. M. nga gjykimi i një çështjeje civile ku ajo ishte palë. Kjo kërkesë është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili me vendimin nr. ***, datë 14.10.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit. Në përmbajtjen e vendimit pasqyrohet se në seancën e datës 21.10.2013, gjykata, pasi deklaroi çeljen e saj dhe verifikoi paraqitjen e palës kërkuese, konstaton se nuk është paraqitur dhe rezulton se ishte në dijeni të rregullt për datën dhe orën e seancës, fakt i cili, sipas gjykatës, provohet nga fletëthirrja e datës 17.10.2013, në të cilin është vendosur shënimi “*Mori dijeni me tel. për datën dhe orën e gjyqit*”. Në këto kushte, subjekti, duke arsyetuar se pala kërkuese ka pasur dijeni të rregullt për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, nuk është paraqitur dhe nuk rezultoi që kjo mosparaqitje të ketë ardhur si rezultat i sëmundjes apo shkakut të ligjshëm, ka vendosur pushimin e gjykimit.

102. Komisioni, referuar dispozitave procedurale të kohës së gjykimit, arsyeton se Kodi i Procedurës Civile në nenet 128 e në vijim ka përcaktuar rregullat që kanë të bëjnë me letërthirrjet drejtuar të paditurit, si dhe mënyrën e njoftimit të tij për datat dhe orët e zhvillimit të seancave gjyqësore. Për sa i përket mënyrës së njoftimit, përcaktohet se njoftimi është

¹⁵⁴ Neni 158/a: “Gjyqtari cakton, për çdo çështje, seancën përgatitore, ku thirren palët ose personi i tretë, për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kërkon prej tyre shpjegimet e nevojshme, si dhe përcaktimin e provave për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre. Gjyqtari, me vendim, kryen këto veprime: kërkon nga paditësi që kërkesëpadia të plotësohet me të gjitha elementet e nevojshme të përcaktuara nga nenet 154 dhe 156 të këtij Kodi; vendos për përjashtimin e paditësit nga pagimi i taksës mbi aktet, në rastet e përcaktuara nga ligji. ...vendos se cilët dëshmitarë do të thirren në seancë gjyqësore dhe kërkon nga i padituri ose persona të tjerë akte që ndodhen pranë tyre ...kur është rasti vendos për vënien e sekuestros ose për marrjen e ndonjë mase tjetër për sigurimin e padisë. Kur është rasti vendos për sigurimin e provave...; vendos për pezullimin e gjykimit kur janë rastet e përcaktuara nga neni 297 i këtij Kodi; vendos për pushimin e gjykimit kur janë rastet e përcaktuara nga shkronjat ‘b’ dhe ‘c’ të nenit 299 të këtij Kodi.

¹⁵⁵ Neni 179: “Nëse i padituri nuk paraqitet në seancën e parë dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata cakton një seancë tjetër gjyqësore”.

¹⁵⁶ Neni 130: “...në rastin e personave juridikë privatë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë aktet dhe, në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik...”.

¹⁵⁷ Neni 225: “Caktimi i ekspertit bëhet nga gjykata duke marrë edhe mendimin e palëve e të pjesëmarrësve në gjykim...”.

¹⁵⁸ Neni 227: “Gjykata, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij”.

shkresor (neni 130) dhe elektronik¹⁵⁹ (neni 141). Gjithashtu, në nenin 144 përcaktohet se: *“Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër që garanton një njoftim të rregullt për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin”*.

103. Në rastin konkret rezulton se pala kërkuese është person juridik, adresa e të cilit është publikisht e shpallur në regjistrin elektronik të subjekteve tregtare dhe, si pasojë, bazuar në nenin 130¹⁶⁰ të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi bëhet në mënyrë shkresore në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve. Referuar vendimit gjyqësor, për atë që pasqyrohet, rezulton që njoftimi i kërkuesit nuk është bërë në rrugë shkresore apo me anë të komunikimit elektronik të deklaruar nga ana e tij, por me anë të telefonit. Gjithashtu, në vendim nuk pasqyrohet që personi i thirrur (personi juridik) të ketë konfirmuar me shkrim se ka marrë njoftimin. Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti nuk ka zbatuar dispozitat procedurale për njoftimin e palës kërkuese lidhur me zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 21.10.2013.

104. Në përfundim, bazuar në analizën ligjore të dy rasteve të trajtuara më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

Ankesat e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë

105. Lidhur me ankesën e Avokaturës së Shtetit dhe të Kryeministrisë, për shqyrtimin e një çështjeje civile duke mos e njoftuar Avokaturën e Shtetit, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimet e Ministrisë së Drejtësisë se: (i) nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 79/a i Kodit të Procedurës Civile dhe ligji nr. 10018, datë 13.11.2008 *“Për Avokaturën e Shtetit”*, pasi nuk ka njoftuar Avokaturën e Shtetit për të marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje civile, ku ishte palë një organ i administratës shtetërore; (ii) nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, *“Për kthimin dhe kompensimin e pronave”*, i ndryshuar, pasi kjo çështje është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërkohë që gjykata kompetente në aspektin tokësor është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.10.2013, gjyqtari Laurent Fuçia nuk ka respektuar detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 155, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, pasi ka planifikuar seancën përgatitore pas 7 ditësh.

106. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimet nga hetimi administrativ kryesisht se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 7.10.2013, duke mos u mbështetur në provat e paraqitura nga palët në gjykim, sipas parashikimit të nenit 29 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se: (i) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Vlorë, është shtesë kati e realizuar nga shteti në objektin e ish-pronarit dhe për këtë pasuri nuk është realizuar asnjë procedurë privatizimi nga organet shtetërore; (ii) në kontratën nr. ***, 19.9.2013, pala shitëse i ka kaluar palës paditëse të drejtën e parablerjes*

¹⁵⁹ Lidhur me njoftimin elektronik, sipas nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile, kërkohet që paditësi (kërkuesi) në kërkesëpadinë (kërkesën) e tij të tregojë saktë të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik.

¹⁶⁰ Neni 130: *“...në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve. Në rastin e personave juridikë privatë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë aktet dhe, në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik”*.

*dhe të kompensimit dhe jo të drejtën e pronësisë së sipërfaqes ndërtimore 93 m², me nr. pasurie ***.*

107. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶¹, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Lidhur me njoftimin e Avokaturës së Shtetit*, shpjegon se, pavarësisht parashikimit ligjor të nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile, nga interpretimi sistematik i dispozitave procedurale civile, nga referimi në doktrinën e së drejtës procedurale civile, si dhe nga studimi i praktikës gjyqësore në këtë fushë, ende nuk rezulton të jetë definuar përfundimisht dhe ka konfuzione në lidhje me pozicionin procedural të Avokaturës së Shtetit në një gjykim civil, ku pjesëmarrja është e detyrueshme sipas ligjit. Në vijim, gjykon se një shkelje e tillë procedurale, në aspektin objektiv, referuar nenit 135 të Kushtetutës, si dhe parimit kushtetues të kontrollit të vendimeve të gjykatës më të ulët vetëm nga gjykata më e lartë, mund dhe duhet të përbëjë lëndë ankimi për gjykatën më të lartë, në drejtim të kontrollit në fakt dhe ligj të vendimmarrjes së gjykatës më të ulët, në rastin konkret gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, shpjegon se pas paraqitjes së kërkesës nga ana e saj, me vendim përfundimtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është njohur e drejta për të paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë ndaj vendimit nr. ***, datë 8.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe çështja është e regjistruar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

108. *Lidhur me kompetencën tokësore*, sqaron se duke iu referuar natyrës së mosmarrëveshjes, llojit të padisë, si dhe kërtimeve të palës paditëse, në funksion të përcaktimit të kompetencës tokësore të gjykatës, ka mbajtur qëndrimin se ndodhemi përpara një padie reale, sipas parashikimit të nenit 45 të Kodit të Procedurës Civile, ngrihet në gjykatën e vendit ku ndodhet sendi objekt padie, i cili në rastin konkret ndodhet në qytetin e Vlorës, duke realizuar interpretim sistematik të dispozitës së mësipërme me nenin 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, nga ku, sipas parimit *lex superior derogat lex inferiori*, ka zbatuar drejtpërdrejt dispozitën e ligjit, i cili qëndron më lart në hierarki, nenin 45 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, subjekti i referohet edhe vendimit unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kanë arritur në përfundimin: “...kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile...”.

109. *Për sa i përket planifikimit të seancës përgatitore në një hark kohor prej 8 ditësh, nga momenti i regjistrimit të padisë në gjykatë*, sqaron se si gjyqtar i çështjes nuk ka pasur asnjë kërkesë të motivuar të palës paditëse për caktimin e seancës përgatitore në më pak se 10 ditë, por mund të jetë ndodhur në kushtet e ndonjë lajthimi në llogaritjen e afatit të planifikimit të seancës së parë gjyqësore, nga momenti i regjistrimit të padisë, për shkak të numrit relativisht të madh të çështjeve gjyqësore të planifikuara.

110. *Sa i përket vendimit civil nr. ***, datë 7.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*, shpjegon se nga provat e administruara gjatë gjykimit ka rezultuar e provuar se me anë të kontratës së shitjes të së drejtës reale, datë 1.8.2012, lidhur midis paditësve, në cilësinë e blerësve dhe trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Sh. V., në cilësinë e shitësve, është kaluar e drejta reale e parablerjes në favor të paditësve A. dhe E. D. për sipërfaqen 214 m², ndërsa me

¹⁶¹ Email datë 23.2.2022.

anë të kontratës së shitjes datë 19.9.2013, lidhur po midis të njëjtave palë, paditësit kanë blerë edhe sipërfaqen 93 m² të katit të tretë të godinës. Më pas, shpjegon se e drejta e parablerjes është një e drejtë reale dhe, si e tillë, mund të disponohet lirisht nga pronari përmes kontratës së dhurimit ose të shitjes, sikundër ka ndodhur në rastin konkret dhe një konkluzion i tillë gjen mbështetje edhe në vendimin unifikues civil nr. 23, datë 1.4.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

111. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është gjykuar çështja civile me nr. *** akti, me palë: paditës M. B. (V.); i paditur AKKP Tiranë, me objekt “anulimi i pikës 2 të vendimit nr. ***, datë 23.6.2009, të ZRKKP-së Vlorë”, duke njohur të drejtën e parablerjes edhe për sip. 93 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në qytetin e Vlorës.

112. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se me anë të vendimit nr. ***, datë 23.6.2009, të AKKP-së Tiranë, është vendosur njohja dhe kthimi i pasurisë me sip. 403 m², si dhe e drejta e parablerjes e sipërfaqes 214 m² në favor të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Sh. V. dhe rrëzimin e kërkesës në lidhje me sip. 93 m², me arsyetimin se kjo sipërfaqe është regjistruar në emër të shtetasve B. dhe F. M.

113. Për këtë pasuri është zhvilluar një proces gjyqësor, ku gjatë gjykimit është konstatuar se kjo është shtesë kati e realizuar nga shteti në objektin e ish-pronarit dhe me vendimin nr. ***, datë 4.7.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pavlefshmëria e kontratës së privatizimit në emër të shtetasve B. dhe F. M., si dhe fshirja e regjistrimit në emër të tyre duke u regjistruar në favor të shtetit. **Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 15.5.2013.**

114. Pas këtij fakti, në kushtet kur ishte zhdukur pengesa për të cilin nuk i ishte njohur e drejta e parablerjes për sip. 93 m², paditësi, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të të ndjerit Sh. V., ka kërkuar me anë të padisë drejtuar gjykatës që t’i njihet e drejta e parablerjes edhe për sip. 93 m², me nr. pasurie ***. Ka rezultuar se në këtë proces gjyqësor nuk është njoftuar Avokatura e Shtetit.

115. Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 8.7.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë, anulimin e pjesshëm të vendimit nr. ***, datë 23.6.2009, të ZRKKP-së Vlorë, vetëm në lidhje me pikën 2 të tij, duke njohur të drejtën e parablerjes në favor të palës paditëse dhe në lidhje me sip.93 m² me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Vlorë. **Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.8.2013, pasi nuk është ankimuar.**

116. Në vijim, trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Sh. V., me anë të kontratës së shitjes datë 1.8.2012, i kanë kaluar të drejtën reale të parablerjes palës paditëse A. dhe E. D. për sipërfaqen prej 214 m² dhe me kontratën e shitjes së datës 19.9.2013, të lidhur po midis tyre, paditësit kanë blerë edhe të drejtën e parablerjes për sip. 93 m² të katit të tretë të godinës.

117. Blerësit e të drejtës reale të parablerjes i janë drejtuar ZVRPP-së Vlorë, me qëllim regjistrimin e sipërfaqeve të mësipërme, por ky institucion ka refuzuar regjistrimin, duke arsyetuar se nuk dispononte dokument ligjor për regjistrim.

118. Në vijim, blerësit A. D. dhe E. D. i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në çështjen civile nr. *** akti, me palë: paditës A. D., E. D.; i paditur ZVRPP-ja Vlorë, me objekt “detyrimi i palës së paditur të regjistrojë sipërfaqen prej 117 m², me nr.

pasurie ***, vol. ***, f. *** dhe sipërfaqen prej 190 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** dhe nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në katin e tretë të godinës trekatëshe të quajtur ish-hetuesia, godina me nr. pasurie ****”. Konstatohet se edhe në këtë proces gjyqësor nuk është njoftuar Avokatura e Shtetit.

119. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 7.10.2013, ka vendosur: “...detyrimin e palës së paditur ZVRPP-Vlorë që të regjistrojë në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, në emër të palës paditëse, sipërfaqen prej 117 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** [...], të ndodhur në katin e tretë të godinës trekatëshe, të quajtur ish-hetuesia [...]”. **Ky vendim nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 29.10.2013.**

120. Sa më sipër, në analizë të fakteve të rezultuara nga hetimi dhe të shpjegimeve të subjektit, Komisioni çmon se mosnjoftimi i institucionit të Avokaturës së Shtetit gjatë procesit përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, kjo në referencë të vendimit unifikues nr. 13, datë 24.3.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese¹⁶².

121. Zbatimi i kompetencës tokësore nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes është në përputhje me vendimin unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

122. Komisioni çmon se mosrespektimi i afatit 10-ditor lidhur me njoftimin e padisë nga ana e subjektit, në referencë të nenit 155, paragrafi 1¹⁶³ i Kodit të Procedurës Civile, nuk ka sjellë pasoja për palët dhe, për pasojë, nuk vlerësohet si cenim i elementeve të procesit të rregullt ligjor.

123. Komisioni çmon se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit për detyrimin e ZVRPP-së të regjistrojë pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të paditësve A. dhe E. D., duke arsyetuar, ndër të tjera, se gjykata çmon se palës paditëse i ka lindur e drejta për të kërkuar regjistrimin e pasurisë objekt gjykimi... në kushtet kur ajo arriti të provojë përpara gjykatës jo vetëm titullin e saj të pronësisë mbi sendin, por edhe origjinën e krijimit të këtij titulli, e konkretisht pala paditëse ka fituar pronësinë në lidhje me këtë pasuri sipas kontratës së shitjes datë 19.9.2013, përbën një mangësi në arsyetim dhe vlerësim jo të drejtë nga ana e subjektit të njohurive ligjore. Subjekti, në arsyetim, pavarësisht se analizon origjinën e krijimit të këtij titulli, ky titull është një kontratë shitjeje e një të drejte parablerjeje, që në asnjë mënyrë nuk mund të jetë një mënyrë e fitimit të pronësisë për një pasuri, e cila nuk ka qenë blerë nga shitësit e kësaj të drejte.

124. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se kjo mangësi duhet të jetë pjesë e vlerësimit profesional të organeve kompetente, në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

125. Ndërkohë, lidhur me efektin që kjo çështje ka në procesin e rivlerësimit të subjektit, Komisioni sjell në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vendimin nr. 2/2017, ku arsyetohet se: “Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të

¹⁶² Vendimi nr. 27, datë 27.7.2009 e në vijim.

¹⁶³ I shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017.

pasakta' nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

Në rastin konkret, vlerësojmë se shkelja nuk mund të konsiderohet thelbësore dhe serioze dhe nuk evidentohen një seri çështjesh gjykimesh të gabuara të kësaj natyre, që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit e, për pasojë, ta konsiderojnë këtë vendimmarrje, e cila cenon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, komponent ky i rëndësishëm i procesit të rivlerësimit”.

126. Komisioni, në një vlerësim tërësor të të gjitha elementeve të tilla, si: (i) identifikimi i shkeljes së kryer nga subjekti dhe vlerësimi paraprak i ekzistencës së arsyeve që përbëjnë shkelje disiplinore; (ii) vlerësimi nëse kjo shkelje e subjektit e vetme në kriterin profesional, duke mos pasur elemente nga dy kriteret e tjera të rivlerësimit, a mund të konkurrojë me vlerësimin e përgjithshëm sipas pikës 5 të nenit 61; (iii) në një vlerësim logjik të pikës 4 të nenit 59 në raport me pikën 5 të nenit 61 – vlerëson se në rastin konkret nuk mund të arrihet në konkluzionin se është cenuar besimi i publikut tek drejtësia, për atë kohë sa nuk u arrit të provohej se subjekti ka pasur një qëllim të caktuar për këtë vendimmarrje.

127. Në përfundim, Komisioni vlerëson se kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit kompetent për inspektim, për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

128. Lidhur me ankesën e shtetas M. T. (K.), për marrjen e vendimit nr. ***, datë 25.2.2014, në kundërshtim me ligjin material dhe procedural, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti në gjykimin e çështjes civile nr. *** akti ka marrë vendimin për zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur në seancën e veprimeve përgatitore, duke vepruar jo sipas parashikimit të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se ky vendim merret në seancë gjyqësore.*

129. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶⁴, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se u qëndron shpjegimeve të dhëna.

130. Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është gjykuar çështja civile me nr. *** akti, me palë: paditës M. T. (K.); i paditur K. K., me objekt “detyrimi i palës së paditur ta njohë trashëgimtare të S. K., pavlefshmëri testamenti”. Ka rezultuar se i ndjeri K. K. ka ndërruar jetë në datën 11.10.1960 dhe bashkëshortja e tij S. K. ka ndërruar jetë në datën 10.11.1956, duke lënë të dy si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tyre fëmijët A., M., K., V. dhe S., të cilët kanë trashëguar nga 1/5 pjesë të pasurisë trashëgimore. Paditësja është trashëgimtare e babait të saj S. K. së bashku me nënën E. K. dhe fëmijët e tjerë T., V., A. dhe L., duke trashëguar prej tyre nga 1/6 pjesë të pasurisë së S. K. ose 1/30 pjesë të K. K. Trashëgimtarë të K. K. (të birit të K. K.) ka qenë bashkëshortja A. K. dhe fëmijët Th. dhe vajza S., duke trashëguar nga 1/3 e pasurisë së K. K. ose 1/15 e K. K.. Sipas dy AMTP-ve të datës 17.2.1994, A. K. ka pasur në pronësi dy sipërfaqe tokë bujqësore, 3.530 m² dhe 7.190 m²,

¹⁶⁴ Email datë 23.2.2022.

në fshatin ***, ndërkohë që ajo ka qenë në trung familjar e vetme. Gjithashtu, figuron e regjistruar prona nr. *** në emër të të ndjerit K. K., V. e A. K.. Me testamentin e mbajtur me akt noterial e ndjera ka disponuar në favor të nipit të saj K. K. disa prona të ndodhura në ***, të cilat i ka pasur trashëgim dhe disa prona të fituara në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, një shtëpi në bashkëpronësi të ndodhur në *** dhe të gjitha pasuritë e tjera në emrin e saj dhe ato të krijuara pas vdekjes. Padiësja ka ngritur padinë, duke pretenduar se testamenti është i pavlefshëm, pasi e ndjera ka disponuar një pasuri që nuk e ka pasur në pronësi në momentin e hartimit të testamentit, si dhe për faktin se testamenti është hartuar në prani të një personi, i cili nuk mund të ishte i besuar, pasi gëzonte edhe cilësinë e trashëgimtarit ligjor të së ndjerës.

131. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 25.2.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiësë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 9.7.2015, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 25.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë duhet të kishte hetuar faktin se cila ishte pasuria që e ndjera A. K. e kishte përfituar personalisht si anëtare e kooperativës bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, cila ishte pasuria që ajo kishte në trashëgim nga i ndjeri K. K., gjykimi i çështjes në shkallë të parë është bërë në mungesë të palës së paditur dhe vendimi i zhvillimit të gjykimit në mungesë është marrë që në seancë përgatitore, gjë që bie ndesh me nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile.

132. Komisioni arsyeton edhe një herë se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e zhvillimit të gjykimit në mungesë të palës së paditur në seancën e veprimeve përgatitore, duke vepruar jo sipas parashikimit të neneve 179 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se ky vendim merret në rastet kur i padituri nuk paraqitet në seancë gjyqësore.

133. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, por që e vetme nuk mund të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

134. Lidhur me ankesën e shtetasit L. I. kundër gjyqtarëve S. H., Laurent Fuçia dhe A. S., për dhënien e vendimit nr. ***, datë 23.5.2018, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti, në marrjen e vendimit nr. ***, datë 23.5.2018, i ka mohuar të pandehurit të drejtën për t’u dëgjuar, e cila ka sjellë si pasojë cenimin e të drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij në lidhje me aktekspertimin e administruar në gjykim.*

135. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶⁵, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pretendimet e të pandehurit për aktekspertimin e kryer gjatë hetimeve paraprake dhe për kërkesën e tij për kryerjen e një akti të ri ekspertimi, gjykata ka vendosur refuzimin e një kërkesë të tillë, pasi ka çmuar se nuk kishte vend për riekspertim, për aq kohë sa nuk janë konstatuar elemente pavlefshmërie apo papërdorshmërie të aktekspertimit të kryer gjatë hetimeve paraprake. Për sa i përket konstatimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar vendimin e ndërmjetëm për refuzimin e marrjes së provave nga i pandehuri, subjekti i rivlerësimit shpjegon se Gjykata e Apelit është gjykatë fakti e shkallës së dytë me juridiksion rishikues në drejtim të mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit dhe në lidhje me mënyrën

¹⁶⁵ Email datë 23.2.2022.

e çmuarjes dhe vlerësimit të provave në gjykimin në shkallë të parë dhe, në këto kushte, nuk ka pasur asnjë pengesë procedurale që, nga ana e kësaj gjykate, qoftë edhe kryesisht, të disponohej me vendim të ndërmjetëm për përsëritjen e pjeseshme të shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 427, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale.

136. Nga analiza e Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë mbi bazën e kallëzimit të disa shtetasve ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale “falsifikim të dokumenteve” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, në ngarkim të shtetasit L. I. Ka rezultuar se i pandehuri për njohjen, kthimin dhe regjistrimin e pasurisë, ndërmjet disa dokumenteve, ka përdorur edhe dokumentin vërtetim pronësie, datë 4.9.1993, lëshuar nga përgjegjësi i Seksionit të Kadastrës pranë Këshillit të Rrethit Vlorë. Pas kryerjes së ekspertimit tekniko-grafik ka rezultuar se ky dokument ishte i falsifikuar. Gjithashtu, ka rezultuar se i pandehuri ka përdorur dokumentin e falsifikuar “vërtetim pronësie”, datë 4.9.1993, në procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku është vendosur pushimi i gjykimin të çështjes civile dhe në procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. **, datë 21.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

137. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me trup gjykues S. H., Laurent Fuçia dhe A. S., me vendimin nr. ***, datë 23.5.2018, ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe për veprën penale “pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287/1, gerrat “a” dhe “dh” të Kodit Penal, duke e dënuar përfundimisht me 10 vjet burgim. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 25.6.2021, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 23.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kthimin e akteve kësaj gjykate për rigjykim me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se: *“[...] gjykata e shkallës së parë ka pranuar rrethanat e faktit, ashtu sikurse janë konstatuar nga organi i akuzës [...], duke mos bërë asnjë analizë se përse argumentet dhe provat e paraqitura nga i pandehuri nuk merren në konsideratë [...], i pandehuri ka pretenduar se njohjen dhe kthimin e pronës ai e ka realizuar jo vetëm bazuar mbi vërtetimin që pretendohet si i falsifikuar, por edhe mbi disa prova të tjera, si dokumente arkivore dhe kadastrale. Gjithashtu, ai ka ngritur disa pretendime në lidhje me aktin e ekspertimit, duke dhënë argumente për pasaktësinë e tij, si dhe duke paraqitur edhe një aktekspertim privat. Të gjitha këto prova nuk janë pranuar për shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, duke mos dhënë arsye as në vendimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për marrjen e tyre dhe as në vendimin përfundimtar”.*

138. Komisioni çmon se, pavarësisht se subjekti nuk ka qenë në cilësinë e kryesuesit (relatorit) të çështjes, nuk mund të tregohet indiferent ndaj zhvillimit të gjykimin dhe provave dhe dokumentacionit të administruar në gjykim. Si pasojë, Komisioni vlerëson se në rastin konkret trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pjesë e të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, nuk ka arsyetuar vendimin gjyqësor, sipas standardit të vendosur nga Gjykata Kushtetuese.

139. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti, edhe pse jo në rolin e kryesuesit, ka treguar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor duke u bazuar në tregues të tillë, si struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës, sipas parashikimit të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, por kjo mangësi në rastin konkret nuk mund të përbëjë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit.

DENONCIME

140. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Laurent Fuçia janë administruar 23 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 5 denoncime, si vijon:

140.1. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 22.2.2018, të shtetasit E. K.,** i cili akuzon subjektin se ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, pa analizuar mjaftueshmërinë e veprimeve hetimore të organit të akuzës, duke vepruar jo sipas parashikimit të neneve 328 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale dhe jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶⁶, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se konstatimet e Komisionit lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes, si rezultat i mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal e atij material penal, si dhe vlerësimit dhe çmuarjes së akteve të fashikujve hetimorë sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit. Duke respektuar parimin kushtetues të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, vlerëson se, në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Apelit ka qenë rrjedhojë e një interpretimi të ndryshëm të ligjit procedural penal të bërë nga gjykata e shkallës së parë, si dhe e një vlerësimi të ndryshëm të akteve të fashikujve hetimorë nga ai i bërë nga gjykata e shkallës së parë.

Ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi A. V. ndaj shtetasit L. B., ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Konkretisht, kallëzuesi ka pretenduar se nëpërmjet falsifikimit të nënshkrimit të tij dhe nënës së tij, shtetases L. B. në prokurën e përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008, shtetasi L. B. ka shitur tek persona të tjerë pronën, e cila është njohur me vendim të ZRKPP-së Vlorë. Gjithashtu, ka rezultuar se mbi bazën e kallëzimit të shtetasit V. A. është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Kallëzuesi ka pretenduar se është falsifikuar nënshkrimi i tij si person i besuar i shtetases K. B. në prokurën e përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008, në deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.9.2009 dhe në kontratën e ndërmjetësimit nr. ***, datë 12.9.2009. Në këto rrethana, prokurori i çështjes ka vendosur bashkimin e dy procedimeve në një procedim të vetëm, me nr. ***. Nga hetimi paraprak është provuar se prokura e datës 15.12.2008 është përdorur në disa kontrata shitjeje të nënshkruara nga shtetasi L. B. si përfaqësues i trashëgimtarëve të ish-pronarëve. Organi procedues ka vendosur sekuestrumin e kopjes së prokurës së përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008, pranë zyrës së noterit, si dhe të prokurës së posaçme nr. ***, datë 20.6.2007, por nuk është bërë e mundur gjetja e origjinalit të prokurës së përgjithshme.

Pavarësisht këtij fakti, nga ana e organit të akuzës është vendosur marrja e modeleve eksperimentale të dorëshkrimit të shtetasve që figuron në aktet noteriale, me qëllim kryerjen e ekspertimit teknik-grafik të nënshkrimit, por nga ana e Institutit të Policisë Shkencore është kthyer përgjigje se nuk mund të procedohet me kryerjen e aktit, për shkak të mungesës në origjinal të dokumentit objekt ekspertimi. Si pasojë, organi i akuzës, me vendimin e datës 15.7.2016, ka vendosur pushimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi kallëzuesit kanë paraqitur

¹⁶⁶ Email datë 23.2.2022.

kërkesën për kundërshtimin e vendimit të prokurorit përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit të shtetasve V. A. dhe A. V., me arsyetimin se në rrethanat kur nuk është bërë e mundur kryerja e ekzaminimit teknik-grafik të nënshkrimit në këtë dokument si provë shkencore, e cila do të vlerësohej në unitet me prova të tjera, nuk është e mjaftueshme vetëm besueshmëria në pretendimet e ngritura nga ana e subjekteve kallëzues, pa u lidhur dhe vlerësuar edhe në unitet me prova të tjera. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 2.7.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 21.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit për pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. ***, duke u urdhëruar vazhdimin e hetimeve dhe në arsyetimin e vendimit ka lënë edhe detyrat konkrete për organin e akuzës¹⁶⁷.

Komisioni, referuar jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁶⁸, arsyeton se në gjykimin me objekt “kundërshtimi i vendimit të pushimit të çështjes”, funksioni i gjykatës është kontrolli lidhur me zbatimin e drejtë dhe korrekt të rasteve të parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Në gjykimin e këtyre çështjeve gjykata shqyrton jo vetëm bazueshmërinë e kërtimeve të paraqitura nga ankuesi, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorit janë respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji lidhur me pushimin e çështjes penale¹⁶⁹. Në këtë mënyrë, gjykata shndërrohet në garantimin e kontrollit të veprimtarisë hetimore të prokurorisë vetëm në aspekt të verifikimit të “mjaftueshmërisë së veprimeve hetimore” të ndërmarra.

Në rastin konkret, rezulton që Gjykata e Apelit Vlorë, gjatë ushtrimit të funksionit të saj si gjykatë më e lartë, pasi ka çmuar aktet e fashikujve hetimorë, ka arritur në përfundim të ndryshëm nga gjykata e rrethit, duke vlerësuar se nga ana e organit të akuzës nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore. Komisioni vlerëson se çmuarja e provave të akteve të fashikujve penalë nga Gjykata e Apelit Vlorë ka lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe me verifikimin e korrektësisë së vendimit të gjykatës së rrethit, kriteret të cilat sipas nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, nuk janë objekt i rivlerësimit të aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit.

¹⁶⁷ (i) Gjetjen e kopjes origjinale të prokurës së pretenduar si të falsifikuar në ZVRPP, në zyrën noteriale ku mund të jetë bërë pjesëtimi i pronës së fituar me vendim të ZVKKK Pronave apo në dosjet e vendimeve gjyqësore të administruara gjatë hetimeve paraprake; (ii) pyetjen e personave që figurojnë si të përfaqësuar në prokurë nëse e kanë firmosur atë dhe nëse disponojnë kopje të saj; (iii) verifikimin e regjistrit të noterit që e ka hartuar këtë prokurë me qëllim që të provohet nëse prokura e datës 15.12.2008, e nënshkruar nga 7 persona, ka ekzistuar apo jo, apo ka ekzistuar një prokurë e mëparshme me 4 persona, e zëvendësuar me atë me 7 persona; (iv) pyetjen e shtetasit L. B. se përse nuk kishte realizuar përfaqësimin e interesave të trashëgimtarëve dhe në kontratën e ndërmjetësimit të datës 12.9.2009, me qëllim sqarimin e faktit nëse personat e përfshirë në prokurën e datës 15.12.2008 i kishin dhënë të drejtë shtetasit L. B. të bënte shitje e disponime për pasurinë në emër të tyre, pra a ekzistonte kjo prokurë në përmbajtje, ashtu si ishte prezantuar apo ishte e falsifikuar; (v) pyetjen e shtetasit G. O. nëse ka realizuar ndonjë kontratë përfitimi në zbatim të kontratës së ndërmjetësimit, me kë e ka realizuar atë dhe si është përfaqësuar interesi i shitësve në këtë kontratë.

¹⁶⁸ Vendim nr. 2, datë 20.6.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁶⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 328: “Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimat nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj...”.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

140.2. Në lidhje me denoncimet nr. * prot., datë 9.12.2021 dhe nr. *** prot., datë 19.4.2022**, të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), që akuzon trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Vlorë, M. B., S. D. dhe Laurent Fuçia, se ka marrë vendimin e datës 2.12.2021 pa u bazuar në dispozitat procedurale, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti në marrjen e vendimit nr. ***, datë 2.12.2021, si anëtar i trupit gjykues, nuk ka vlerësuar zbatimin e dispozitave të neneve 130 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me njoftimin e vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, subjektit OSHEE sh.a.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷⁰, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga provat e administruara në gjykimin në shkallë të parë ka rezultuar e provuar se vendimi nr. ***, datë 19.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është komunikuar shoqërisë “OSHEE” sh.a, me dëftesën e komunikimit të datës 27.12.2019, e cila është nënshkruar nga punonjësja e kësaj shoqërie, znj. O. A., dhe e vulosur me vulën e kësaj shoqërie. Gjithashtu, ka rezultuar se fletëthirrja e gjykatës është dërguar në datën 2.10.2019, është nënshkruar nga punonjësja e shoqërisë “OSHEE” sh.a., dega Vlorë, znj. K. N. dhe është vulosur me vulën përkatëse të shoqërisë, “***”.

Më pas, shpjegon se nga interpretimi sistematik i nenit 130 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 28 të Kodit Civil, në rastin e personit juridik privat, njoftimi i akteve procedurale do të bëhet në qendrën e tij, e cila si rregull është vendi ku ndodhet organi drejtues i tij, me përjashtim të rastit kur në statut ose në aktin e themelimit është parashikuar se qendra e personit juridik ndodhet në një vend tjetër, të ndryshëm nga vendi ku ndodhet organi drejtues i tij. Referuar ekstraktit të lëshuar nga QKB-ja, vijon subjekti i rivlerësimit, rezulton e provuar se për palën kërkuese, si qendër e saj, krahas vendit ku ndodhen organet drejtuese të kësaj shoqërie, janë të pasqyruara edhe vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit tregtar të saj, ku midis të tjerave njëri prej këtyre vendeve ndodhet në qytetin e Vlorës, në adresën përkatëse. Në këto rrethana, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se ndodhemi përpara përjashtimit nga rregulla e parashikuar nga neni 28 i Kodit Civil dhe, për pasojë, njoftimet e kryera në këtë adresë konsiderohen të vlefshme dhe të rregullta.

Referuar vendimit nr. ***, datë 2.12.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë, rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është gjykuar kërkesa civile e OSHEE sh.a., me objekt “rivendosja në afat e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”. Ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2019, ka vendosur detyrimin e të paditurit OSHEE sh.a., njësia Vlorë, të dëmshpërblejë paditësin N. H. për shkak të dëmit të shkaktuar nga ndërprerja e energjisë elektrike në shumën 291.723 euro. Gjithashtu, është provuar se njoftimi i vendimit përfundimtar për palën e paditur është realizuar nëpërmjet dorëzimit të aktit në filialin e saj në qytetin e Vlorës. Shoqëria “OSHEE” sh.a. ka pretenduar se komunikimi i vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, është bërë në shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile mbi njoftimin e palëve, pasi është bërë në degën e OSHEE-së Vlorë, degë e cila nuk ka personalitet juridik.

¹⁷⁰ Email datë 23.2.2022.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 18.3.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së shoqërisë “****” sh.a. dhe rivendosjen e saj në afat për të bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë ndaj vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin se njoftimi i vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, është i pavlefshëm, pasi nuk është bërë në adresën e qendrës së subjektit “****” në Tiranë.

Gjykata e Apelit Vlorë¹⁷¹, me vendimin nr. ***, datë 2.12.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 18.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se është provuar se njoftimi i vendimit është bërë pranë *** sh.a., dega Vlorë dhe sipas ekstraktit të QKB-së, si qendër e saj, krahas vendit ku ndodhen organet drejtuese, janë të pasqyruara edhe vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit tregtar të saj, ku midis të tjerave njëri prej këtyre vendeve ndodhet në qytetin e Vlorës.

Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë¹⁷² rezulton se pranë kësaj gjykate është gjykuar çështja civile me palë: paditës N. H.; i paditur ***, njësia Vlorë, me objekt “detyrimi i palës së paditur për shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike në shumën 48.917.735 lekë”. Kjo çështje është gjykuar nga gjyqtari A. B., i cili në përfundim të gjykimit ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë, detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin për shkak të dëmit të shkaktuar nga ndërprerja e energjisë elektrike në shumën 291.723 euro. Në vendim pasqyrohet shënimi se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 29.1.2020, pasi nuk u ankimua. Gjithashtu, nga informacioni i administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë¹⁷³ rezulton se dosja gjyqësore është sekuestruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2020.

Referuar fakteve të mësipërme, Komisioni arsyeton se ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në nenin 9, pika 2, parashikon: “2. *Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë*”. Gjithashtu, në nenin 43 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “*..paditë që rrjedhin nga marrëdhënie juridike me një degë ose agjenci lokale të personit juridik, mund të ngrihen edhe në gjykatën ku ka qendrën dega ose agjencia, si dhe në gjykatën e shkallës së parë ku personi juridik ka një ndërtesë me aktivitet ose një përfaqësues të autorizuar që të paraqitet në gjykim për objektin e padisë*”. Në analizë të dispozitave të mësipërme, rezulton qartë që dega gëzon personalitet juridik më vete njësoj si shoqëria tregtare dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime, në rast se ajo ka vepruar kundrejt të tretëve në emër të vet ose të shoqërisë¹⁷⁴ dhe, në këtë kuptim, gëzon të drejtën e përfaqësimit në gjykatë për mbrojtjen e interesave të saj ose të shoqërisë mëmë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se mosmarrëveshja objekt gjykimi ka lindur për shkak se ***, njësia Vlorë, kishte lëshuar ndaj shtetasit N. H. një faturë tatimore të konsumit të energjisë elektrike,

¹⁷¹ Me trup gjykues M. B. (kryesuese), S. D. dhe Laurent Fuçia (anëtarë).

¹⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2023 (protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.2.2023), e administruar pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjektiv të rivlerësimit.

¹⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2023.

¹⁷⁴ Vendimet nr. ***, datë 26.6.2012 dhe nr. ***, datë 2.7.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

duke e ngarkuar me një detyrim monetar të konsiderueshëm, e më pas ka vijuar me ndërprerjen e energjisë elektrike. Në këto kushte, shtetasi N. H. ka paraqitur padi në gjykatë, ku ka thirrur si palë të paditur në gjykim ***-në, njësia Vlorë. Nga verifikimi i ekstraktit historik i regjistrit tregtar në faqen elektronike të QKB-së¹⁷⁵ rezulton se një nga vendet e deklaruara të ushtrimit të aktivitetit të subjektit “****” sh.a.¹⁷⁶ është edhe qyteti i Vlorës. Referuar këtyre rrethanave faktike, Komisioni, duke marrë në konsideratë që: (i) ligji nr. 9901/2008, i ka njohur personalitet juridik degëve të personit juridik; (ii) mosmarrëveshja objekt gjykimi ka lindur nga veprimtaria e ***, njësia Vlorë; (iii) palë e paditur në procesin gjyqësor ka qenë ***, njësia Vlorë – arrin në përfundimin se formimi i ndërgjyqësisë ka qenë i rregullt dhe, për pasojë, edhe njoftimi i vendimit nr. ***, datë 19.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë pranë ***, njësia Vlorë, është bërë në përputhje me nenin 316¹⁷⁷ të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon se vendimet e gjykatës u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

140.3. Në lidhje me denoncimin nr. *, datë 28.4.2022**, të shtetasve F. M. dhe Sh. J., të cilët akuzojnë subjektin e rivlerësimit për marrjen e një vendimi të padrejtë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti në marrjen e vendimit nr. ***, datë 28.7.202, ka konkluduar se në rastin konkret çështja përbën “gjë të gjykuar”, pa vlerësuar karakterin vazhdues të veprave penale “shpërdorim i kompetencave”, “falimentim i provokuar”, “fshehje e të ardhurave”, sipas orientimit të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë në vendim nr. ***, datë 9.10.2018.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷⁸, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për çështjen në fjalë kemi të bëjmë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë, vendimet e së cilës kontrollohen nga Gjykata e Lartë sipas nenit 135/1 të Kushtetutës. Më pas shpjegon se nga ana e organit të prokurorisë janë zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë në vendimin nr. ***, datë 9.10.2018, duke konkluduar se nuk ndodhej përpara elementeve të veprave penale. Në vijim shpjegon se vendimi i pushimit të procedimit penal nuk konsiderohet vendim i formës së prerë në kuptimin material (sipas parimit *non bis in idem*), por ai është në çdo kohë i revokueshëm nëse dalin të dhëna apo prova të reja, të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme për ekzistencën e elementeve të ndonjë veprave penale dhe në rastin konkret nuk ka ekzistuar asnjë e dhënë që të tregonte për prezencën e fakteve të dyshuara si penale, të cilat të kenë ngjarë apo ndodhur pas rifillimit të hetimeve apo pas detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 9.10.2018.

Sa i përket natyrës vazhduese të veprave penale për të cilat është paraqitur kërkesa e organit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal, është mbajtur në konsideratë vendimi unifikues penal nr. ***, datë 6.10.2000¹⁷⁹, duke arritur në përfundimin se në rastin konkret nuk ndodhemi

¹⁷⁵ https://qkb.gov.*/

¹⁷⁶ Ndërruar emri në OSHEE Group në datën 26.2.2020.

¹⁷⁷ Kodi i Procedurës Civile, neni 316: “Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tri ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tri ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar...”

¹⁷⁸ Email datë 23.2.2022.

¹⁷⁹ Sipas të cilit: “...për të pasur krim vazhdues duhet të jenë të pranishëm elementë të tillë si; secila veprë nuk duhet të qëndrojë si akt më vete, veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale, të ekzistojë një mendim kriminal, i cili të bashkojë aktet e veçanta në një tërësi të vetme të pandashme. Për të pasur krim vazhdues është e domosdoshme që personi të ketë parashikuar hollësitë rreth veprimtarisë së tij kriminale, siç janë koha, mjetet, forma, mënyra

përpara krimit vazhdues. Në përfundim vlerëson se hetimet për rastin konkret kanë qenë të plota, në përputhje me detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe me të drejtë nga ana e organit të prokurorisë është konkluduar se nga këto veprime nuk ka fakte të reja penale.

Nga hetimi i Komisionit rezulton se në datën 13.4.2018 shtetasit Sh. J. dhe F. M. kanë depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kallëzim penal, duke shpjeguar se janë përfaqësues të shoqërisë “****” dhe kallëzojnë administratorin e kësaj shoqërie, shtetasin K. K., për vjedhjen dhe dëmet që i ka shkaktuar kësaj shoqërie që nga viti 1996 e deri në vitin 2010. Sipas kallëzuesve, megjithëse shoqëria anonime dispononte pasuri, shtetasi K. K. filloi ta falimentonte, duke nxjerrë autobusët dhe makineritë e tjera jashtë përdorimit dhe i shiste për skrap, duke mos marrë parasysh asnjë vendim të aksionerëve dhe ato si aksionerë të shoqërisë që nga viti 1996 e deri në mbylljen e saj nuk janë shpërblyer.

Gjithashtu, ka rezultuar se në datën 6.11.1997 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga 39 punonjës të Parkut të Naftës Patos, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, ku objekt i këtij procedimi kanë qenë pretendimet e kallëzuesve për mosregjistrimin e shoqërisë nga drejtori i saj K. K. në degën e tatim-taksave, duke fshehur tatimet e taksat e shtetit, si dhe pretendimi i kallëzuesve se drejtori i shoqërisë ka abuzuar me fondin e banesave të dhënë nga EKB-ja. Me vendimin e datës 28.12.1998, prokurori i çështjes ka vendosur pushimin e çështjes. Më pas, në datën 26.5.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve Sh. J., G. K. dhe F. M. ndaj shtetasve K. K. dhe V. Sh. ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprat penale të parashikuara “shpërdorim i kompetencave” dhe “dhënia e informacioneve të rreme”, të parashikuara nga nenet 164 dhe 168 të Kodit Penal¹⁸⁰. Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes, pasi dosja ishte kthyer më parë nga gjykata, ka vendosur pushimin e procedimit penal.

Lidhur me kallëzimin penal të paraqitur në datën 13.4.2018, prokurori i çështjes, me vendimin e datës 30.4.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk përmban elementet e një figure veprë penale, por kualifikohet si marrëdhënie juridiko-civile, si dhe konstatohet parashkrimi i ndjekjes penale. Pas ankimit të kallëzuesve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 12.6.2018, ka vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 9.10.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe prishjen e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke përcaktuar në përmbajtjen e vendimit edhe detyrat e prokurorisë.

Mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. *** në lidhje me veprat penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “shpërdorim i kompetencave”, “falimentim i provokuar” dhe “fshehje e të ardhurave”, të parashikuara nga nenet 287, 164, 193 dhe 180 të Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur në gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se në rastin konkret nuk ndodhemi përpara veprave penale të parashikuara nga nenet 287, 164, 193 dhe 180 të Kodit Penal. Gjykata e

për kryerjen e krimit. Mendimi i vetëm kriminal, si bosht i kërkesës për krimin vazhdues, presupozon që i pandehuri të ketë përpunuar në mendjen e tij zhvillimin e veprimeve konkrete në kohë e hapësirë. Pavarësisht se është 'mendim' ai 'lexohet' nëpërmjet veprimeve konkrete që kryen i pandehuri për realizimin e veprës penale”.

¹⁸⁰ Kallëzuesit kanë pretenduar se shtetasi K. K., në kundërshtim me ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992, ka riblerë aksionet e shoqërisë, nuk ka thirrur mbledhjet e asamblesë së aksionarëve dhe nuk i ka shpërndarë fitimet e shoqërisë, ndërkohë që sipas tyre shoqëria ka dalë me fitim.

Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 2.6.2021, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, duke urdhëruar prokurorinë të kryejë veprimet hetimore sipas detyrave të pasqyruara në pjesën arsyetuese. Gjykata e Apelit Vlorë, me trup gjykues vetëm gjyqtarin Laurent Fuçia, me vendimin nr. ***, datë 28.7.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 2.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pranimin e kërkesës së paraqitur nga prokuroria.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit nr. ***, datë 9.10.2018, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal nr. ***, rezulton se kjo gjykatë, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se: (i) gjykata e rrethit dhe prokurori, megjithëse kanë pasur dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, nuk janë thelluar në analizën e pasojave të ardhura nga kjo vepër penale, konkretisht ato që kanë të bëjnë me kalimin e fondeve të përvetësuara nga fondi i EKB-së tek shoqëria “****”; (ii) në varësi të kalimit të këtyre fondeve të analizohet parashkrimi ose jo i ndjekjes penale për këtë vepër penale; (iii) veprat penale të pretenduara nga kallëzuesi për shpërdorimin e kompetencave¹⁸¹, falimentimin e provokuar¹⁸², fshehjen e të ardhurave nëpërmjet paraqitjes së bilanceve të pavërteta në organet tatimore¹⁸³ kanë karakter vazhdues, duke vijuar në kohë dhe në çastin e paraqitjes së kallëzimit e nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të ndjekjes penale dhe, në këtë kuptim, organi procedues ka detyrimin për të regjistruar procedimin penal për këto vepra penale dhe për të vijuar me hetimin e pretendimeve të kallëzuesve.

Prokuroria, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, ka paraqitur kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. *** në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, duke arsyetuar se: (i) për veprën penale “shpërdorim i kompetencave” fakti objekt procedimi është i njëjtë me atë të hetuar nga prokuroria në procedimin penal nr. ***; (ii) lidhur me veprën penale “falimentim i provokuar”, nga hetim i kryer në kuadër të procedimit penal nr. *** nuk janë konstatuar kundërligjshmëri në lidhje me veprimtarinë e nxjerrës së mjeteve jashtë përdorimit; (iii) në lidhje me veprën penale “fshehje e të ardhurave” nuk rezulton se është kryer ndonjë veprim i kundërligjshëm nga ushtrimi i veprimtarisë tregtare; (iv) në lidhje me veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” rezulton se shuma reale e përfituar nga EKB-ja është 7.800.000 lekë dhe kjo shumë nuk i ishte dhënë nga EKB-ja, por shoqëria ia kishte kaluar fillimisht këtij institucioni e më pas ka kërkuar kthimin e saj dhe nga hetimi nuk u zbulua ndonjë rrethanë e re nga ato të cilat ishin hetuar në procedimin penal nr. ***, të cilat janë ende në fuqi edhe për këtë procedim penal.

Gjithashtu, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në vendimin nr. ***, datë 28.7.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e gjykimit, me arsyetimin se në rastin konkret jemi përpara institutit të “gjësë së gjykuar”, pasi pretendimet e kallëzuesve kanë qenë objekt hetimi në procedimet penale nr. *** dhe nr. ***.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij, pavarësisht se citon parimin *ne bis in idem*, arsyeton se jemi përpara institutit të “gjësë së gjykuar”, të cilat janë parime të ndryshme. Në lidhje me parimin *ne bis in idem*, Gjykata Kushtetuese është shprehur se parimi i mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale është njohur si një prej të drejtave të njeriut

¹⁸¹ Neni 164 i Kodit Penal.

¹⁸² Neni 193 i Kodit Penal.

¹⁸³ Neni 180 i Kodit Penal.

të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare, sipas të cilit askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një veprë penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar. Kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtit veprim, sjelljeje, fakti, veprë penale dhe kualifikimit ligjor të tyre, që formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilën personi është dënuar apo liruar¹⁸⁴. Gjithashtu, ky parim duhet të kuptohet se e ndalon ndjekjen ose gjykimin e një personi për një “veprë” të dytë, për sa kohë që kjo e fundit ka si zanafillë fakte të njëjta ose fakte që janë “në thelb” të njëjta me ato të veprës së parë, ku del i përzier i njëjti autor dhe të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht midis tyre në kohë dhe në hapësirë¹⁸⁵. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm. Ndërsa parimi *res judicata* nënkupton, në aspektin formal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa në atë substancial fuqinë e detyrueshme të vendimit¹⁸⁶.

Në rastin konkret, rezulton që pretendimet e kallëzuesve lidhur me kalimin e fondeve të përvetësuara nga fondi i EKB-së është hetuar në procedimin penal nr. ***, ndërsa pretendimet e tyre për kryerjen e veprave penale “shpërdorim i kompetencave”, “falimentim i provokuar” dhe “fshehje e të ardhurave” janë hetuar në procedimin penal nr. **. Si pasojë, në rastin konkret, gjenden elemente të parimit *ne bis in idem*. Për sa i përket orientimit të Gjykatës së Apelit Vlorë në vendimin nr. **, datë 9.10.2018, lidhur me karakterin vazhdues të këtyre veprave penale, Komisioni vlerëson se për sa kohë në procedimet penale nr. ** dhe nr. ** nuk janë konstatuar elemente të figurës së veprave penale, atëherë mungon edhe elementi “vazhdues”.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

140.4. Në lidhje me denoncimin nr. **, datë 31.5.2022, të shtetasit I. K. i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për marrjen e një vendimi të kundërligjshëm për ndryshim mase sigurimi personal, Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit në lidhje me arsyet e marrjes së vendimit për ndryshimin e masës së sigurimit të personit nën hetim nga “arrest shtëpie” në “detyrim paraqitjeje në policinë gjyqësore”, se *Gjykata e Apelit Vlorë ka arritur në konkluzionin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka qenë rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal, pasi: (i) prokurori i çështjes në gjykimin në shkallë të parë ka qenë dakord me pranimin e kërkesës së pandehurit për zëvendësimin e masës së sigurimit, me arsyetimin se masa e “arrestit në shtëpi” nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit, për aq kohë sa akuza për veprën penale më të rëndë rezulton të jetë pushuar dhe tashmë i pandehuri akuzohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të Kodit Penal¹⁸⁷; (ii) gjyqtari i seancës paraprake, pas kërkesës së paraqitur nga prokurori, ka vendosur pushimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, e cila ka qenë edhe vepra penale më e rëndë për të cilën është dyshuar i pandehuri gjatë fazës së hetimeve paraprake, duke u akuzuar tashmë vetëm për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të Kodit Penal (të cilat parashikojnë dënime me burgim nga 6 muaj - 4 vjet dhe nga 6 muaj - 5 vjet), arrin në konkluzionin se duke u bazuar në nenin 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, që*

¹⁸⁴ Vendimet nr. 5, datë 8.3.2005, nr. 10, datë 2.4.2009, nr. 33, datë 22.7.2011 dhe nr. 8, datë 28.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸⁵ Vendim i GJEDNJ-së (Dh. M.) *Serguei Zolotoukhine k. Rusisë*, datë 10.2.2009.

¹⁸⁶ Vendim nr. 29, datë 21.12.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸⁷ Faqet nr. 1 dhe nr. 2 të procesverbalit të seancës gjyqësore, datë 4.5.2022, ndodhur në dosjen gjyqësore.

parashikon se çmimi i aftësive gjyqësore bëhet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, çmon se Gjykata e Apelit Vlorë ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të administruara në dosjen gjyqësore dhe, për pasojë, ka bërë një interpretim të ndryshëm të ligjit, duke vlerësuar se masa e “arrestit në shtëpi” nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit, për aq kohë sa akuza për veprën penale më të rëndë rezulton të jetë pushuar dhe tashmë i pandehuri akuzohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të Kodit Penal, që parashikojnë masa dënimi më të buta.

Si rrjedhojë, Komisioni vlerëson se në rastin konkret ndryshimi i vendimit të gjykatës së rrethit nga Gjykata e Apelit ka të bëjë me ushtrimin e funksionit të kësaj të fundit si gjykatë më e lartë në kontrollin e korrektësisë së vendimeve të gjykatave të rrethit dhe me zgjidhjen në themel të çështjes, kritere të cilat nuk janë objekt i rivlerësimit të aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

140.5. Në lidhje me denoncimet nr. * prot., datë 11.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 28.12.2022**, të shtetasit V. H., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit se ka marrë vendim të padrejtë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 13.2.2019, jo sipas parashikimeve të neneve 328 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale dhe jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi: (a) nuk ka përcaktuar të drejtat e palëve mbi truallin, parkimin dhe pjesët takuese të tyre; (b) nuk ka analizuar veprimet e shtetasit N. M. mbi truallin (sendin) mbi të cilin pretendon se ekziston e drejta e tij e ligjshme.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁸⁸, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se konstatimet e Komisionit lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes, si rezultat i mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit procedural penal dhe atij material penal, si dhe e vlerësimit dhe çmuarjes së akteve të fashikujve hetimorë sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit. Më pas shpjegon se pretendimet e kallëzuesit kanë qenë me natyrë juridiko-civile, pasi nga ana e tij në kallëzim janë ngritur pretendime pronësie mbi truallin, parkimin dhe pjesët takuese përkatëse midis tij dhe personit të kallëzuar, të cilat buronin nga kontrata e sipërmarrjes lidhur me subjektin “****” sh.p.k. Gjithashtu, shpjegon se në rastin konkret vendimi i Gjykatës së Apelit ka qenë rrjedhojë e një interpretimi të ndryshëm të ligjit procedural penal të bërë nga gjykata e shkallës së parë, si dhe të një vlerësimi të ndryshëm të akteve të fashikujve hetimorë nga ai i bërë nga gjykata e shkallës së parë.

Nga hetimi i Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit V. H., ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Në datën 12.10.2018 prokurorja e çështjes ka vendosur pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale, duke e konsideruar konfliktin të natyrës juridiko-civile. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi V. H..

¹⁸⁸ Email datë 23.2.2022.

Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 13.2.2019, ka vendosur rrëzimin e ankimit, me arsyetimin se konflikti midis palëve ka natyrë juridiko-civile, palët duhet t'i drejtohen gjykatës së juridiksionit civil, me padi kontraktuale, sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 9.4.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pranimin e ankimit dhe prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal dhe kthimin e akteve për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Referuar vendimeve të mësipërme gjyqësore, Komisioni konstaton se Gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka rivlerësuar provat e administruara në dosjen gjyqësore, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, duke arritur në përfundimin se organi i akuzës duhet të kryente një hetim më të plotë. Si pasojë, Komisioni vlerëson se në rastin konkret ndryshimi i vendimit të gjykatës së rrethit nga Gjykata e Apelit ka të bëjë me ushtrimin e funksionit të kësaj të fundit si gjykatë më e lartë në kontrollin e korrektësisë së vendimeve të gjykatave të rrethit, kriter i cili nuk është objekt i rivlerësimit të aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

141. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

142. Lidhur me denoncimet e tjera të administruara në Komision për subjektin e rivlerësimit Laurent Fuçia, pasi u verifikuan nominalisht denoncimet e paraqitura, trupi gjykues i Komisionit çmoi se ato nuk paraqisnin *indicie*, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjen konkrete, në drejtim të vlerësimit të kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të nenit 49, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzion i Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

143. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta¹⁸⁹. Gjithashtu, ka çmuar se vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale¹⁹⁰.

144. Trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 (986 çështje); (ii) mangësitë e konstatuara si më lart nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen serioze dhe as të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale; (iii) nuk rezulton që veprimet e subjektit të rivlerësimit mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta;

¹⁸⁹ Vendimet nr. 17, datë 12.11.2004 dhe nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹⁰ Vendim nr. 2, datë 18.1.2017.

(iv) kërkesat e germës “c” të pikës 1 të nenit 59, i cili përcakton se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet: [...] *kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale* [...] – vlerëson se problematikat e rezultuara në rivlerësimin e aftësive profesionale, të përshkruara më lart në arsyetimin e këtij vendimi, nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

145. Për këto arsye dhe për sa janë detajuar më sipër, sipas përcaktimit të nenit 44, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

146. Gjithashtu, trupi gjykues, lidhur me marrjen e vendimit nr. ***, datë 7.10.2013, vlerëson se çështja e përmendur më lart nuk është e mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të nenit 44, gjerat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, kjo çështje nuk përbën shkak që mund ta çonte trupin gjykues në përfundimin se subjekti i vlerësimit ka cenuar besimin e publikut të dhënia e drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

147. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të konfirmohet në detyrë.

Për këto arsye,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, germën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë aktet e çështjes civile nr. *** dhe vendimin nr. *** akti, datë 7.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj